


# Publikationen

zur rechtlichen Zusammenarbeit

**Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e  
Njeriut**

**Botimi 1/2018, vëllimi i 6-të, viti i 4-të**

**Aktuelle Rechtsprechung des EGMR  
Newsletter 1/2018**



botuar nga  
Enti për përfaqësim të Republikës së  
Maqedonisë para GJEPD  
dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim  
ndërkombëtarë juridik, Shoqatë e  
regjistruar (IRZ)





## BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Botues:

MAKAVEJ Shkup, viti 2018

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Koço Bendo (faqe 12-76)

Behar Dalipi (faqe 77-93)

Koordinimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Dr. Stefan Pürner, avokat, dhe Danica Djonova, v.d. Drejtore e Entit për përfaqësimin e RM-së para GJEDNJ-së.

Bashkëpunimi i redaksisë së botimit në gjuhën shqipe: Ritta Lideroth, jurist, menaxhues i projektit pranë IRZ dhe Dana Trajçev – Bozhicq, V.A., studime për media dhe komunikime.

Përkthimi i këtij Buletini në gjuhën shqipe, si dhe botimi i këtij publikimi u mundësua nga ana e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar, shoqatë e regjistruar (IRZ).

Buletini i praktikës gjyqësore të  
Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

botuar nga  
Enti për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para GJEDNJ-së

dhe  
Fondacioni gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar  
Shoqatë e regjistruar (IRZ)

Botimi 1/ 2018, vëllimi i 6-të, viti i 4-të, në gjuhën shqipe

~~~~~

Newsletter zur Rechtsprechung des  
Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte

Gemeinsam herausgegeben von dem mazedonischen  
Regierungsvertreter vor dem EGMR

und der  
Deutschen Stiftung für internationale rechtliche  
Zusammenarbeit e.V. (IRZ)

Ausgabe 1/2018, 6. Band, 4. Jahrgang in albanischer Sprache

*Sehr geehrte Kolleginnen und Kollegen, liebe Leser,*

sie halten eine neue Ausgabe des bereits im vierten Jahr erscheinenden Newsletter zur Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte (EGMR) in Straßburg in Händen. Dieser Newsletter ist zur Information von Justizangehörigen, insbesondere Richtern und Staatsanwälten, und Behördenmitarbeitern in Mazedonien gedacht. Deshalb berichtet er vor allem über Urteile des Straßburger Gerichts, die für diese von besonderem Interesse sind, also über Entscheidungen, die gegen Mazedonien ergangen sind, oder aber, obwohl sie aus Verfahren gegen andere Staaten stammen, sich auf Rechtsfragen beziehen, die in Mazedonien große praktische Bedeutung haben.

Herausgegeben wird dieser Newsletter, der in mazedonischer und albanischer Sprache erscheint, gemeinsam von der mazedonischen Regierungsvertreterin und Direktorin des Büros für die Vertretung Mazedoniens vor dem EGMR und der Deutschen Stiftung für internationale rechtliche Zusammenarbeit e.V. (kurz IRZ).

Bei der IRZ handelt es sich um eine seit 1992 bestehende Organisation, die im Auftrag der deutschen Bundesregierung Transformationsstaaten bei den Reformen hin zum Rechtsstaat unterstützt. In der IRZ sind die wichtigsten deutschen Organisationen, die im Bereich des Rechtsstaates und der Justiz tätig sind, zusammengeschlossen. Dazu gehören (in alphabetischer Reihenfolge gemäß ihrer Bezeichnung in deutscher Sprache) der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V., der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterrinnen, die Bundesnotarkammer, die Bundesrechtsanwaltskammer, der Deutsche Anwaltverein e.V., die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V., der Deutsche Juristinnenbund e.V. der Deutsche Notarverein e.V., der Deutsche Richterbund e.V. und die Notarkammer Koblenz.

Eine weitere Gruppe von Mitgliedern bilden wirtschaftliche Vereinigungen, wie der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V., der Bundesverband deutscher Banken e.V., der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V., der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V., der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V., der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft e.V., der Markenverband e.V., Berlin und der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.

Hinzu kommen bedeutende Industrieunternehmen Allianz SE, Bayer AG und Daimler AG) sowie eine Anzahl von Einzelpersonen aus Justiz, Politik und Wissenschaft.

In Mazedonien ist die IRZ seit dem Jahr 2000 mit Mitteln des deutschen Auswärtigen Amtes (AA) aus dem deutschen Beitrag zum Stabilitätspakt für Südosteuropa tätig. Darüber hinaus wird die Tätigkeit der IRZ allgemein, aber auch in Südosteuropa, durch eine

*Shumë të nderuar kolege dhe kolegë, të dashur lexues,*

po merrni në dorë botimin e ri të buletinit në vitin e tij të katër të publikimit mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg. Ky buletin është menduar për informimin e operatorëve të drejtësisë, veçanërisht gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe punonjësve të organeve administrative në Maqedoni. Për këtë arsye ai përmban para së gjithash vendime të Gjykatës së Strasburgut që për ta paraqesin interes të veçantë, pra vendime të cilat janë dhënë kundër Maqedonisë ose nga gjykime të tjera kundër shteteve të tjera, por që prekin çështje ligjore të cilat për Maqedoninë janë me rëndësi të madhe praktike.

Ky buletin, i cili del në gjuhët maqedonase dhe shqipe, botohet në bashkëpunim me përfaqësuesen e qeverisë maqedonase dhe Drejtorinë e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (shkurt IRZ).

IRZ-ja është një organizatë që është themeluar në vitin 1992, e cila, në emër të Qeverisë Federale Gjermane, mbështet shtetet në transformim e sipër në reformat e tyre drejt shtetit të së drejtës. Në IRZ-ë përfaqësohen organizatat gjermane më të rëndësishme të cilat veprojnë në sferën e shtetit të së drejtës dhe drejtësisë. Këtu përfshihen (në renditje alfabetike sipas emërimit në gjuhën gjermane) Lidhja Gjermane e Punonjësve Gjyqësorë (der Bund Deutscher Rechtspfleger e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve dhe Gjyqtareve për Çështjet Administrative (der Bund Deutscher Verwaltungsrichter und Verwaltungsrichterrinnen), Dhoma Federale e Noterisë (die Bundesnotarkammer), Dhoma Federale e Avokatisë (die Bundesrechtsanwaltskammer), Shoqata Gjermane e Avokatëve (der Deutsche Anwaltverein e.V.), Institucioni gjerman i Arbitrazhit (die Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit e.V.), Lidhja gjermane e Juristëve (der Deutsche Juristinnenbund e.V.), Shoqata Gjermane e Noterëve (der Deutsche Notarverein e.V.), Lidhja Gjermane e Gjyqtarëve (der Deutsche Richterbund e.V.) dhe Dhoma e Noterisë Koblenz (die Notarkammer Koblenz).

Një grup tjetër i anëtarëve përbëhet nga organizimet ekonomike si Shoqata Federale e Industrisë Gjermane (der Bundesverband der Deutschen Industrie e.V.), Shoqata Federale e Bankave Gjermane (der Bundesverband deutscher Banken e.V.), Shoqata Federale e Juristëve të Ndërmarrjeve (der Bundesverband der Unternehmensjuristen e.V.), Shoqata Gjermane e Kooperativave dhe Raiffeisen-it (der Deutsche Genossenschafts- und Raiffeisenverband e.V.), Kongresi i Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë (der Deutsche Industrie- und Handelskammertag e.V.), Shoqata e Përgjithshme e Ekonomisë Gjermane të Sigurimeve (der Gesamtverband der Deutschen Versicherungswirtschaft

institutionelle Zuwendung des deutschen Bundesministeriums der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV) ermöglicht.

Im Rahmen dieser Tätigkeit spielen die Menschenrechte und die Europäisierung des Rechtes eine besondere Rolle. Außer Gesetzgebungsberatung und Unterstützung bei der Aus- und Weiterbildung von Juristen arbeitet die IRZ auch auf dem besonders nachhaltigen Feld juristischer Publikationen. So erscheint in Mazedonien zusätzlich zu diesem Newsletter bereits seit dem Jahre 2011 eine juristische Fachzeitschrift zum Europarecht, die unter <http://www.evropsko-pravo.info> auch eine eigene Internetseite besitzt, von der alle bisher erschienenen Ausgaben dieser Zeitschrift heruntergeladen werden können. Auch ist es dort möglich, einzelne Beiträge gezielt herunterzuladen.

Auch der vorliegende Newsletter wird in elektronischer Form vertrieben. So findet sich die mazedonische Fassung auf der Internetseite der IRZ unter <https://www.irz.de/index.php/doenloads#публикации-на-македонски-јазик-publicationen-in-mazedonischer-sprache> und die albanische unter

<https://www.irz.de/index.php/doenloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publicationen-in-albanischer-sprache>. Darüber hinaus werden alle Ausgaben des Newsletters auch auf der Internetseite des Büros für die Vertretung Mazedoniens vor dem EGMR unter <http://biroescp.gov.mk> in der Rubrik „Sudska praksa“ (Rechtsprechung) zum Herunterladen angeboten. Dort finden sich auch alle andere Urteile des EGMR gegen Mazedonien in mazedonischer Übersetzung.

Durch die elektronische Publikation wird der Newsletter allen Interessierten zugänglich. Die Angehörigen der mazedonischen Justiz erhalten ihn darüber hinaus in Druckform. Die wichtigste Rechtsprechung des EGMR ist deshalb mithilfe dieses Newsletters jedem mazedonischen Richter und Staatsanwalt zeitnah direkt auf seinem eigenen Schreibtisch zugänglich.

Die Herausgeber des Newsletters haben bewusst verschiedene Verbreitungswege gewählt, um einen möglichst großen Adressatenkreis erreichen zu können. Dies deshalb, da die Rechtsprechung des Straßburger EGMR für die Anwendung des jeweiligen nationalen Rechts von erheblicher Bedeutung ist. Außerdem garantiert sie, dass die gemeinsamen Menschenrechtsstandards der im Europarat zusammengeschlossenen Staaten auch in der Praxis tatsächlich eingehalten werden.

Ein so anspruchsvolles und nachhaltiges Unternehmen wie die bereits jahrelange regelmäßige Herausgabe eines aktuellen Newsletters in zwei Sprachen ist nur durch das Engagement aller Beteiligten, Teamwork und dauerhafte Unterstützung möglich.

e.V.), Shoqata e Markave, Berlin (der Markenverband e.V., Berlin) dhe Shoqata e Europës Lindore e Ekonomisë Gjermane (der Osteuropaverein der deutschen Wirtschaft e. V.).

Këtu përfshihen edhe ndërmarrjet e rëndësishme industriale Allianz SE, Bayer AG dhe Daimler AG si dhe një numër personalitetesh nga drejtësia, politika dhe shkenca.

Në Maqedoni IRZ-ja e ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2000 me fondet e Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme nga kontributi gjerman për Paktin e Stabilitetit për Europën Juglindore. Përveç kësaj, aktiviteti i IRZ-së në përgjithësi, por edhe për Europën Juglindore, mundësohet nëpërmjet një kontributi institucional të Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorit (MFDK).

Në kuadrin e këtij aktiviteti të drejtat e njeriut dhe europianizimi i së drejtës luajnë një rol të veçantë. Përveç këshillimeve në hartimin e legjislacionit dhe mbështetjes në trajnimin fillestar dhe të vazhduar të juristëve, IRZ-ja punon veçanërisht në sferën qëndrueshme të publikimeve juridike. Kështu në Maqedoni, përveç këtij buletini qysh nga viti 2011 botohet edhe një revistë juridike mbi të drejtën europiane e cila tek adresa <http://www.evropsko-pravo.info> ka edhe një faqe të vetën, nga e cila mund të shkarkohen të gjitha botimet e deritanishme të kësaj reviste. Edhe atje është e mundur të shkarkohen artikuj të veçantë.

Edhe ky buletin do të botohet në format elektronik. Kështu versioni në maqedonisht gjendet në faqen e internetit të IRZ-së tek adresa <https://www.irz.de/index.php/doenloads#публикации-на-македонски-јазик-publikationen-in-mazedonischer-sprache> dhe versioni në shqip tek adresa

<https://www.irz.de/index.php/doenloads#publikime-n%C3%AB-gjuh%C3%ABn-shqipe-publikationen-in-albanischer-sprache>. Përveç kësaj, të gjitha botimet e buletinit ofrohen për tu shkarkuar edhe në faqen e internetit të Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së tek adresa <http://biroescp.gov.mk> në rubrikën „Sudska praksa” (Praktika gjyqësore). Atje gjenden edhe të gjitha vendimet e tjera të GJEDNJ-së kundër Maqedonisë të përkthyer në maqedonisht.

Nëpërmjet botimit elektronik buletini është i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Operatorëve të drejtësisë maqedonase ai u jepet edhe në format fizik. Nëpërmjet këtij buletini i vihet në dispozicion çdo gjyqtari dhe prokurori maqedonas praktika më e rëndësishme e GJEDNJ-së në kohë të afërt dhe drejtpërdrejt në tavolinën e tij të punës.

Botuesit e buletinit kanë zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme disa variante publikimi, për të arritur një rreth sa më të gjerë të interesuarish. Kjo për shkak se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së së Strasburgut është e një rëndësie të veçantë për zbatimin e së drejtës



Allen voran gilt es dem deutschen Auswärtigen Amt für die finanzielle Unterstützung, ohne die die Publikation, die sie derzeit in Händen halten, nicht entstehen hätte können, zu danken. Ergänzt wird diese Unterstützung aus Berlin durch das Engagement der deutschen Botschaft vor Ort in Skopje, die die Tätigkeit der IRZ aktiv und engagiert begleitet. Deshalb gilt Herrn Botschafter Thomas Gerberich und seinen Mitarbeitern an dieser Stelle ein herzliches Wort des Dankes. Zu danken haben die Herausgeber auch dem deutschen Ministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (BMJV), das die Arbeit der IRZ mit einer institutionellen Zuwendung überhaupt erst ermöglicht.

Besonderen Dank schulden die Herausgeber den Übersetzern, die sich regelmäßig der nicht leichten Aufgabe stellen, die hier zusammengefassten anspruchsvollen juristischen Texte in die genannten Sprachen zu übertragen.

Desweiteren ist auch den Mitarbeitern, die in den beteiligten Organisationen an der Erstellung dieses Newsletters mitgewirkt haben, zu danken. Dies sind bei der IRZ Frau Dana Trajcev Bozic, die diese Publikation in Bonn als Projektmanagerin Bonn betreut und Frau Natascha Andreevska-Tomovska, die in Skopje vor Ort für die IRZ die Koordination mit dem Projektpartner, den Übersetzern und dem Verlag übernommen hat.

Zuallerletzt ist noch den Lesern zu danken, die durch ihr bereits seit Jahren anhaltendes Interesse dazu beigetragen haben, dass dieser Newsletter ein Erfolg wurde. Diese Anerkennung ist uns Ansporn, die Herausgabe diese Publikation auch in Zukunft in der bisherigen Qualität fortzusetzen.

Bonn/Skopje, im September 2018

**Danica Djonova LL.M**  
*Kommissarische Direktorin des Büros  
für die Vertretung Mazedoniens  
vor dem EGMR*

**Rechtsanwalt Dr. Stefan Pürner**  
*Bereichsleiter der IRZ  
für Bosnien und Herzegowina, Mazedonien,  
Montenegro sowie Serbien*

përkatëse të brendshme. Përveç kësaj, ajo garanton që standardet e përbashkëta të të drejtave themelore të shteteve palë në Këshillin e Europës të respektohen faktikisht edhe në praktikë.

Një ndërmarrje e tillë ambicioze dhe e qëndrueshme siç është botimi i rregullt për vite me radhë e një buletini të përditësuar në dy gjuhë është e mundur vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë pjesëmarrësve, punës në ekip dhe mbështetjes së vazhdueshme.

Para së gjithash i duhen shprehur falënderimet Ministrisë gjermane të Punëve të Jashtme për mbështetjen financiare, pa të cilin botimi, të cilin tashme keni në dorë, nuk do të ishte i mundur. Kjo mbështetje nga Berlini plotësohet me angazhimin e ambasadës gjermane në Shkup, e cila ndjek në mënyrë të angazhuar dhe aktivisht aktivitetin e IRZ-së. Për këtë shkak Zotit Ambasador Thomas Gerberich dhe kolegëve të tij me këtë rast i shprehim falënderime të përzemërta. Botuesit duhet të falënderojnë gjithashtu edhe Ministrinë gjermane të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MFDK), e cila ka mundësuar punën e IRZ-së nëpërmjet një kontributi institucional.

Një falënderim të veçantë botuesit duhet tu shprehin përkthyesve, të cilët marrin përsipër një punë jo të lehtë për përkthimin në gjuhët përkatëse të këtyre teksteve të vështira juridike të përmbledhura .

Më tej një falënderim u shkon edhe kolegëve, të cilët kanë kontribuar në kuadrin e organizatave pjesëmarrësve për përpilimin e këtij buletini. Këta janë në IRZ-ë Zj Dana Trajcev Bozic, e cila është kujdesur për këtë botim në Bon si menaxhere projekti dhe Zj Nataza Andreevska-Tomovska, e cila ka marrë përsipër në Shkup për IRZ-në bashkërendimin me partnerët e projektit, përkthyesit dhe shtëpinë botuese.

Pikë së fundi, një falënderim shkon për lexuesit të cilët, për vite me radhë nëpërmjet interesit të tyre kanë kontribuar që ky buletin të kthehet në sukses. Kjo mirënjohje është për ne nxitje për nxjerrjen e këtij botimi edhe në të ardhmen me cilësinë e deritanishme.

Bon/Shkup, shtator viti 2018

**Danica Djonova LL.M.**

*Drejtoare e Komanduar e Agjencisë për përfaqësimin e Maqedonisë para GJEDNJ-së*

**Avokat Dr. Stefan Pürner**

*Drejtues i Projektit të IRZ-së për Bosnjën dhe Hercegovinën, Maqedoninë Malin e Zi dhe Serbinë.*

## Përmbajtja

*Parathënia e botuesve* ..... 4

### I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

***Tekin dhe Arslan kundër Belgjikës*** - 37795/13,  
Vendim themeli 5.9.2017 [Seksioni II] ..... 12

***Dorneanu kundër Rumanisë*** - 55089/13,  
Vendim Themeli 28.11.2017 [Seksioni IV] ..... 14

***.S.F. dhe të Tjerë kundër Bullgarisë*** - 8138/16,  
Vendim themeli 7.12.2017 [Seksioni V] ..... 17

***Stollenwerk kundër Gjermanisë*** - 8844/12,  
Vendim Themeli 7.9.2017 (Seksioni V) ..... 19

***Vasiliciuc kundër Republikës së Moldavisë*** - 15944/11,  
Vendim themeli 2.5.2017 [Seksioni II] ..... 21

***Oravec kundër Kroacisë*** - 51249/11,  
Vendim Themeli 11.7.2017 (Seksioni II) ..... 23

***Zubac kundër Kroacisë (GC)*** - 40160/12,  
Vendim Themeli 5.4.2018 (GC) ..... 24

***Bikas kundër Gjermanisë*** - 76607/13,  
Vendim Themeli 25.1.2018 (Seksioni V) ..... 28

***Correia de Matos kundër Portugalisë (GC)*** - 56402/12,  
Vendim themeli 4.4.2018 (GC) ..... 31

***Moreira Ferreira kundër Portugalisë (nr. 2) (GC)*** - 19867/12,  
Vendim themeli 11.7.2017 (GC) ..... 36

***Matanović kundër Kroacisë*** - 2742/12,  
Vendim Themeli 4.4.2017 (Seksioni II) ..... 40

***Regner kundër Republikës Çeke (GC)*** - 35289/11,  
Vendim themeli 19.9.2017 (GC) ..... 42

|                                                                                                                                           |           |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë - 10613/16,</b><br>Vendim themeli 11.1.2018 (Seksioni I) .....                                  | 46        |
| <b>Bărbulescu kundër Rumanisë (GC) - 61496/08,</b><br>Vendim themeli 5.9.2017 (GC) .....                                                  | 49        |
| <b>Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe të tjerë kundër Bosnjës<br/>Hercegovinës (GC) - 17224/11, Vendim themeli 27.6.2017 (GC) .....</b> | <b>54</b> |
| <b>GRA Stiftung Gegen Rassismus und Antisemitismus kundër<br/>Zvicrës - 18597/13, Vendim themeli 9.1.2018 (Seksioni III) .....</b>        | <b>58</b> |
| <b>Škorjanec kundër Krocisë - 25536/14, Vendim Themeli 28.3.2017 (Seksioni II) .....</b>                                                  | <b>60</b> |
| <b>N. kundër Rumanisë - 59152/08, Vendim Themeli 28.11.2017 (Seksioni IV) .....</b>                                                       | <b>62</b> |
| <b>Davydov dhe të Tjerë kundër Rusisë - 75947/11,</b><br>Vendim themeli 30.5.2017 (Seksioni III) .....                                    | 67        |
| <b>De Tommaso kundër Italisë (GC) - 43395/09 - Vendim themeli 23.2.2017 (GC) .....</b>                                                    | <b>71</b> |

## II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

|                                                                                                                                                                                                                   |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Selami dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 78241/13,</b><br>aktgjykimi i datës 1 mars të vitit 2018 .....                                                                                     | 77 |
| <b>Asani kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 27962/10,</b><br>aktgjykimi i datës 1 shkurt të vitit 2018 .....                                                                                                 | 81 |
| <b>Ramkovski kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 33566/11,</b><br>aktgjykimi i datës 8 shkurt të vitit 2018 .....                                                                                             | 85 |
| <b>Taseva Petrovska kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 73759/14,</b><br>aktgjykimi i datës 11 janar të vitit 2018 .....                                                                                      | 89 |
| <b>Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Ortodokse – Greke e<br/>Ohrit e Patrikanës së Pejës) kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 3532/07,</b><br>aktgjykimi i datës 16 nëntor të vitit 2017 ..... | 90 |

# I. AKTGJYKIMET MË TË REJA TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

## Neni 2

### Neni 2 - Përdorimi i forcës

Vdekja e të burgosurit të sëmurë mendor pas shtrëngimit në grykë nga një punonjës i burgut: *shkelje*

***Tekin dhe Arslan kundër Belgjikës - 37795/13***, Vendim themeli 5.9.2017 [Seksioni II]

**Faktet** – Kërkesit ishin prindërit e një të burgosuri i cili vuante nga çrregullime psikiatrike i cili ishte vendosur në një qeli individuale në krahun e zakonshëm të një burgu.

Tre gardianë burgu shkuan në qelinë e tij për ti lexuar disa masa të posaçme sigurie që duhej të zbatoheshin. Pasi u provokuan nga i biri i kërkesve, ata vendosën ta vinin nën kontroll fizik nga frika e një sulmi prej tij dhe për ta vendosur atë në një qeli izolimi. Megjithatë, ai vdiq si rezultat i një teknike shtrënguese ‘bllokim krahu’ e aplikuar nga një prej gardianëve, i ndihmuar nga dy prej kolegëve të tij.

Të tre gardianët u ndoqën penalisht për sulm të vullnetshëm që ka rezultuar në vdekje të paqëllimtë. Megjithatë, gjykimi përfundoi me pafajësinë e tyre.

**Ligji** – Neni 2 (*aspekti lëndor*): Përdorimi i forcës nga gardianët e burgut përfshihej në rrethin e shkaqeve të përcaktuara nga Neni 2, par 2 (a) i Konventës, që është ‘në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme’.

(a) *Kuadri përkatës ligjor dhe administrativ* – Ndërsa kuadri ligjor i brendshëm që rregullon përdorimin e masave shtrënguese nga gardianët ndaj të burgosurit autorizonte përdorimin e forcës vetëm nëse i njëjti objektiv nuk mund të arrihej me mjete të tjera dhe duke patur parasysh parimin e proporcionalitetit, megjithatë, ishte i përcaktuar në terma tepër të përgjithshëm dhe nuk ishte i

qartë në masë të mjaftueshme se cilat masa shtrënguese ishin të autorizuara dhe cilat ishin të ndaluara. Posaçërisht, Autoritetet belge nuk kishin nxjerrë ndonjë udhëzim që të ndalonte teknikat e përdorimit të shtrëngimit fizik që mund të pengonte rrugët e frymëmarrjes ose, aq më tepër, të shkaktonte mbytje, siç është rekomanduar nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar(KPT).

(b)*Trajnimi i personelit*– Trajnimi i dhënë personelit të burgut në Belgjikë në periudhën përkatëse ka qenë i mangët. Personeli i burgut i përfshirë në këtë çështje kishte marrë trajnim relativisht të kufizuar, ndërsa nuk i ishte dhënë aspak trajnim posaçërisht për të burgosurit që vuajnë nga çrregullimet psikiatrike. Qysh nga vdekja e të burgosurit, ishte prezantuar një trajnim gjashtë-ditor për të trajtuar çështjen e të burgosurve të sëmurë mendorë.

(c) *Domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i forcës së përdorur*– Ndërhyrja nuk ishte e nevojshme për të shtrënguar fizikisht një individ i cili përbente rrezik për jetën e njeriut, qoftë kjo e veta apo e të tjerëve.

Përveç kësaj, personeli i burgut e njëjtte të burgosurin dhe ishte në dijeni të shëndetit të tij mendor; ai nuk mbahej në një krah të zakonshëm të burgut, por në një qeli në krahun e burgut për të sëmurët psikikë, ku personeli që shërbente ishte i trajnuar më mirë për të trajtuar individët që ishin të sëmurë mendorë.

Sidoqoftë, kërkuesi ishte vulnerabël përse i takon sëmundjes së tij mendore dhe faktit që atij i ishte hequr liria. Megjithatë, gjykata penale nuk e mori fare parasysh këtë faktor gjatë analizës së domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të forcës së përdorur nga gardianët e burgut. Përkundrazi, i biri i kërkuesit dukej se u trajtua si një i burgosur i zakonshëm në zotërim të plotë të aftësive të tij mendore.

Nuk u zhvillua ndonjë diskutim nga gardianët e burgut se si mund të veprohej më mirë për të informuar të burgosurin në lidhje me masat në fjalë dhe në trajtimin e një reagimi potencialisht negativ ose agresiv nga ana e tij. Pavarësisht paparashikueshmërisë së sjelljes njerëzore, kjo çështje nuk kishte të bënte me një ndërhyrje rastësore që u zhvillua në një mënyrë të papritur, duke kërkuar kështu që gardianët e burgut të reagonin pa qenë të përgatitur. Po ashtu, nga të tre gardianët ose eprorët e tyre nuk ishte përgatitur masë tjetër përveç neutralizimit dhe vendosjes në një qeli izolimi.

Risku që një shtrëngim në grykë të kishte pasoja fatale nuk ishte mësuar në kursin e trajnimit të ndjekur nga R. Megjithatë, nuk kishte asnjë dyshim që një masë e tillë mund të sillte asfiksion dhe në këtë mënyrë të ishte potencialisht vdekje-prurëse.

Me gjithë faktin që pas neutralizimit, i shtrirë në tokë dhe lidhur këmbë e duar, i biri i kërkuesit nuk përbënte më rrezik për të tjerët, gardianët e shumtë të pranishëm gjatë incidentit nuk bënë kontrollin as më sipërfaqësor për të verifikuar gjendjen e tij shëndetësore.

Në këto rrethana, përdorimi i forcës nuk kishte qenë ‘absolutisht e nevojshme’. Edhe mungesa e rregullave të qarta mund të shpjegonte se pse R. kishte vepruar në një mënyrë që kishte rrezikuar jetën e të birit të kërkuesit, gjë që nuk do të kishte ndodhur nëse ai do të kishte marrë trajnimin e përshtatshëm mbi mënyrën e reagimit në situata të tilla si ajo me të cilën ai ishte përballur.

Ky konstatim i përgjegjësive së Shtetit të akuzuar sipas Konventës nuk do të thotë që Gjykata po shprehte ndonjë mendim mbi pafajësinë e të tre gardianëve të burgut dhënë nga gjykatat e brendshme për shkaqe që lidhen me përgjegjësinë e tyre individuale penale.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 20,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Makaratzis kundër Greqisë* (GC), 50385/99, 20 dhjetor 2004, [Shënim Informativ 70](#); *Saoud kundër Francës*, 9375/02, 9 tetor 2007, [Shënim Informativ 101](#); *Renolde kundër Francës*, 5608/05, 16 tetor 2008, [Shënim Informativ 112](#); dhe *W.D. kundër Belgjikës*, 73548/13, 6 Shtator 2016, [Shënim Informativ 199](#))

### Neni 3

#### Trajtimi Çnjerëzor

Kushtet e ndalimit të të burgosurit të dënuar me kancer terminal, *shkelje*

*Dorneanu kundër Rumanisë* - 55089/13, Vendim Themeli 28.11.2017 (Seksioni IV)

**Faktet** – Duke qenë subjekt i procedimit penal qysh nga viti 2002, kërkuesi u shpall fajtor me vendim themeli përfundimtar në shkurt të vitit 2013 dhe u dënua me tre vjet dhe katër muaj heqje lirie.

Megjithëse ai ishte diagnostikuar me kancer në prostat të formës së avancuar në nëntor 2012, ai u pranua në burg në mars të vitit 2013 për të filluar dënimin e tij. Ai bëri menjëherë kërkesë si dhe në disa raste të tjera të mëvonshme për pezullimin e dënimit të tij. Në qershor 2013, gjykata e pranoi kërkesën e tij për një periudhë tre-mujore, por në gusht 2013 gjykata e apelit u shpreh që trajnimi i nevojshëm mjekësor mund të jepej në burg. Për marrjen e trajnimit, kërkuesi u transportua në mënyrë të përsëritur ndërmjet spitaleve dhe burgjeve, ndonjëherë edhe në distanca tepër të gjata. Kimioterapia atij iu zëvendësua me kujdes qetësues dhe ai vdiq në burg në dhjetor 2013.

**Ligji** – Neni 3 (*aspekti lëndor*)

(a) *Kushtet e përgjithshme të ndalimit*: Kushtet në të cilat kërkuesi ishte mbajtur e kishin bërë atë të përjetonte vuajtje tej nivelit të paevitueshëm të vuajtjes që është karakteristike për burgimin. Megjithëse kohëzgjatja e ndalimit të tij në më pak se 3 metra katrorë hapësirë personale kishte qenë e shkurtër, qelitë e zakonshme (ndërmjet 3 dhe 4 metra katrorë) nuk ishin të pajisura si duhet për të trajtuar paaftësinë e tij ekstreme, pasi afër fundit të jetës së tij ai humbi shikimin dhe dëgjimin, dhe vuante nga dhimbja në kocka.

(b) *Transportet e përsëritura*: Megjithëse kryesisht transportet ishin të justifikuara për arsye mjekësore, fakt ishte që institucionet përkatëse ishin në një distancë të largët, dhe ndonjëherë disa qindra kilometra larg. Duke patur parasysh që shëndeti i kërkuesit po përkeqësohej, këto ndryshime të përsëritura mund të nxisnin dhe të intensifikonin ndjenjën e ankthit në lidhje me qëndrueshmërinë e mjediseve të ndryshme të ndalimit, zbatimin e protokollit mjekësor për trajnimi e tij dhe për kontaktin e tij të vazhdueshëm me familjen. Në të njëjtën kohë, intensiteti i një vuajtjeje të tillë e tejkalonte nivelin e paevitueshëm të vuajtjes karakteristike të burgimit.

(c) *Kujdesi dhe ndihma cilësore*: Në momentin e pranimit të tij në burg, kërkuesi po vuante tashmë nga një sëmundje me një prognozë afatshkurtër fatale. Megjithëse ai ishte trajtuar në pajtim me udhëzimet e mjekut, autoritetet e brendshme asnjëherë nuk kishin menduar për mundësinë e dhënies së trajtimit në të njëjtin vend - që do të kishte kursyer kërkuesit një numër lëvizjesh - ose të paktën do të kishin kufizuar numrin e lëvizjeve dhe efektet e tyre të dëmshme për



mirëqenien e pacientit. Megjithatë, në fazat përfundimtare të sëmundjes, ndërsa nuk kishte shpresë për ulje dënimi, stresi karakteristik i jetës së burgut mund të ketë patur pasojë mbi jetëgjatësinë dhe gjendjen shëndetësore të të burgosurit.

Kishte ardhur një fazë e tillë që kërkuesi ishte dobësuar dhe rënë kaq shumë fizikisht dhe psikologjikisht që ai nuk ishte më në gjendje për të bërë detyrat e tij të përditshme bazë pa ndihmë dhe një i bashkë-burgosur ishte caktuar ta ndihmonte atë. Nuk ka prova që i burgosuri i cili kishte rënë dakord të ndihmonte kërkuesin ishte i kualifikuar për të ndihmuar personin me sëmundje terminale ose që kërkuesi kishte marrë mbështetjen e duhur morale dhe shoqërore apo këshillimin e duhur psikologjik, megjithëse ai ishte konstatuar që vuante nga depresioni.

*(d) Vazhdimi i burgimit në kushte të papërshtatshme ndalimi:* Kërkuesi ishte burgosur megjithë se ishte i sëmurë në mënyrë të pashërueshme dhe vuante efektet e një mjekimi të rëndë në kushte të vështira burgimi. Në një situatë të tillë, çdo mungesë kujdesi nga ana e autoriteteve e vendoste personin përkatës në një pozicion më të vështirë, duke e bërë për të të pamundur të ruante dinjitetin ndërsa sëmundja po shkonte drejt fundit të paevitueshëm.

Me përparimin e sëmundjes së kërkuesit, për të ishte bërë e pamundur të duronte mjedisin e burgut. Kështu, ishte përgjegjësia e autoriteteve të brendshme të merrte masa të posaçme mbi bazën e konsideratave humanitare.

Në lidhje me faktin nëse vazhdimi i burgimit të kërkuesit kishte qenë i përshtatshëm, Gjykata nuk mund të marrë rolin e gjykatave të brendshme, por, megjithatë, vëren që gjykata e apelit nuk kishte vënë në dukje ndonjë shkak të lidhur me kërcënimin që mund të shkaktohej nga lirimi i kërkuesit në kuptimin e mbrojtjes së komunitetit, duke patur parasysh gjendjen e tij. Ky dënim ishte i pari për kërkuesin ku ai kishte vuajtur një të tretën e një dënimi relativisht të lehtë; sjellja e tij gjatë gjykimit kishte qenë e mirë; atij i ishte dhënë regjimi më i favorshëm i burgimit; dhe duke patur parasysh gjendjen e tij shëndetësore, rreziku i recidivizmit mund të ishte vetëm minimal.

Autoritetet nuk kishin shqyrtuar nëse praktikisht kërkuesi ishte në gjendje të mbetej në burg në kushtet për të cilat ishte bërë ankesë. Gjykata e apelit ishte e mendimit që trajnimi i caktuar mund të jepej edhe në kushte ndalimi, por nuk kishte marrë parasysh kushtet dhe rrethanat praktike për administrimin e një mjekimi kaq të rëndë në situatën specifike të kërkuesit, kushtet për transportimin e tij tek mjediset e ndryshme të spitaleve dhe burgjeve, distancat

ndërmjet këtyre mjediseve, numrin e spitaleve tek të cilët ai ishte pranuar për të marrë trajtimin ose ndikimin e këtij kombinimi faktorësh në gjendjen e tij tashme tepër të dobët. Duke patur parasysh natyrën tepër të veçantë të këtyre rrethanave të çështjes, këta faktorë duhej të ishin shqyrtuar, qoftë edhe vetëm për shkaqe humanitare, me qëllim që të vlerësohet nëse gjendja shëndetësore e kërkuarit ishte e përshtatshme për kushtet e ndalimit.

Asnjë argument nuk ishte dhënë në lidhje me pamundësinë e autoriteteve vendase për të trajtuar këto rrethana tepër të veçanta duke matur parasysh konsideratat urgjente humanitare që ato shpalosnin. Përkundrazi, procedurat e ndjekura kishin caktuar si prioritet formalitetet, duke e penguar kërkuarin që po vdiste të kalonte ditët e tij të fundit me dinjitet. Përveç kësaj, kohëzgjatja e procedurës për pezullimin e dënimit për shkaqe shëndetësore ishte e tepërt për një pacient me sëmundje të pashërueshme, dhe përgjigjet nga autoritetet e burgut ndaj kërkesave të kërkuarit për ndihmë në garantimin e lirisë së tij ishin karakterizuar nga një mungesë konsiderate për gjendjen e tij.

Si përfundim, kushtet e ndalimit që duhej të duronte kërkuari ndërsa vuante nga një sëmundje e pashërueshme përbënin një trajnim çnjerëzor.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 9 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar të të birit të kërkuarit; rrezohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar.

(Shih gjithashtu *Gülay Çetin kundër Turqisë*, 44084/10, 5 mars 2013, [Shënim Informativ 161](#); shih gjithashtu Dokumentin Faktik mbi [Të drejtat shëndetësore të të burgosurve](#))

### Neni 3

#### Trajtimi poshtëruar

#### Trajtimi Çnjerëzor

Kushtet e ndalimit për shkak emigrimi për të miturit e pashoqëruar: shkelje

**S.F. dhe të Tjerë kundër Bullgarisë - 8138/16**, Vendim themeli 7.12.2017 [Seksioni V]

**Faktet** – Kërkuesit, tre të mitur irakenë që u arratisën nga Iraku të shoqëruar nga prindërit e tyre, u pikasën nga policia tek kufiri bullgaro-serb dhe u ndaluan (së bashku me prindërit e tyre) në një qendër ndalimi policore në qytetin e Vidinit (Bullgari). Në vijim ata u transferuan tek një qendër ndalimi emigrimi në Sofia dhe më vonë iu dha azil në Zvicër.

Para Gjykatës Europiane, kërkuesit pretenduan që kushtet e ndalimit të tyre tek qendra e pritjes në Vidin kishin qenë për ta një trajnim çnjerëzor dhe poshtërues në kundërshtim me Nenin 3.

**Ligji** – Neni 3: Ndalimi në qendrat pritëse për të miturit ngrinte shqetësime të posaçme, pasi fëmijët, qofshin të shoqëruar apo jo, ishin tepër të dobët dhe kishin nevoja specifike.

Periodha në fjalë në këtë çështje ishte ndërmjet tridhjetë e dy dhe dyzet e një orë. Kjo periudhë kohore ishte shumë më e shkurtër nga periudhat e diskutuara në çështjet e fundme, ku Gjykata kishte shqyrtuar kushtet në të cilat ishin mbajtur të miturit e shoqëruar në qendrat e pritjes. Megjithatë, kushtet në mjediset e ndalimit të policisë kufitare ishin tepër më të këqija se në ato çështje. Qelia në të cilën ishin mbajtur kërkuesit, megjithëse relativisht e ajrosur mirë dhe e ndriçuar, ishte tepër e shkatërruar. Ishte e pistë dhe kishte krevate marinari, dyshekë dhe çarçafë të grisur, ndërsa dyshemeja ishte e mbushur me plehra dhe kartonë të lagur. Kishte mundësi të pakta për të shkuar në banjë gjë që i kishte detyruar ata të urinonin në dyshemenë e qelisë në të cilën ata mbaheshin. Pretendohet se autoritetet nuk u kishin dhënë ushqim dhe ujë kërkuesve për më shumë se njëzet e katër orë pas ndalimit të tyre dhe Qeveria nuk e kundërshtoi pretendimin që nënës së kërkuesve i ishte dhënë mundësia e një shisheje dhe qumështit për kërkuesin më të vogël, i cili ishte një vit e gjysmë, rreth nëntëmbëdhjetë orë pasi ata ishin ndaluar.

Kombinimi i faktorëve të sipër-përmendur duhet të kenë ndikuar së tepërmi tek kërkuesit, fizikisht dhe psikologjikisht, dhe duhet të ketë patur efekte tepër të rënda për kërkuesin më të vogël duke patur parasysh moshën e tij tepër të re. Ndërsa është e vërtetë që në vitet e fundit Shtetet Sovrane Kontraktuese që ishin në kufijtë e jashtëm të Bashkimit European kishin vështirësi në trajtimin e fluksit masive të migrantëve, nuk mund të thuhet që në këtë moment Bullgaria po haste ndonjë emergjencë të këtyre raporteve dhe që ishte praktikisht e pamundur për autoritetet e saj të garantonin kushtet e duhura minimale në

qendrat afat-shkurtra të pritjes në të cilat ata vendosën të sistemonin migrantët e mitur menjëherë pas gjetjes dhe arrestimit të tyre. Sidoqoftë, duke patur parasysh karakterin absolut të Nenit 3, një fluks në rritje i migrantëve nuk mund të lironin një Shtet Sovran Kontraktues nga detyrimet e tij sipas kësaj dispozite.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 600 EUR secili në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë* [GC], 16483/12, 15 dhjetor 2016, [Shënim Informativ 202](#); *Muskhadzhiyeva dhe të tjerë kundër Belgjikës*, 41442/07, 19 janar 2010, [Shënim Informativ 126](#); dhe *R.M. dhe të tjerë kundër Francës*, [33201/11](#), 12 korrik 2016)

## Neni 5

### Nenet 5-4 Rishikimi i ligjshmërisë së ndalimit

Prëzimi i ankimit të të burgosurit të dënuar në lidhje me vazhdimin e dënimit pa i dhënë mundësi atij për t'iu përgjigjur parashtrimeve të zyrës së prokurorisë: *Neni 5, par 4, i zbatueshëm; shkelje*

***Stollenwerk kundër Gjermanisë - 8844/12***, Vendim Themeli 7.9.2017 (Seksioni V)

**Faktet** – Kërkuesi u arrestua dhe u fut në paraburgim në lidhje me vepra penale me narkotikët. Vendimi për ta ndaluar ata u rishikua në tetë raste. Kërkuesi u shpall fajtor në gjyq dhe iu dha një vendim me heqje lirie. Ai bëri ankim. Gjykata e faktit nxori një urdhër shtesë që urdhëronte ndalimin e tij.\* Kërkesa e kërkuesit ndaj urdhrit dhe kërkesa e tij pasuese për një seancë u rrëzuan nga Gjykata e Apelit.

Në gjykimin sipas Konventës, kërkuesi u ankua që gjykimi para gjykatës së apelit nuk ishte i drejtë, pasi kjo gjykatë, në shkelje të parimit të barazisë së armëve, kishte shqyrtuar ankimin e tij kundër urdhrit për vazhdimin e ndalimit dhe kërkesën për një seancë pa i dhënë atij një mundësi për t'iu përgjigjur parashtrimeve me shkrim të Kryeprokurorit Publik.

**Ligji** – Neni 5, par 4: Procedimi që ishte bërë shkak për vendimin e gjykatës së apelit për të mos e liruar kërkuesin në pritje të rezultatit të ankimit në lidhje me faktet e çështjes, kishte filluar pas vendimit përfundimtar të gjykatës së faktit që e shpallte atë fajtor. Për pasojë, Nenet 5, par 1(c) dhe 5, par 3, të Konventës nuk vazhdonin të zbatoheshin në lidhje me ndalimin e kërkuesit.

Megjithëse, Neni 5, par 4, i Konventës, nuk ka efekt në lidhje me ndalimin e rregulluar nga Neni 5, par 1 (a) të Konventës (ndalimi i ligjshëm pas shpalljes fajtor nga një gjykatë kompetente), ky zbatohet në rastin e kërkuesit, pasi ligji i brendshëm parashikonte që një person futet në paraburgim derisa dënimi i tij ose i saj të marrë formë të prerë, duke përfshirë gjykimin në apel dhe i jepen të njëjtat të drejta si garanci procedurale si dhe të gjithë të paraburgosurve të tjerë. Nëse një Shtet Kontraktues parashikon procedura të cilat shkojnë tej kërkesave të Neni 5, par 4, i Konventës, garancitë e dhëna nga kjo dispozitë duhej të respektoheshin në këto procedura.

Nuk diskutohej që Gjykata e Apelit i kishte marrë vendimet e saj në lidhje me vazhdimësinë e ndalimit të kërkuesit dhe kërkesën e tij për një seancë pasuese pa e informuar atë në lidhje me parashtrimet me shkrim të autoriteteve të prokurorisë dhe pa i dhënë atij mundësinë për të mbajtur qëndrim mbi to. Me qëllim që gjykimi në apel të jetë ‘në pajtim me parimin e kontradiktoritetit’ dhe që të garantohet barazia e armëve, një palë duhej të informohej nëse parashtrimet ishin paraqitur nga një palë tjetër dhe t’i jepej një mundësi reale për të komentuar. Përveç kësaj, meqenëse kjo ishte hera e parë që Gjykata e Apelit dhe Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ishte përfshirë në gjykim, kërkuesi duhej të dinte qëndrimet e tyre në lidhje me ndalimin e tij.

Kështu gjykimi nuk mbështetej në parimin e kontradiktoritetit dhe parimi i barazisë së armëve ishte shkelur.

**Përfundimi:** shkelje (katër vota me tre)

Neni 41: konstatimi i një shkeljeje përbënte një kompensim të drejtë dhe të mjaftueshëm në lidhje me dënimin jo-financiar.

\*Sipas ligjit gjerman, një person futet në paraburgim, jo pas dënimit, derisa dënimi i tij ose i saj të marrë formë të prerë, duke përfshirë gjykimin në apel.

## Neni 5

### Neni 5-1 Arrestimi ose ndalimi i ligjshëm

Mosbërja nga autoritetet e përpjekjeve të arsyeshme për të informuar kërkuesen në lidhje me gjykimin kundër saj dhe domosdoshmërinë par tu paraqitur para tyre: *shkelje*

**Vasiliciuc kundër Republikës së Moldavisë - 15944/11**, Vendim themeli 2.5.2017 (Seksioni II)

**Faktet** – Kërkuesja, një shtetase moldave që banon në Greqi, u ndalua dhe u morr në pyetje në aeroportin e Chisinaut në lidhje me sendet e çmuara që ajo kishte me vete. Pas kthimit të saj në Greqi, filloi gjykimi penal ndaj saj për tentative kontrabande sendesh të çmuara dhe në vijim u thirr të paraqitej nëpërmjet adresës së saj moldave. Më 19 qershor 2009, një gjykatë rrethi moldave urdhëroi ndalimin e kërkueses për shkak se ajo nuk u paraqit para autoriteteve hetimore pas thirrjes. Kërkuesja u vu në dijeni të urdhit të ndalimit dhe kërkoi revokimin e tij me argumentimin që ajo nuk ishte në dijeni të gjykimin penal në ngarkim të saj. Kërkesa e saj nuk u pranua ndërsa ankimi u rrëzua. Në vitin 2011, kërkuesja u arrestua në Greqi në bazë të një urdhri ndërkombëtar arresti dhe u mbajt në ndalim në pritje të procedurave të ekstradimit për një periudhë prej 23 ditësh.

Në gjykimin në bazë të Konventës, kërkuesi u ankua në bazë të Nenit 5 që urdhri i ndalimit i nxjerrë ndaj saj nga autoritetet moldave nuk ishin bazuar në shkaqe relevante dhe të mjaftueshme.

**Ligji** – Neni 5, par 1

(a) *Pranueshmëria* - Kërkuesi ishte nën kontrollin dhe juridiksionin e autoriteteve greke në periudhën ndërmjet arrestit të saj në Greqi dhe liritë të saj pas ndalimit. Heqja e lirisë e kishte origjinën e saj në masat e marra nga autoritetet moldave, që ishte urdhri ndërkombëtar i arrestit i lëshuar nga Interpoli me kërkesë të tyre. Në kontekstin e një procedure ekstradimi, një Shtet i kërkuar duhet të jetë në gjendje të prezumojë vlefshmërinë e dokumenteve ligjore të lëshuara nga Shteti kërkues dhe në bazë të të cilëve është kërkuar heqja e lirisë. Për më tepër, vendi që kërkon ekstradimin duhet të garantonte që kërkesa për ndalim dhe ekstradim të ishte e ligjshme, jo vetëm në bazë të ligjit të brendshëm, por edhe në bazë Konventës. Rrjedhimisht, akti ndaj të cilit

kërkuesi ka bërë ankim, duke qenë i nxitur nga Moldavia në zbatim të ligjit të tij të brendshëm dhe i pasuar nga Greqia në përmbushje të detyrimeve të saj ndërkombëtare, duhej ti atribuohet Moldavisë, pavarësisht se akti u ekzekutua në Greqi.

(b) *Faktet* - Heqja e lirisë së kërkueses në Greqi ishte një pasojë e drejtpërdrejtë e urdhrit të ndalimit të datës 199 qershor 2009 dhe në Greqi nuk do të kishte qenë e mundur asnjë heqje lirie në mungesë të një urdhri të tillë. Ky fakt është theksuar shprehimisht nga gjykatat greke në vendimet e tyre në lidhje me ekstradimin e kërkueses. Ndalimi i kërkuesit në Greqi, megjithëse formalisht për qëllimin e ekstradimit të saj, ishte pjesë e mekanizmit të përdorur nga autoritetet moldave për të zbatuar urdhërimin e ndalimit jashtë kufijve të Moldavisë.

Shkaku për urdhërimin e ndalimit të kërkueses që parashtrohej nga gjykatat moldave ishte fakti që kërkuesi nuk ishte paraqitur para autoriteteve hetimore kur ishte thirrur. Megjithatë, kërkuesja ishte larguar nga vendi në mënyrë të ligjshme, në një moment kur nuk kishte filluar procedimi penal në ngarkim të saj. Autoritetet kishin filluar procedimin penal vetëm pas largimit të saj nga vendi. Ajo u kishte dhënë autoriteteve informacionin e saj të kontaktit në Greqi, por megjithë këtë prokurorët kishin dërguar fletëthirrje në adresën e saj moldave. Prokurorët nuk kishin bërë asnjë përpjekje të ndiqnin informacionin që ajo ishte në Greqi dhe nuk kishin bërë asnjë përpjekje të arsyeshme për ta informuar atë për procedimin penal dhe domosdoshmërinë për tu paraqitur para tyre.

Autoritet kishin zgjedhur të mbanin që qëndrim formalist ndaj problemit të thirrjes së kërkueses dhe kur ajo nuk ishte paraqitur, ato nxorën shpejt përfundimin që ajo i fshihej drejtësisë. Refuzimi i gjykatave të brendshme për të verifikuar parashtrimet e kërkueses në lidhje me thirrjen e papërshtatshme dhe për ti dhënë asaj një mundësi për tu paraqitur para autoriteteve e bindën Gjykatën që ndalimi i kërkueses nuk mund të konsiderohej i nevojshëm dhe pa arbitraritet.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 3,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

## Neni 5

### Nenet 5-4 Rishikimi i ligjshmërisë së ndalimit

Mosgarantimi i barazisë së armëve në shqyrtimin e apelit të pranuar të bërë nga prokuroria Neni 5, par 4, i zbatueshëm; shkelje

**Oravec kundër Kroacisë - 51249/11**, Vendim Themeli 11.7.2017 (Seksioni II)

**Faktet** - Në prill të vitit 2011 kërkuesi u arrestua dhe ndalua i dyshuar për trafik narkotikësh. Në vijim ai u lirua me urdhër të gjyqtarit hetimor. Ky vendim u rrëzua pas një ankimi të prokurorisë dhe më 31 maj 2011 gjyqtari e rishqyrtoi çështjen dhe konfirmoi vendimin e tij të mëparshëm. Prokuroria bëri ankim i cili nuk iu komunikua kërkuesit apo avokatit të tij. Më 10 qershor 2011, një trup gjykues me tre gjyqtarë zhvilloi një seancë me dyer të mbyllura në mungesë të palëve. Ata e shfuqizuan vendimin e gjyqtarit hetimor dhe urdhëruan paraburgimin e kërkuesit. Më 14 qershor 2011, kërkuesi u ri-sistemua në paraburgim. Ankimet e tij në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese nuk ishin të suksesshëm.

Para Gjykatës Europiane, kërkuesi u ankua, ndër të tjera, që zhvillimi i gjykimit ne apel kishte shkelur parimin e barazisë së armëve, të garantuar nga Neni 5, par 4.

**Ligji** – Neni 5, par 4: Kërkuesi u lirua nga paraburgimi në zbatim të urdhrit të datës 31 maj 2011. Megjithatë, vendimi i gjyqtarit hetimor iu nënshtrua rishikimit të mëtejshëm pas një ankimi dhe nuk kishte marrë formë të prerë. Në fakt u bë një ankim nga prokuroria kundër vendimit të gjyqtarit hetimor. Duke synuar rrëzimin e këtij vendimi, zyra e prokurorisë, nëpërmjet gjykimit në apel, kërkoi lënien në fuqi të urdhrit fillestar të ndalimit. Nëse ankimi i prokurorisë do të ishte rrëzuar, vendimi për lirimin e kërkuesit do të kishte marrë formë të prerë; meqenëse ai u pranua, kërkuesi u vendos përsëri në paraburgim. Në këtë mënyrë ankimi përfaqësonte vazhdimin e gjykimit në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të kërkuesit. Në këto rrethana, rezultati i gjykimit në apel ishte një faktor thelbësor në vendimin në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të kërkuesit, pavarësisht nëse në atë moment konkret kërkuesi ishte apo nuk ishte i ndaluar. Kështu, Neni 5, par 4, ishte i zbatueshëm në lidhje me gjykimin në apel.

Një gjykatë që shqyrton një ankim ndaj një vendimi në lidhje me ndalimin duhej të ofronte garancitë e një procedure gjyqësore. Gjykimi duhej të mbështetej



në parimi e kontradiktoritetit dhe të siguronte barazinë e armëve ndërmjet palëve. Duke patur parasysh ndikimin dramatik të heqjes së lirisë mbi të drejtat themelore të personit përkatës, gjykimi i zhvilluar në pajtim me Nenin 5, par 4, duhet të përmbushte, më masën më të madhe të mundshme në rrethanat e një hetimi në vazhdim, kërkesat bazë të një gjykimi të drejtë, si e drejta për një proces mbi bazë kontradiktoriteti.

Në ankimin e saj ndaj vendimit të gjyqtarit hetimor që urdhëron lirimi e kërkuetit, prokuroria paraqiti arsye të shumta për urdhërimin e ndalimit. Ankimi nuk iu komunikua mbrojtjes dhe në këtë mënyrë, kërkueti nuk kishte mundësi tu përgjigjej argumenteve të paraqitura nga zyra e prokurorisë. Trupi gjykues me tre gjyqtarë që urdhëroi ndalimin e kërkuetit më 10 qershor 2011 e bëri këtë në një seancë të mbyllur pa informuar, dhe aq më pak ftuar, kërkuetin ose përfaqësuesin e tij dhe në këtë mënyrë nuk iu dha mundësia për të paraqitur argumente në lidhje me ndalimin e tij. Meqenëse mbrojtja nuk ishte në gjendje të paraqiste ndonjë argument në gjykatë për këtë gjykim, qoftë me shkrim apo me gojë, kërkueti nuk mund të ushtronte me efektivitet të drejtat e tij të mbrojtjes në gjykim. Nuk ishte respektuar parimi i barazisë së armëve.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Gjykata gjithashtu konstatoi një shkelje tjetër të Nenit 5, par 4, në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa nuk gjeti shkelje të Nenit 5, par 1, në lidhje me mosçaktimin nga ana e trupit gjykues të një afati kohor për ndalimin e kërkuetit.

Neni 41: 500 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih *Fodale kundër Italisë*, 70148/01, 1 qershor 2006, [Shënim Informativ 87](#))

## **Neni 6 Gjykimi civil**

### **Neni 6-1 Aksesi në gjykatë**

Pretendimi i pretenduar i interpretuar në mënyrë tepër formale i rregullave procedurale (*ratione valoris* Pragu i pranueshmërisë): *Nuk ka shkelje*

***Zubac kundër Kroacisë (GC) - 40160/12***, Vendim Themeli 5.4.2018 (GC)

**Faktet** - Çështjet civile sillen para Gjykatës së Lartë kroate bazohen në një ankim për çështjet të ligjit, që mund të jetë: (i) ankim ‘i zakonshëm’ për çështje të ligjit, një e drejtë e plotë individuale kur pjesa e kundërshtuar e vendimit të ankimuar përfaqëson një vlerë që kalon një prag të caktuar, që në momentin përkatës ishte 100 000 kuna kroate (HRK); ose (ii) në mungesë të kësaj, një ankim ‘i jashtëzakonshëm’ për çështje të ligjit që synon garantimin e interpretimit të njëtrajtshëm të ligjit. Në çdo rast, ankimi kufizohet në çështje të ligjit.

Kërkuesja ngriti padi civile, objekti i të cilës u vlerësua nga avokati i saj i parë të ishte 10 000 HRK (rreth 1 400 Euro). Pasi kërkuesja zëvendësoi avokatët, palët shkëmbyen parashtrimet në seancën fillestare mbi themelin. Në seancën pasuese, avokati ri-vlerësoi objektin me 105 000 HRK. Megjithatë, ‘pretendimi civil’ i përmendur në padi mund të ndryshohej vetëm me një vendim të posaçëm të gjykatës që nuk ishte i mundur në atë fazë. Sidoqoftë, gjykatat e faktit e përdorën shifrën e re në përlllogaritjen e tarifave gjyqësore. Ankimi i kërkueses për çështje të ligjit u rrëzua nga Gjykata e lartë, që e deklaroi atë të papranueshëm *ratione valoris* për shkak se objekti i treguar në dokumentin e pretendimit të shkallës së parë nuk ishte ndryshuar në mënyrë të vlefshme.

Para Gjykatës Europiane, kërkuesja pretendoi që, në shkelje të Nenit 6, par 1, të Konventës, ajo ishte penguar në aksesin e saj në Gjykatën e Lartë. Në një vendim të datës 6 shtator 2016 ([Shënim Informativ](#)) një Dhomë e Gjykatës konstatoi një shkelje të asaj dispozite në një raport prej katër votash me tre.

**Ligji** – Neni 6, par 1

(a) *Kufizimi i kundërshtuar*: Kufizimi në fjalë nuk ishte rezultat i rregullave procedurale jo fleksible: ligji përkatës dhe praktika lejonin mundësinë e ndryshimit të objektit të mosmarrëveshjes; kërkuesi kishte gjithashtu të drejtën të bënte ankime të ‘jashtëzakonshme’ për çështje të ligjit, por nuk e kishte bërë këtë.

(b) *Legjitimiteti i qëllimit të ndjekur*: Funkzioni kryesor i Gjykatës së Lartë ishte të garantonte zbatimin e unifikuar të ligjit dhe barazinë e të gjithëve para gjykatës. Kështu, caktimi i një pragu specifik *ratione valoris* synonte në mënyrë të ligjshme të garantonte që Gjykatës së Lartë ti kërkohej të trajtonte vetëm çështjet e një niveli të rëndësisë që ishin në përputhje me rolin e saj. Për më tepër, rishikimi nga ajo gjykatë e parregullsive të kryera nga gjykatat e ulëta në

caktimin e vlerës së mosmarrëveshjes ishte gjithashtu një shqetësim legjitim, në lidhje me shtetin e së drejtës dhe administrimin e duhur të drejtësisë.

(c) *Proporcionaliteti i pengesës*: Në këtë çështje, Shtetit të paditur duhej ti jepej një marzh i gjerë vlerësimi: (i) çështja e kërkueses ishte shqyrtuar nga dy shkallë juridiksioni; (ii) çështja nuk ngrinte ndonjë çështje padrejtësie; (iii) dhe roli i Gjykatës së Lartë ishte kufizuar në rishikimin e zbatimit të duhur të ligjit të brendshëm nga gjykatat e ulëta.

Për shkaqet e përcaktuara më poshtë: marzhi i vlerësimit nuk ishte tejkaluar.

Së pari, kushtet për lejimin e një ankimi për çështje të ligjit ishin të parashikueshme. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë ishte e konsoliduar dhe e qartë: nëse gabimi në fjalë u vishej gjykatave më të ulëta ose një prej palëve, kur vlera e objektit të mosmarrëveshjes ndryshohej në mënyrë të paligjshme në një fazë të avancuar të gjykimit, nuk lejohej ankim për çështje të ligjit. Për më tepër, ligji kërkonte një vendim të posaçëm gjyqësor me qëllim që të ndryshohet vlera e objektit të mosmarrëveshjes.

Në çështjen konkrete, në kohën kur një vendim i tillë mund të ishte kërkuar në mënyrë të vlefshme dhe kur kërkuësja do ta kishte bërë këtë kërkesë, ajo ishte përfaqësuar nga një avokat i kualifikuar që e ushtronte profesionin në Kroaci, i cili prezumohej të njihje ligjin dhe praktikën gjyqësore kroate.

Për pasojë, megjithëse gjykatat e ulëta në vijim dukej se e praninin vlerën e rritur të objektit (të paktën për qëllimet e llogaritjes së tarifave gjyqësore), kërkuësja dhe avokati i saj kishin qenë në gjendje të kuptonin që ndryshimi i vonuar i vlerës së objektit të mosmarrëveshjes do të përjashtonte aksesin në Gjykatën e Lartë.

Së dyti, gabimet që kishin penguar aksesin e kërkueses në Gjykatën e Lartë i visheshin, kryesisht dhe objektivisht, asaj, e përfaqësuar nga një avokat:

- fakti që avokati i parë i kërkueses, e ushtronte profesionin në Malin e Zi më shumë se në Kroaci, kjo ishte një çështje thjesht e zgjedhjes së saj të lirë të përfaqësuesit ligjor; ajo mund të konsultohet lehtësisht me një avokat kroat, gjë që ajo e kishte bërë më vonë;

- disproporcioni i pretenduar ndërmjet vlerës së treguar në dokumentin e pretendimit dhe vlerës reale të pronës në fjalë ishte i parëndësishëm; kërkuësja

kishte të drejtë të caktonte vlerën e mosmarrëveshjes në një shumë që jo domosdoshmërisht përputhej me vlerën e tregut të pronës;

- do të kishte qenë e mundur të modifikohesh vlera e treguar fillimisht deri në momentin e paraqitjes së argumenteve lëndore të mbrojtjes, por kërkesja nuk e bëri këtë, megjithëse përfaqësohej nga një avokat kroat;

- zëvendësimi i avokatit nga kërkesja nuk e pengonte avokatin e ri që të kërkonte personalisht ndryshimin e vlerës së objektit të mosmarrëveshjes qysh herët, në seancën e parë të themelit.

Bazuar në njohurinë e plotë të fakteve përkatëse, interpretimi i Gjykatës së Lartë të ligjit përkatës të brendshëm nuk do të dukej të ishte arbitrar ose haptazi e paarsyetuar.

Gabimi procedural i kërkueses nuk mund të justifikohesh nga gabimi pasues i kryer nga gjykatat, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës dhe kërkesën e zhvillimit të kujdesshëm dhe të përshtatshëm të gjykimit dhe zbatimit e kujdesshëm të rregullave përkatëse procedurale.

Kërkesja nuk mund të kishte ndonjë pritshmëri të ligjshme të rrjedhur nga rritja e tarifave gjyqësore që ajo kishte paguar, thjesht si pasojë e sjelljes së saj, dhe për rimbursimin e të cilave ajo mund të kishte bërë kërkesë.

Së treti, nuk mund të konfirmohet që kur Gjykata e Lartë deklaroi të papranueshëm ankimin e kërkueses për çështje të ligjit, ajo kishte aplikuar një formalizëm të tepërt. Në një situatë kur ligji i brendshëm i ka lejuar filtrimin e çështjeve që vijnë para saj, të thuhet që gjykata duhet tu përmbahet gabimeve të bëra nga gjykatat më të ulëta mund të pengojë punën e saj në masë të konsiderueshme dhe ta bëjë të pamundur për të përpushur rolin e saj specifik.

Në mungesë të një arsyeje për të hedhur dyshime mbi kuadrin procedural të vendosur me ligj për të treguar vlerën e objektit të mosmarrëveshjes, nuk mund të thuhet që zbatimi i dispozitave detyruese në fjalë ishte e barsvlershme me formalizmin e tepruar. Përkundrazi, kjo kishte forcuar sigurinë ligjore dhe administrimin e duhur të drejtësisë: Gjykata e Lartë kishte rikthyer shtetin e së drejtës pas gabimeve të kryera nga kërkuesi dhe nga dy gjykatat e ulëta për një çështje që prekte juridiksionin e saj. Meqenëse shteti i së drejtës ishte një parim themelor i demokracisë dhe i Konventës, nuk mund të pritej që, në bazë

të Konventës apo të një shkakut tjetër, Gjykata e Lartë të mund të injoronte ose të mos merrte parasysh parregullsitë e mëparshme procedurale.

\*\*\*

Në tërësi, nuk ka patur pengesë disproporcionale që të ketë cenuar thelbin e të drejtës së kërkueses për akses në gjykatë ose të tejkalimit të marzhit të brendshëm të vlerësimit.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

## Neni 6

### Neni 6 - Prezumimi i pafajësisë

Veprat penale për të cilat është ndërprerë gjykimi penal të marra parasysh në procesin e dëmit: *Nuk ka shkelje*

***Bikas kundër Gjermanisë - 76607/13***, Vendim Themeli 25.1.2018 (Seksioni V)

**Faktet** - Kërkuesi ishte shpallur fajtor për katër raste shtrëngimi për tu përfshirë në marrëdhënie seksuale dhe dënuar me gjashtë vjet burgi. Para Gjykatës Europiane ai pretendoi që prezumimi pafajësisë ishte shkelur pasi gjykata, në caktimin e dënimit, kishte marrë parasysh edhe vepra të tjera penale për të cilat ai nuk ishte fajësuar.

**Ligji** – Neni 6, par 2

(a) *Pranueshmëria*: Fillimisht kërkuesi ishte ‘akuzuar’, për qëllimet e Nenit 6 par 2, për kryerjen e një numri të madh veprash penale, duke përfshirë të paktën pesëdhjetë raste të tjera shtrëngimi për tu përfshirë në aktivitet seksual, duke ditur që ai ishte shpallur fajtor dhe dënuar në gjykimin para Gjykatës Rajonale për ato vepra penale. Në një vendim të marrë në ditën e fundit të gjyqit, Gjykata Rajonale kishte ndërpretë provizorisht gjykimin penale për ato vepra penale në bazë të Nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale. Në bazë të kësaj dispozite, gjykimi mund të ndërpritej në mënyrë provizore, pasi dënimi që mund të kishte rrjedhur nga ndjekja penale e pesëdhjetë veprave penale nuk konsiderohej të ishte tepër e konsiderueshme tej dënimit që kërkuesi mund të priste për katër veprat e mbetura të shtrëngimit për tu përfshirë në aktivitet

seksual. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore gjermane kjo ndërprerje nuk përjashtonte konsiderimin e tyre si rrethanë rënduese në procesin e dënimit në rast shpalljeje fajësie, nëse ekzistenca e tyre do të ishte provuar në masë të mjaftueshme. Kërkuesi ishte paralajmëruar që ato raste të shtrëngimit mund të merreshin parasysh në fazën e dënimit për katër rastet e mbetura. Gjykata Rajonale e bëri këtë në procedurën e dënimit. Në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata Rajonale provoi gjerësisht provat në lidhje me pesëdhjetë vepra të tjera penale dhe përsëriti që ishte e bindur që ato kishin ndodhur.

Në këto rrethana, në kohën kur Gjykata Rajonale mori parasysh pesëdhjetë incidentet e tjera të shtrëngimit për përfshirje në aktivitet seksual, kërkuesi duhej të konsiderohej si i njoftuar për një pretendim që ai ishte i përfshirë në raste të tjera të shtrëngimit për përfshirje në aktivitet seksual, duke qenë kështu ‘i ngarkuar’, *ndër të tjera*, me pesëdhjetë veprat e tjera penale në fjalë. Neni 6, par 2, që zbatohet para së gjithash në kontekstin e gjykimit penal të papërfunduar, zbatohet po ashtu edhe në gjykimin në falë.

(b) *Themeli*: Në përcaktimin e kërkesave për përputhshmëri me prezumimin e pafajësisë, Gjykata kishte bërë dallimin ndërmjet çështjeve kur ishte dhënë një vendim përfundimtar pafajësie dhe atyre kur gjykimi penal ishte ndërprerë. Në çështjet në lidhje me deklaratimet e bëra pasi një vendim pafajësie të ketë marrë formë të prerë, Gjykata kishte mendimin që shprehja e dyshimeve në lidhje me pafajësinë e të akuzuarit nuk ishte e pranueshme. Nga ana tjetër, prezumimi i pafajësisë do të shkelej vetëm në rastet e deklaratimeve pas ndërprerjes së gjykimit penal nëse, ndërsa fajësia e të akuzuarit nuk është provuar sipas ligjit dhe, veçanërisht, pa patur mundësinë e ushtrimit të së drejtës së mbrojtjes, një vendim gjyqësor në lidhje me të shprehte një konsideratë që ai ishte me faj. Një vendim gjyqësor mund ta reflektojë këtë konsideratë edhe në mungesë të një konstatimi formal të fajit; është e mjaftueshme nëse ka një arsyetim që tregon që gjykata e ka konsideruar të akuzuarin me faj.

Në rastet e përputhshmërisë me prezumimin e pafajësisë, gjuha e përdorur nga vendim-marrësi do të ishte e një rëndësie vendimtare në vlerësimin e përputhshmërisë së vendimit dhe arsytimit të tij me Nenin 6, par 2. Në këtë aspekt, rëndësi duhej ti kushtohej natyrës dhe kontekstit të gjykimit të posaçëm në të cilat janë bërë deklaratimet e kundërshtuara. Ndërprerja provizore e gjykimit, veçanërisht, në lidhje me pesëdhjetë ngjarjet e tjera, kishte ndodhur në ditën e fundit të gjykimit, pas shtatëmbëdhjetë ditësh

nga marrja e provave, dhe në të njëjtën ditë në të cilën është dhënë vendimi përfundimtar. Të gjitha të drejtat e mbrojtjes së kërkuesit ishin marrë parasysht gjatë gjykimit. Në momentin e ndërprerjes provizore të gjykimit, për shkak të ekonomisë procedurale, kërkuesi ishte paralajmëruar që ngjarjet përkatëse mund të përdroreshin gjatë procesit të dënimit.

Vendimi që fokusohej në katër ngjarje dhe duke marrë parasysht, në caktimin e masës së dënimit, pesëdhjetë vepra të tjera penale përshkruante faktet e provuara gjatë gjithë periudhës kohore që veprat e pretenduara kishin ndodhur. Gjykata Rajonale theksoi disa herë në vendimin e themelit që ajo ishte e bindur që pesëdhjetë veprat e tjera kishin ndodhur, por nuk ishte e mundur të jepeshin specifikat në lidhje me vendin dhe kohën e saktë për të gjitha këto ngjarje. Gjykata Rajonale në këtë mënyrë ka dhënë një vendim në të cilin ajo shpall shprehimisht fajtor të akuzuarin për katër raste të shtrëngimit për përfshirje në aktivitet seksual. Ndërsa të katër incidentet përmendeshin shprehimisht në pjesën përshkruese të vendimit, pesëdhjetë incidentet e tjera përshkruheshin në arsyetimin e vendimit dhe ishin marrë parasysht si element rëndues në përcaktimin e masës së dënimit.

Gjykata Rajonale mund të thuhet se, në bazë të së drejtës së brendshme, ka aplikuar standarde të larta, por të ndryshme prove për përcaktimin e fajësisë së kërkuesit në lidhje me këto incidente. Ndërsa për katër incidentet e parë gjykata kishte të gjithë elementet për të përcaktuar krimet si vepra penale në kuptimin procedural, për pesëdhjetë incidentet e tjera në lidhje me të cilët ajo ndërpreu gjykimin, ajo ishte e bindur që i akuzuari ishte fajtor, por ajo nuk mund të gjente kohën dhe vendin e saktë në të cilin incidentet kishin ndodhur për shkak të çrregullimeve të viktimës në të shprehur. Në këtë kontekst, Gjykata mori parasysht që pesëdhjetë incidentet e tjera, siç ishte theksuar nga Gjykata Rajonale, ishin vërtet të ngjashme dhe të lidhura ngushtë: ato kishin të bënin të gjitha me të njëjtin tip vepre penale, d.m.th., shtrëngimin për tu angazhuar në aktivitet seksual; ato ishin kryer mbi të njëjtën viktimë brenda një periudhe të caktuar, me të njëjtin synim të abuzimit seksual. Kjo mbështeste konstatimin që në një rast të tillë, duke patur parasysht që ndodhia e veprimeve ishte provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk ishte e nevojshme të përcaktohej koha dhe vendi i saktë i çdo veprimi të kryer. Kështu, gjykatat kishin përmbushur kërkesat që ishin vendosur nga praktika gjyqësore e gjykatave të brendshme, në lidhje me vlerësimin e provave në pajtim me veçantitë e veprave penale në seri në fushën e abuzimit seksual.

Kërkuesi, në lëndë, ishte deklaruar fajtor, për të pesëdhjetë veprat e tjera penale, për të cilat ishte zbatuar një standard tjetër prove. Standardi i provës ishte i mjaftueshëm sipas ligjit të brendshëm, për marrjen parasysh të atyre veprave penale në procesin e dënimit, por jo për shpalljen formalisht fajtor të kërkuesit në lidhje me to. Standardi i provës i nevojshëm për konstatimin e një personi fajtor për një vepër penale duhej të përcaktohej nga autoritetet e brendshme. Kështu, Gjykata ishte e mendimit që kërkuesi në këtë çështje ishte i provuar fajtor, në pajtim me standardet që ekzistonin dhe mund të rregulloheshin nga ligji i brendshëm, për pesëdhjetë incidentet e tjera në fjalë dhe që prezumimi i pafajësisë për këtë shkak binte.

Përfundimisht, Gjykata mori parasysh detyrimin pozitiv të Shteteve në pajtim me Nenet 3 dhe 8, posaçërisht në lidhje me veprat penale seksuale për të garantuar integritetin fizik të individëve. Për më tepër, ajo nuk lë pa përmendur që praktika gjyqësore gjermane që autorizon gjykatat e brendshme të marrin parasysh, në procesin e dënimit, veprime të tjera, ishte transparente dhe i shërbente qëllimit të dobishëm të ekonomisë procedurale.

**Përfundim:** nuk ka shkelje (njëzëri)

(Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar (GC), 25424/09, 12 korrik 2013, [Shënim Informativ 165](#); Vulakh dhe të tjerë kundër Ruisë, 33468/03, 10 janar 2012, [Shënim Informativ 148](#))

## Neni 6

### Gjykim penal

#### Neni 6-3-c Mbrojtja nëpërmjet asistencës juridike

Moslejimi i avokatit për të bërë mbrojtjen e tij në gjykimin penal: *Nuk ka shkelje*

#### Neni 6-1 Gjykimi i drejtë /Barazia e armëve

Moslejimi i avokatit për të bërë mbrojtjen e tij në gjykimin penal: *Nuk ka shkelje*

**Correia de Matos kundër Portugalisë (GC) - 56402/12**, Vendim themeli 4.4.2018 (GC)



**Faktet** – Kërkuesi, avokat, u ndoq penalisht për ofendimin e gjyqtarit.

Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës kërkuesi pretendoi që vendimet e gjykatave të brendshme që i refuzuan atij lejen për të bërë mbrojtjen e tij vetë në gjykimin penal në ngarkim të tij dhe që i kërkuan të përfaqësohet nga një avokat kishte shkelur Nenin 6, paragrafët 1 dhe 3 (c).

**Ligji** – Neni 6 par 1 dhe 3 (c):

*(a) Komentet paraprake në lidhje me përmbajtjen dhe kontekstin e ankesës së kërkuarit: Kjo çështje kishte të bënte me objektin e së drejtës së të pandehurit që kishte arsim juridik të përfaqësohej personalisht. Megjithatë, kërkuesi ishte pezulluar nga lista e Këshillit të Dhomës në momentin e gjykimit në fjalë para gjykatave të brendshme dhe nuk mund të shërbente si mbrojtës në çështjen e tij.*

Për më tepër, kërkuesi kishte bërë më parë një kërkesë bazuar në ankime të ngjashme, që ishin bërë shkak për një vendim të datës 15 nëntor 2001 (*Correia de Matos kundër Portugalisë* (dec.), [48188/99](#)). Në atë vendim Gjykata kishte konstatuar që, ndërsa ishte e vërtetë që, si rregull i përgjithshëm, avokatët mund të përfaqësohen personalisht para gjykatës, gjykatat përkatëse kishin të drejtë të konsideronin, duke zbatuar marzhin e diskrecionit të tyre, që interesat e drejtësisë kërkonin caktimin e një përfaqësuesi për të përfaqësuar një avokat i cili ishte akuzuar për një vepër penale dhe që, për këtë shkak, nuk mund të ishte në gjendje të vlerësonte interesat përkatës si duhet ose, për pasojë, të realizojë mbrojtjen e vet me efektivitet. Prandaj Gjykata kishte rrëzuar kërkesën si haptazi të pabazuar, për shkak se mbrojtja e kërkuarit ishte zhvilluar rregullisht dhe që të drejtat e tij të mbrojtjes sipas Nenit 6, par 1 dhe 3 (c) nuk ishin shkelur.

*(b) Shqyrtimi i relevancës dhe mjaftueshmërisë së shkaqeve që mbështetin legjislacionin portugez i zbatuar në çështjen konkrete: Duke patur parasysh lirinë e konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve që praktika e konsoliduar e Gjykatës u jepte Shteteve për të garantuar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në pajtim me kërkesat e të drejtës së Nenit 6, par 3 (c), dhe duke ditur që qëllimi i brendshëm të kësaj dispozite ishte të kontribuonte për të siguruar drejtësinë e gjykimit penal në tërësi, standardet e miratuara nga këta shtete dhe zhvillimet ndërkombëtare nuk ishin përcaktuese.*

Gjykatat e brendshme reflektonin me besnikëri arsyetimin e ndjekur nga Gjykata Kushtetuese portugeze, Gjykata e Lartë dhe Gjykatat e Apelit për disa vite. Ato kishin theksuar që rregullat për ndihmën juridike të detyruar në gjykimet penale që zbatoheshin prej tyre ishin projektuar për të mos kufizuar veprimet e mbrojtjes, por të mbronin të akuzuarin duke garantuar një mbrojtje efektive; që mbrojtja e të akuzuarit në gjykimet penale ishte në interesin publik dhe që drejta e mbrojtjes me përfaqësim nuk mund të shmanget; dhe që dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale reflektonin premisën që një i akuzuar mund të mbrohet nga një profesionist ligjor i trajnuar në avokati i cili nuk është i ndikuar nga barra emocionale që rëndon mbi të pandehurin dhe mund të garantojë një mbrojtje të qartë, të çliruar nga emocionet dhe efektive.

Vendimi i gjykatave portugeze që i kërkonte kërkuesit të përfaqësohej nga një avokat mbështetej në një legjislacion të plotë në përpjekje për të mbrojtur personat e akuzuar duke garantuar një mbrojtje efektive në çështjet ku është i mundur dënimi me heqje lirie. Për më tepër, një Shtet Anëtar mund të konsiderojë në mënyrë të ligjshme që një i akuzuar, të paktën si rregull i përgjithshëm, mund të mbrohet më mirë nëse ndihmohet nga një avokat mbrojtës i cili është i çliruar nga emocionet dhe teknikisht i përgatitur, dhe po ashtu një i pandehur i trajnuar në avokati, si kërkuesi, mund të jetë jo në gjendje si rezultat i ndikimit personalisht nga akuzat, për të zhvilluar një mbrojtje efektive të çështjes së tij ose të saj.

Legjitimiteti i konsideratave të tilla është më me shumë vend pasi, në rastin konkret, i pandehuri është pezulluar nga Dhoma, nuk ishte një avokat i regjistruar rregullisht dhe ishte përjashtuar nga dhënia e asistencës ligjore për personat e tretë. Për më tepër, kërkuesi ishte akuzuar për ofendimin e një gjyqtari. Duke patur rolin e posaçëm të avokatëve në administrimin e drejtësisë dhe, në këtë kontekst, detyrat e tyre posaçërisht në lidhje me sjelljen e tyre, ka patur shkaqe të arsyeshme për të konsideruar që kërkuesi mund të mos e kishte qëndrimin objektiv dhe të çliruar nga emocionet që konsiderohet i nevojshëm sipas ligjit portugez për të zhvilluar me efektivitet mbrojtjen e tij.

Për më tepër, natyra posaçërisht kufizuese e legjislacionit portugez nga perspektiva e një të akuzuari si kërkuesi nuk do të thoshte që atij i ishin hequr të gjitha mjetet nëpërmjet të cilave mund të zgjidhte si do të zhvillohej mbrojtja e tij dhe të merrte pjesë në mënyrë efektive në mbrojtjen e tij. Ndërsa në bazë të ligjit portugez për procedurën penale mbrojtja teknike ligjore i ishte rezervuar

avokatit, legjislacioni përkatës i jepte të akuzuarit shumë mjete nëpërmjet të cilave mund të merrte pjesë dhe të ndërhynte personalisht në gjykim.

I akuzuari kishte të drejtë të ishte i pranishëm në të gjitha fazat e gjyqimit në ngarkim të tij ose saj, të bënte deklarime ose të mos shprehej në lidhje me përmbajtjen e akuzës dhe të paraqiste vërejtje, deklarime dhe kërkesa, në të cilat ai ose ajo mund të trajtonte çështje të ligjit ose faktit dhe që, pa qenë e nevojshme të nënshkruheshin nga avokati, i shtoheshin dosjes së çështjes. Për më tepër, ai ose ajo mund të revokonin çdo masë të marrë në emër të tij ose saj. Për më tepër, ligji portugez parashikonte që i akuzuari ishte personi i fundit që mund ti drejtohej gjykatës pas përfundimit të deklarimeve përfundimtare gojore dhe para dhënies së vendimit të themelit.

Përfundimisht, nëse i akuzuari nuk është i bindur me avokatin mbrojtës të caktuar nga gjykata, ai ose ajo mund të kërkojnë zëvendësimin e avokatit bazuar në një shkak të vlefshëm. Personat e akuzuar janë gjithashtu të lirë të konsultohen me një avokat të zgjedhjes së tyre, të cilit ata i besojnë dhe me të cilin ata mund të bien dakord për një strategji mbrojtjeje në çështjen e tyre. Ndërsa personat e akuzuar, nëse shpallen fajtorë, duhet të mbulojnë shpenzimet e përfaqësimit të detyruar, ata mund të kërkojnë ndihmë juridike nëse ata nuk janë në gjendje për të paguar shpenzimet. Në këtë kontekst, kërkuesit i është kërkuar të paguajë shumën relativisht modeste prej 150 EUR për përfaqësimin e tij nga avokati i caktuar nga gjykata dhe kjo shumë nuk ishte paguar asnjëherë.

Pra, megjithë kërkesën për tu asistuar nga një avokat, në praktikë mbetej një gamë relativisht e gjerë për një të akuzuar si kërkuesi të ndikonte mbi mënyrën se si do të zhvillohej mbrojtja e vet në gjykimin penal në ngarkim të tij dhe të merrte pjesë në mënyrë aktive në mbrojtje të vet.

Synimi thelbësor i normës portugeze për përfaqësimin e detyruar ligjor në gjykimin penal ishte garantimi i administrimit të duhur të drejtësisë dhe të gjyqimit të drejtë në respekt të së drejtës së akuzuarit për barazinë e armëve. Duke patur parasysh kontekstin procedural si një të tërë në të cilin ishte zbatuar kërkesa e përfaqësimit të detyruar, dhe duke patur parasysh marzhin e vlerësimit që gëzohet nga Shtetet Anëtare në lidhje me zgjedhjen e mjeteve nëpërmjet të cilave garantohet që mbrojtja e të akuzuarit të realizohet, arsyet e paraqitura për kërkesën e ndihmës së detyrueshme të përgjithësi dhe në çështjen konkrete në veçanti ishin relevante dhe të mjaftueshme.

(c) *Drejtësia e gjykimit në tërësi*: Mbrojtja e kërkuarit ishte garantuar nga kjo gjykatë - avokat mbrojtës i emëruar.

Kërkuari, nga ana e tij, nuk kishte qenë i pranishëm në seanca për të paraqitur versionin e vet të fakteve ose interpretimet e tij të dispozitave përkatëse ligjore, dhe në këtë mënyrë kishte vendosur me vullnetin e vet për të mos marrë pjesë në mënyrë efektive në mbrojtjen e tij së bashku me avokatin. Ai nuk kishte komunikuar me avokatin e tij dhe nuk ishte përpjekur ta udhëzonte atë për të përcaktuar së bashku me të se si do të zhvillohej mbrojtja e tij. Dhe ndërsa ai nuk kishte një raport besimi me avokatin e tij dhe dyshonte që ajo ishte pa eksperiencë, ai nuk e kishte kundërshtuar cilësinë e punës së saj ose kualifikimet para gjykatave të brendshme, as nuk kishte pretenduar që ajo kishte bërë ndonjë gabim procedural. Për më tepër, ai nuk kishte caktuar ndonjë avokat tjetër të zgjedhjes së tij me të cilin mund të kishte rënë dakord për një strategji mbrojtjeje.

Po ashtu, fakti që kërkuari ishte akuzuar një herë tjetër për ofendimin e në gjyqtari mund të ishte shkak për një dënim me heqje lirie prej katër muajsh dhe pesëmbëdhjetë ditë, gjë që nuk mund të konsiderohej gjë e parëndësishme. Duke patur parasysh rrethanat dhe natyrën e veprës për të cilën ai ishte akuzuar, nuk ishte e paarsyeshme për gjykatat e brendshme të konsideronin që kërkuari nuk e kishte gjykimin objektiv dhe të lirë nga emocionet që konsiderohej i nevojshëm sipas ligjit portugez me qëllim që një i akuzuar të zhvillojë mbrojtjen e vet.

Nuk ka patur arsye bindëse për të vënë në dyshim që mbrojtja e kërkuarit nëpërmjet avokatit të caktuar nga gjykata ishte zhvilluar si duhet në rrethanat e çështjes ose për të menduar që zhvillimi i gjykimit nga gjykatat e brendshme ka qenë në mënyrë të padrejtë. Dilte nga komentet e kërkuarit dhe kërkesat e vazhdueshme drejtuar Gjykatës që shqetësimi i tij kryesor nuk ishte gjykimi penal përkatës në fjalë por dëshira e tij për të mbështetur qëndrimin e tij në parim kundër ndihmës së detyrueshme ligjore sipas ligjit portugez.

**Përfundimi:** Nuk ka shkelje (nëntë vota me tetë).

(Shih gjithashtu *Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 50541/08 et al., 13 shtator 2016, [Shënim Informativ 199](#))

## Neni 6

### Gjykim penal

#### Neni 6-1 Aksesi në gjykatë / Akuza penale / Gjykimi i drejtë

Ankim në lidhje me refuzimin nga gjykatat e brendshme për ri-hapjen e gjykimit penal në vijim të një konstatimi nga Gjykata Europiane të shkeljes së Nenit 6: e pranueshme

Refuzimi nga Gjykata e Lartë e kërkesës për rishikimin e një vendimi penal në vijim të një vendimi themeli të Gjykatës Europiane që konstaton shkeljen e Nenit 6; Nuk ka shkelje

**Moreira Ferreira kundër Portugalisë (nr. 2) (GC) - 19867/12**, Vendim themeli 11.7.2017 (GC)

**Fakte** – Më 21 mars 2012, Gjykata e Lartë dha një vendim që rrëzonte një kërkesë për rihapjen e një gjykimi penal i cili ishte paraqitur nga kërkuësja në vijim të një vendimi të dhënë nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ('Gjykata') i cili konstatonte një shkelje të nenit 6, par 1 (shih *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, [19808/08](#), 5 korrik 2011). Në bazë të Nenit 41, Gjykata konstatoi që një rigjykim ose rihapje e gjykimit me kërkesë të kërkuësës, në parim, do të përbënte një mjet të përshtatshëm të trajtimit të shkeljes së konstatuar. Në këtë kuptim, ajo vuri re që Neni 449 i Kodit të Procedurës Penale portugeze lejonte rihapjen e gjykimeve penale të brendshme nëse Gjykata ka konstatuar një shkelje të të drejtave të kërkuësit dhe të lirive themelore.

Gjykata e Lartë u shpreh që vendimi i Gjykatës nuk ishte në papajtueshmëri me shpalljen fajtores të kërkuësës dhe nuk ngrinte asnjë dyshim serioz në lidhje vlefshmërinë e tij, siç kërkohet në pajtim me Nenin 449, par 1 (g) të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkuësja u ankua që Gjykata e Lartë kishte keqinterpretuar vendimin e Gjykatës, në shkelje të Neneve 6, par 1, dhe 46, par 1, të Konventës.

**Ligji** – Neni 6, par 1

(a) Pranueshmëria:

(i) Nëse neni 46 i Konventës përjashtonte shqyrtimin nga Gjykata të ankimit në pajtim me Nenin 6 të Konventës - Mungesa e pretenduar e rregullsisë së

procedurës që është zbatuar në trajtimin e kërkesës për rishikim, dhe aq më tepër gabimet që kërkuesi pretendonte se kishin vesuar arsyetimin e Gjykatës së Lartë, përbënin informacion të ri në lidhje me vendimin e mëparshëm të Gjykatës.

Për më tepër, procedura e mbikëqyrjes në lidhje me ekzekutimin e vendimit, që ishte e papërfunduar para Komitetit të Ministrave, nuk e pengonte Gjykatën të shqyrtonte një kërkesë të re në masën që ajo përfshinte aspekte të reja që nuk ishin vendosur në vendimin e parë.

Kështu, Neni 46 i Konventës nuk e përjashtonte shqyrtimin nga ana e Gjykatës të ankesës së re në pajtim me Nenin 6 të Konventës.

(ii) *Nëse ankesa e re e kërkueses ishte në pajtim racione materiae me Nenin 6, par 1, i Konventës* - Gjykata e Lartë duhej të krahasonte shpalljen fajtores në fjalë me shkaqet mbi të cilat Gjykata e kishte bazuar konstatimin e saj për shkeljen e Konventës. Megjithëse detyra e Gjykatës së Lartë ishte shqyrtimi i kërkesës për lejimin e rishikimit, ajo zhvilloi edhe një ri-shqyrtim të themelit të një numri aspektesh të çështjes së diskutuar të mungesës së kërkueses në seancën e shkallës së apelit dhe pasojat e mungesës së saj për vlefshmërinë e shpalljes fajtores dhe dënimit të saj. Duke ditur gamën e shqyrtueshmërisë nga Gjykata e Lartë, kjo mund të konsiderohet si zgjatje e gjykimit që është përmbyllur me vendimin e themelit të datës 19 dhjetor 2007 që linte në fuqi shpalljen fajtores të kërkueses. Shqyrtimi përsëri ishte përqendruar në përcaktimin e një akuze penale në ngarkim të kërkueses brenda kuptimit të Nenit 6, par 1, të Konventës. Për pasojë, garancitë e Nenit 6, par 1, i Konventës ishin të zbatueshme për gjykimin para Gjykatës së Lartë.

Për pasojë, kundërshtimi i Qeverisë që Gjykata nuk kishte juridiksion *racione materiae* për të shqyrtuar themelin e ankimit të ngritur nga kërkuesja në pajtim me Nenin 6 të Konventës duhej rrëzuar.

**Përfundim:** i pranueshëm (shumica).

(b) *Themeli* - Në pajtim me interpretimin nga Gjykata e Lartë të Nenit 449, par 1 (g), të Kodit të Procedurës Penale, parregullsitë procedurale të tipit të konstatuar në këtë çështje nuk shërbenin automatikisht si shkak për të drejtën e rihapjes së gjykimit.

Ky interpretim, i cili kishte efektin e kufizimit të numrit të çështjeve të rihapjes së gjykimit që ishin përfunduar me një vendim themeli, ose të paktën ua nënshtronte këta kritereve që duhej të vlerësoheshin nga gjykatat vendase, nuk dukej se ishte arbitrar dhe ishte i mbështetur nga praktika gjyqësore e konsoliduar me efektin që Konventa nuk garantonte të drejtën e rihapjes së gjykimit ose një lloj tjetër mjeti mbrojtës nëpërmjet të cilit mund të prishej ose të rishikohej një vendim gjyqësor i formës së prerë, si dhe nga mungesa e një qëndrimi të unifikuar ndërmjet Shteteve Anëtare në lidhje me procedurat operacionale të një mekanizmi ekzistues për rihapjen. Për më tepër, konstatimi i një shkeljeje të Nenit 6 të Konventës si rregull nuk sjell një situatë të vazhdueshme dhe nuk vendos mbi Shtetin e paditur një detyrim procedural të vazhduar.

Vendimi i themelit i Dhomës i datës 5 korrik 2011 konstatoi që një rigjykim ose rihapje e gjykimit me kërkesë të kërkuarit, 'në parim, do të përbënte një mjet të përshtatshëm të trajtimit të shkeljes'. Në këtë mënyrë, një rigjykim ose rihapje e gjykimit u përshkrua si një zgjidhje e përshtatshme, por jo një zgjidhje e nevojshme ose përjashtuese. Për më tepër, përdorimi i shprehjes 'në parim' e kufizonte objektin e rekomandimit, duke sugjeruar që në disa situata një rigjykim ose rihapje e gjykimit mund të mos jetë një zgjidhje e përshtatshme. Kështu Gjykata u kufizua në dhënien e treguesve detyrues për mënyrën se si ekzekutohet vendimi, dhe në vend të kësaj zgjodhi ti ofronte shtetit një marzh të gjerë manovrimi në këtë sferë. Për më tepër, Gjykata nuk mund të paragjykonte rezultatin e vlerësimit të gjykatave të brendshme nëse ai do të ishte i përshtatshëm, duke ditur rrethanat specifike të çështjes, për lejimin e rigjykimit ose rihapjes së çështjes.

Për pasojë, rihapja e gjykimit nuk dukej se ishte e vetmja mënyrë për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së datës 5 korrik 2011; në rastin më të mirë, kjo do të kishte përfaqësuar opsionin më të dëshirueshëm, këshillueshmëria e të cilit ishte një çështje vlerësimi për gjykatat e brendshme, duke patur parasysh ligjin portugez dhe rrethanat e posaçme të çështjes.

Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj të vendimit e themelit të datës 21 mars 2012, kishte analizuar përmbajtjen e vendimit të themelit të Gjykatës të datës 5 korrik 2011 dhe kishte përcaktuar interpretimin e vet të këtij të fundit. Duke patur parasysh marzhin e vlerësimit që u rezervohet autoriteteve të brendshme

në interpretimin e vendimeve të Gjykatës dhe duke patur parasysh parimet që rregullojnë ekzekutimin e vendimeve, Gjykata e konsideroi të panevojshme të shprehte një mendim mbi vlefshmërinë e këtij interpretimi. Në fakt ishte e mjaftueshme për Gjykatën të bindej që vendimi i themelit i datës 21 mars 2012 nuk ishte arbitrar, që do të thotë që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë nuk kishin shtrembëruar ose keqpërfaqësuar vendimin e themelit të dhënë nga Gjykata.

Gjykata nuk mund të nxirrte përfundimin që leximi nga Gjykata e Lartë i vendimit të themelit të vitit 2011 të Gjykatës, si një i tërë, ishte rezultat i një lajthimi të dukshëm faktik ose ligjor që çonte në 'refuzimin e drejtësisë'. Duke patur parasysh parimin e subsidiaritetit dhe tekstin e vendimit të themelit të vitit 2011 të Gjykatës, Gjykata ishte e mendimit që refuzimi nga ana e Gjykatës së Lartë për rihapjen e gjykimit siç kërkohet nga kërkuesja nuk ishte arbitrar. Vendimi i themelit të Gjykatës së Lartë të datës 21 mars 2012 kishte dhënë një tregues të mjaftueshëm në lidhje me shkaqet ku ai bazohet. Këto shkaqe përfshiheshin në marzhin e vlerësimit të autoriteteve të brendshme dhe nuk shtrembëronin konstatimet e vendimit të themelit të Gjykatës.

Konsideratat e mësipërme nuk synonin të shmangnin rëndësinë e garantimit ekzistencës së procedurave të brendshme, nëpërmjet të cilave një çështje duhet të rishqyrtohet në dritën e një konstatimi se Neni 6 i Konventës është shkelur. Përkundrazi, gjykime të tilla mund të konsiderohen si një aspektet i rëndësishëm i ekzekutimit të vendimeve të saj dhe disponibiliteti i tyre tregonte angazhimin e Shteteve Anëtare përkundrejt Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës.

**Përfundimi:** Nuk ka shkelje (nëntë vota me tetë).

(Shih gjithashtu *Meftah dhe të tjerë kundër Francës* (GC), 32911/96 et al., 26 korrik 2002, [Shënim Informativ 44](#); *Lenskaya kundër Rusisë*, 28730/03, 29 janar 2009, [Shënim Informativ 115](#); *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës* (nr. 2) (GC), 32772/02, 30 qershor 2009, [Shënim Informativ 120](#); *Egmez kundër Qipros* [dec.], 12214/07, 18 Shtator 2012, [Shënim Informativ 155](#); *Bochan kundër Ukrainës* (nr. 2) (GC), 22251/08, 5 shkurt 2015, [Shënim Informativ 182](#); dhe *Yaremenko kundër Ukrainës* (nr. 2), [66338/09](#), 30 prill 2015)



## Neni 6

### Gjykim penal

#### Neni 6 -1 Gjykimi i drejtë

Mungesa e procedurës gjyqësore efektive për të përcaktuar nëse provat e marra nga zyra e prokurorisë duhej ti bëheshin të ditura mbrojtjes: *shkelje*

***Matanović kundër Krocisë - 2742/12***, Vendim Themeli 4.4.2017 (Seksioni II)

**Faktet** - Kërkuesi, një punonjës i shërbimit publik, u vendos nën survejim të veçantë gjatë një hetimi për korrupsion. Pas gjykimit të tij me një numër të akuzuarish të tjerë, ai u shpall fajtor për vepra të ndryshme penale dhe u dënua me njëmbëdhjetë vjet burgim. Provat në ngarkim të tij përfshinin regjistrime bisedash të bëra gjatë operacionit të survejimit të posaçëm. Në gjykimin sipas Konventës, kërkuesi pretendoi, *ndër të tjera*, që atij i ishte mohuar gjykimi i drejtë (Neni 6, par 1, i Konventës), pasi atij nuk i ishte lejuar akses i tek regjistrimet origjinale dhe për shkak se disa regjistrime nuk i ishin treguar atij për shkak se ato nuk kishin rëndësi për çështjen e tij dhe preknin jetën private të palëve të treta.

**Ligji** – Neni 6, par 1, (*mosdeklarimi dhe përdorimi i provave të marra nëpërmjet masave të posaçme të hetimit*): Ankesat e kërkuesit në lidhje me parregullsinë procedurale kishin të bënin me aksesin e tij të kufizuar tek tre kategoritë kryesore të provave të marra nëpërmjet përdorimit të masave të fshehta të survejimit.

Kategoria e parë kishte të bënte me regjistrimet e survejimit të dhëna si provë dhe merreshin si bazë për shpalljen fajtor të kërkuesit. Gjykata vuri re që kërkuesi ka patur akses tek zbardhjet e regjistrimeve të autorizuara nga gjyqtari hetimor dhe gjykata e faktit dhe që ishin përgatitur nga një ekspert, pavarësia dhe paanësia e të cilit nuk ishin vënë asnjëherë në pikëpyetje. Regjistrimet ishin dëgjuar në gjykim, kërkuesit i ishte dhënë mundësia e mjaftueshme për të krahasuar zbardhjet përkundrejt materialit të dëgjuar dhe kundërshtimet e tij në lidhje me mospërputhjet ndërmjet zbardhjeve dhe regjistrimeve ishin trajtuar rregullisht dhe u autorizuan ekspertiza të tjera me qëllim që të sqaroheshin këto mospërputhje. Kërkuesi gjithashtu kishte shfrytëzuar mundësinë për të sfiduar vlefshmërinë e provave në fjalë dhe gjykatat e brendshme kishin dhënë përgjigje të hollësishme për në lidhje me rezervat e tij. Kërkuesi asnjëherë nuk

kishte pretenduar që bisedat e regjistruara kishin ndodhur apo të kishte sfiduar vërtetësinë e regjistrimeve. Kështu Gjykata doli në përfundimin që nuk ka patur parregullsi në lidhje me regjistrimet që përfshihen ën kategorinë e parë.

Kategoria e dytë kishte të bënte me regjistrimet e kërkuesit dhe të akuzuarit tjetër që nuk ishin marrë parasysh për shpalljen fajtor të kërkuesit. Në lidhje me këtë kategori, Gjykata vuri re që, megjithëse i ishte dhënë aksesit tek raporte tepër të detajuar në lidhje me bisedat e tij me palë të treta, kërkuesi nuk kishte ngritur asnjë argument të posaçëm në lidhje me relevancën e mundshme të provave në fjalë në asnjë moment gjatë gjykimit të brendshëm. Në këtë mënyrë Gjykata nuk ishte në gjendje të dilte me përfundimin që pamundësia e tij e pretenduar për akses tek regjistrimet që i takonin kësaj kategorie ishte në vetvete e mjaftueshme për të konstatuar një shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë. Megjithatë, në vlerësimin e saj për rregullsinë e përgjithshme të gjykimit, ajo do ta mbante parasysh këtë kufizim mbi të drejtat e mbrojtjes së kërkuesit.

Kategoria e tretë e provave përbëhej nga regjistrime në lidhje me individë të tjerë që nuk ishin nën ndjekje penale dhe nuk ishin marrë parasysh për shpalljen fajtor të kërkuesit. Kërkuesit i ishte mohuar aksesit tek çdo informacion i tillë për shkak se ai nuk kishte të drejtë të aksesonte regjistrimet që nuk kishin të bënin me çështjen e tij dhe që preknin jetën private të të tjerëve. Megjithatë nuk pati asnjë procedurë që do ti jepte mundësi gjykatës kompetente të vlerësonte, me kërkesë të kërkuesit, relevancën e tyre për çështjen, veçanërisht nëse ato përmbanin ato hollësi që do ti jepnin mundësi kërkuesit të shfaqësohej ose ti ulej dënimi, apo nëse ato kishin relevancë në lidhje me pranueshmërinë, besueshmërinë dhe plotësinë e provave të marra gjatë gjykimit. Konstatimi i Gjykatës së Lartë që Avokati i Shtetit ishte në gjendje të bënte një përzgjedhje të provave që do të përdorehin në gjykim ishte në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas së cilës procedurë, nëse autoritet e ndjekjes penale vetë përpiqen të vlerësojnë se çfarë mund të jetë relevante, pa garanci të mëtejshme procedurale për të drejtat e mbrojtjes, nuk mund të jetë në pajtim me kërkesat e Nenit 6, par 1.

Kështu, ishte e dukshme që, duke patur parasysh procedurën e mangët për deklarimin e provave nën shqyrtim, kërkuesi nuk kishte qenë në gjendje të formonte një argument specifik në lidhje me relevancën e provës në fjalë dhe të kërkonte që gjykata kompetente të shqyrtonte kërkesën e tij nën dritën e së

drejtës së tij për të përgatitur mbrojtjen në mënyrë të efektshme. Kështu atij iu privua një procedurë nëpërmjet të cilës mund të konstatohej nëse provat në zotërim të prokurorisë që ishin përjashtuar nga dosja, mund të kishin ulur dënimin e tij ose të vinin në dyshim objektin e aktivitetit të tij të konsideruar kriminal.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 1 500 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar (katër vota me tre); rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar.

Gjykata doli njëzëri në përfundimin që nuk ka patur një shkelje të Nenit 8 të Konventës dhe as shkelje të Nenit 6, par 1, në lidhje me parashtrimin e provokimit nga kërkuesi.

## Neni 6

### Gjykim administrativ

#### Neni 6-1 Gjykimi i drejtë / Gjykim mbi baza kontradiktoriteti / Barazia e armëve

**Mungesa e aksesit në informacionin e klasifikuar që përbën provë vendimtare në gjykimet rishikuese:** *Neni 6, i zbatueshëm; nuk ka shkelje*

**Regner kundër Republikës Çeke (GC) - 35289/11**, Vendim themeli 19.9.2017 (GC)

**Faktet** - Në shtator të vitit 2006 Autoriteti i Sigurisë Kombëtare vendosi të revokojë lejen e sigurisë që i ishte lëshuar kërkuesit duke i dhënë atij mundësi për të mbajtur postin e zëvendësimit të Zëvendësministrit të parë të Mbrojtjes, për shkak se ai përbente rrezik për sigurinë kombëtare. Vendimi, megjithatë, nuk tregonte se mbi cilin informacion konfidencial bazohej, pasi ai ishte i klasifikuar ‘i kufizuar’ dhe nuk mund ti deklarohet ligjërisht kërkuesit.

Pas ankimit të kërkuesit, drejtori i Autoritetit konfirmoi ekzistencën e një rreziku. Kërkesa e kërkuesit për një rishikim gjyqësor të vendimit u rrëzua në vijim nga Gjykata e Rrethit së cilës i ishin paraqitur dokumentet në fjalë nga Autoriteti. Kërkuesi dhe avokati i tij nuk u lejuan të konsultoheshin. ankimet në vijim nga kërkuesi ishin të pasuksesshëm.

Në mbështetje të Nenit 6, par 1, të Konventës, kërkuesi u ankua që shqyrtimi administrativ ishte i padrejtë pasi ai nuk kishte qenë në gjendje të këqyrte provat vendimtare, të klasifikuara si informacion konfidencial, të cilat u ishin ofruar gjykatave nga i akuzuari.

Në vendimin e datës 26 nëntor 2015, një Dhomë e Gjykatës u shpreh njëzëri që nuk ka patur një shkelje të Nenit 6, par 1, të Konventës, duke konstatuar që procedura e vendim-marrjes ishte në pajtueshmëri në masën e mundur me kërkesat e gjykimit mbi bazë kontradiktoriteti dhe barazinë e armëve dhe përfshinte garancitë e duhura për mbrojtjen e interesave të kërkuesit.

Më 2 maj 2016, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

#### **Ligji – Neni 6, par 1**

(a) *Zbatueshmëria* - Zotësia e kërkuesit për të përmbushur detyrat e tij ishte e kushtëzuar nga autorizimi për të aksesuar informacionin e klasifikuar. Revokimi i lejes së sigurisë e kishte bërë të pamundur për të të përmbushte detyrat në tërësi dhe kishte ndikuar negativisht në zotësinë tij për të marrë postin e ri në shërbimin civil. Në këto rrethana, lidhja ndërmjet vendimit për të revokuar lejen e sigurisë së kërkuesit dhe humbjes së detyrave dhe punësimit të tij kishte qenë tepër e dobët dhe e largët. Ndërsa ai kishte qenë në gjendje të sfidonte ligjshmërinë e këtij revokimi para gjykatave.

Marrëdhënia e punësimit ndërmjet kërkuesit dhe Ministrisë së Mbrojtjes ishte bazuar në dispozitat e Kodit të Punës, që nuk përmbante ndonjë dispozitë të posaçme që të zbatohet për funksionet e kruara brenda administratës shtetërore, kështu që në momentin përkatës nuk ka patur shërbim civil në kuptimin tradicional të termit, që u ngarkonte punonjësve të shërbimit publik detyrime dhe privilegje jashtë objektit të ligjit të zakonshëm. Meqenëse mosmarrëveshjet e punësimit kishin të bënin me të drejta civile brenda kuptimit të Nenit 6, par 1, të Konventës, vendimi për tërheqjen e lejes së sigurisë së kërkuesit dhe gjykimi pasues kishte prekur të drejtat e tij civile.

Në këto rrethana, edhe nëse prezumohet që kërkuesi duhej të konsiderohej si punonjës i shërbimit civil, ai kishte qenë në gjendje tu drejtohej gjykatave administrative për rishikim gjyqësor të vendimit të Autoritetit. Për pasojë Neni 6 në këtë çështje ishte i zbatueshëm përsa i takon pjesës të së drejtës civile.

Për pasojë, kërkuesi mund të pretendonte që ka statusin e viktimës për qëllimet e nenit 34 të Konventës.

**Përfundim:** Kundërshtimet paraprake rrëzohen (pesëmbëdhjetë vota me dy)

(b) **Themeli** - Në pajtim me kërkesat e ligjit çek, në rastin e gjykimeve që shqyrtojnë një vendim i cili refuzon të lëshojë ose revokojë një leje sigurie, gjykimi i filluar nga kërkuesi ishte i kufizuar në dy mënyra në lidhje me rregullat e ligjit të zakonshëm që garantonte një gjykim të drejtë: së pari, dokumentet dhe informacioni i klasifikuar nuk i ishin treguar as atij dhe as avokatit të tij, dhe së dyti, në masën që vendimi për revokimin e lejes së sigurisë ishte bazuar në ato dokumente, shkaqet për vendim-marrjen nuk i ishin treguar atij.

Gjykata theksoi kompetencat e dhëna gjykatave të brendshme. Ato kishin akses të pakufizuar tek të gjitha dokumentet e klasifikuara mbi të cilat ishte bazuar Autoriteti për të justifikuar vendimin e tij; ato kishin kompetencë të bënin një shqyrtim të detajuar të shkaqeve mbi të cilat ishte mbështetur Autoriteti për mos-deklarimin e dokumenteve të klasifikuara; dhe ato mund të urdhëronin deklarimin e atyre që ato konsideronin që nuk e kishin të nevojshëm atë klasifikim. Ato mund të vlerësonin edhe themelin e vendim-marrjes së Autoritetit që revokonte lejen e sigurisë dhe të prishnin, sipas rastit, një vendim arbitrar. Juridiksioni i tyre përfshinte të gjitha faktet e çështjes dhe nuk ishte i kufizuar me shqyrtimin e shkaqeve që kishte marrë parasysh kërkuesi, i cili ishte dëgjuar nga gjyqtarët dhe kishte qenë gjithashtu në gjendje të bënte parashtrimet e tij me shkrim.

Gjykatat e brendshme kishin ushtruar rregullisht kompetencat e tyre për shqyrtim që u jepen atyre në këto lloj gjykimesh, si në lidhje me nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e dokumenteve të klasifikuar ashtu edhe në lidhje me justifikimin e vendimit që revokonte lejen e sigurisë së kërkuesit, duke dhënë shkaqet për vendimet e tyre në lidhje me rrethanat specifike të kësaj çështjeje.

Po ashtu, Gjykata e Lartë Administrative ishte e mendimit që deklarimi i dokumenteve të klasifikuara mund të kishte efektin e deklarimit të metodave të punës së shërbimeve të inteligjencës, duke treguar burimet e informacionit

të tyre ose duke u bërë shkak për përpjekje për të ndikuar dëshmitarët e mundshëm. Ajo shpjegoi që nuk ishte ligjrisht e mundur të tregonte se ku qëndronte saktësisht rreziku i sigurisë ose të tregonte saktësisht se cilat konsiderata mbështesin përfundimit që ka patur një rrezik sigurie, arsyet dhe konsideratat që mbështesnin vendim-marrjen e Autoritetit që e kanë origjinën ekskluzivisht në informacionin e klasifikuar. Për pasojë, nuk ka patur asnjë shkak që do të tregonte që klasifikimi i dokumenteve në fjalë ishte vendosur në mënyrë arbitrare apo për një qëllim të ndryshëm nga interesi legjitim që tregohej se ndiqej.

Sipas Gjykatës së Lartë Administrative, ishte pa asnjë mëdyshje e qartë nga dokumentet e klasifikuar që kërkuesi nuk vazhdonte të përmbushte kushtet ligjore për t'iu besuar sekrete. Sjellja e tij përbënte rrezik për sigurinë kombëtare. Në këtë kontekst, në mars të vitit 2011, kërkuesi ishte ndjekur penalisht për pjesëmarrje në krimin e organizuar; ndihmë dhe nxitje e abuzimit me pushtetin publik; bashkëpunim në ndikim të paligjshëm të tenderave publikë dhe procedurave të prokurimit publik; dhe ndihmë dhe inkurajim i shkeljes së rregullave detyrues që rregullojnë marrëdhëniet ekonomike. Ishte e kuptueshme që kurdoherë që ekzistojnë dyshime të tilla, autoritetet e konsiderojnë të nevojshme për të vepruar menjëherë pa pritur për rezultatin e hetimit penal, duke penguar deklarin, në një fazë të mëparshme, të dyshimeve që preknin personin në fjalë, të cilat mund të rrezikojnë pengimin e hetimit penal.

Megjithatë, do të ishte e dëshirueshme - në masën që është në pajtueshmëri me ruajtjen e konfidencialitetit dhe efektivitetit të hetimeve në lidhje me kërkuesin - për autoritetet e brendshme, ose të paktën Gjykatën e Lartë Administrative, të shpjegonin, edhe në mënyrë të përmbledhur, masën e rishikimit që ato kishin kryer dhe akuzat ndaj kërkuesit. Në këtë kontekst, Gjykata vuri re me kënaqësi zhvillimet e reja pozitive në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë Administrative.

Duke patur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet që veprojnë mbi gëzimin e të drejtave nga kërkuesi, të dhëna atij në pajtim me parimet e gjykimit bazuar në parime kontradiktoriteti dhe barazinë e armëve, ishin balancuar në një mënyrë të tillë që një balancë e drejtë ndërmjet palëve nuk ishte cenuar në mënyrë të tillë që të cenonte thelbin e të drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë.

**Përfundimi:** Nuk ka shkelje (dhjetë vota me shtatë).

(Shih *Fitt kundër Mbretërisë së Bashkuar* (GC), 29777/96, 16 shkurt 2000, [Shënim Informativ 15](#); *Ternovskis kundër Letonisë*, [33637/02](#), 29 prill 2014; *Schatschaschwili kundër Gjermanisë* (GC), 9154/10, 15 dhjetor 2015, [Shënim Informativ 191](#); dhe *Miryana Petrova kundër Bullgarisë*, [57148/08](#), 21 korrik 2016)

## Neni 6

### Gjykim administrativ

#### Neni 6-1 Aksesi në gjykatë

Mosrespektimi nga autoritetet e brendshme të urdhrimit të përkohshëm të gjykatës që kufizon prishjen e pronës banesë: *shkelje*

#### Neni 13 Mjeti efektiv i mbrojtjes

Mosrespektimi nga autoritetet e brendshme të urdhrimit të përkohshëm të gjykatës që kufizon prishjen e pronës banesë: *shkelje*

#### Neni 1 i Protokollit nr 1.

#### Neni 1, par 1 i Protokollit nr 1 Gëzimi paqësor i sendeve në zotërim

Prishja e pronës banesë: *shkelje*

**Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë - 10613/16**, Vendim themeli 11.1.2018 (Seksioni I)

**Faktet** – Kërkuesit ishin pronarë të apartamenteve dhe dyqaneve në një pronë rezidenciale dhe shërbimesh. Më 3 nëntor 2013, pa njoftim paraprak, punonjësit e Inspektoratit Kombëtar të Ndërtimit dhe Urbanistikës, të mbështetur nga policia, e rrethuan rezidencën, e kufizuan atë me një shirit të verdhë të policisë dhe i penguan banorët të hynin në apartamentet e tyre. Kërkuesit bënë ankim në Gjykatën e Rrethit, e cila më 7 nëntor 2013 nxori një urdhër të përkohshëm për të penguar prishjen. Më 27 nëntor 2013, Këshilli i Ministrave nxori një

vendim i cili urdhëronte shpronësimin e rezidencës për interes publik dhe u dha kompensim banorëve. Rezidenca u prish ndërmjet datave 4 dhe 8 dhjetor 2013. Gjykimi në lidhje me nivelin kompensimit u pezullua në janar të vitit 2015 nga Gjykata e Lartë.

Para Gjykatës Europiane kërkuesit u ankuan që, si rezultat i mosrespektimit nga autoritetet i një mase mbrojtëse të gjykatës administrative, ka patur një shkelje të Nenit 6, par 1. Ata u ankuan gjithashtu në bazë të Nenit 1 të Protokollit 1 për ndërhyrje në gëzimin paqësor të sendeve në zotërim të tyre dhe në bazë të nenit 13 të Konventës për shkak të mungesës së mjeteve efektive mbrojtëse të brendshme.

**Ligji** - Neni 6, par 1, i Konventës: Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë - duke përfshirë një vendim të dhënë në gjykimin për masë mbrojtëse - duhet të merrej parasysh si pjesë integrale e 'gjykimit' për qëllimet e Nenit 6. E drejta e aksesit në gjykatë e garantuar në pajtim me këtë Nen do ishte iluzor nëse sistemi ligjor i një Shteti Kontraktues do të lejonte një vendim gjyqësor detyrues dhe përfundimtar ose një urdhër të përkohshëm të nxjerrë në pritje të një vendimi përfundimtar të mbetëj i pazbatuar në dëm të një pale. Ky parim ishte e një rëndësie më të madhe në kontekstin e gjykimit administrativ në lidhje me një mosmarrëveshje rezultati i së cilës ishte vendimtare për të drejtat civile të një pale.

Nuk ishte fjala nëse Neni 6, paragrafi 1, zbatohet për gjykimet për masën e përkohshme. Urdhri i përkohshëm, drejtuar çdo organi publik, ishte lëshuar me synim pengimin e një prishjeje të mundshme të ndërtesës së kërkuesve dhe duhet të lihej në fuqi derisa të ishte marrë një vendim mbi themelin e çështjes. Para se gjykatat e brendshme të mund të vendosnin mbi themelin e çështjes, Këshilli i Ministrave vendosi që rezidenca duhet të shpronësohet në interes publik dhe ndërtesa ishte prishur. Kështu, ekzekutimi i urdhrit të përkohshëm dhe rezultati i gjykimit në themel ishte bërë i tepërt. Gjykatat e brendshme në të gjitha nivelet konstatuan që autoritetet shqiptare nuk e kishin respektuar urdhrin e përkohshëm. Autoritetet e brendshme nuk kishin respektuar në praktikë një urdhër të përkohshëm duke i hequr kështu çdo efekt të dobishëm Nenit 6, par 1.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 13 në lidhje me Nenin 6, par 1, i Konventës: Kërkuesit u ankuan që autoritetet nuk e kishin respektuar masën e përkohshme, kështu që për ta ishte



e pamundur të kërkonin që themeli i çështjes të shqyrtohej si duhej. Parimi i shtetit të së drejtës, që Shtetet Anëtare kanë marrë përsipër të respektojnë kur ata ratifikuan Konventën, përfshinte detyrimin për të garantuar që autoritetet kompetente të zbatonin garancitë gjyqësore nëse ato jepeshin. Në momentin përkatës në Shqipëri nuk kishte mjet efektiv mbrojtës në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve përfundimtare dhe kohëzgjatjen e gjyqësorëve. Përveç një konstatimi deklarativ për shkelje në rastet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare, Gjykata Kushtetuese nuk ishte në gjendje të ofronte ndonjë mjet tjetër për ndreqjen e situatës. Në këto rrethana, nuk ka patur mjete efektive mbrojtës në dispozicion të kërkuësve në lidhje me mosekzekutimin e urdhrit mbrojtës.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 1 i Protokollit Nr 1: (*sekuestrimi i ndërtesës*): Kërkuësve u ishte mohuar aksesimi tek pronat e tyre për një periudhë prej një muaji dhe në këtë mënyrë ata kishin humbur tërësisht kontrollin mbi pronat e tyre dhe mundësinë për ti përdorur dhe gëzuar ato. Mohimi i vazhdueshëm i aksesit me qëllim prishjen e rezidencës përbënte një ndërhyrje në gëzimin paqësor të sendeve në zotërim të tyre, ku një ndërhyrje e tillë nuk ishte e ligjshme sipas ligjit të brendshëm, pasi autoritetet kishin injoruar një masë të përkohshme të lëshuar nga gjykatat e brendshme.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 13 i Konventës i marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr 1: (*sekuestrimi i ndërtesës*): Kërkuësve nuk u ishte dhënë ndonjë kompensim nga gjykatat e brendshme në lidhje me sekuestrimin e ndërtesës. Kështu ata nuk kishin asnjë mjet efektiv në dispozicion të tyre për qëllimet e Nenet 13 të Konventës.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 1 i Protokollit Nr 1: (*sekuestrimi dhe prishja e pronës*): Prishja e ndërtesës i kishte privuar kërkuësit nga çdo mundësi në të ardhmen për gëzimin e pronës së tyre. Në këto rrethana, ka patur një ndërhyrje në të drejtat e tyre të pronës në formën e 'privimit' brenda kuptimit të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të Nenet 1 të Protokollit nr. 1. Shqetësime të ligjshme kanë lindur në lidhje me përshtatshmërinë e një procedure nëpërmjet të cilës autoritetet mund të vendosnin, në një kohë kaq të shkurtër, të shpronësonin pronën e kërkuësve në

interesin publik dhe të vazhdonin menjëherë me prishjen. Në vendimet e tyre, gjykatat vendase kishin nxjerrë përfundimin që mosrespektimi i autoriteteve të urdhrit të përkohshëm dhe prishja e rezidencës ka qenë e paligjshme. E gjithë procedura e shpronësimit të kërkuësve ishte kryer me nxitim dhe ishte haptazi në mospërputhje me ligjin e brendshëm.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 13 i Konventës i marrë së bashku me Nenin 1 të Protokollit Nr 1: (*shpronësimi dhe prishja e pronës*): Çështja në lidhje me nivelin e kompensimit kishte mbetur para Gjykatës së Lartë qysh në vitin 2014. Në janar të vitit 2015, Gjykata e Lartë e pezulloi gjykimin pa dhënë asnjë arsye. Kërkuësit nuk ishin kompensuar akoma. Një vonesë prej katër vjetësh në pagesën e kompensimit për kërkuësit, që kishin humbur shtëpinë dhe sendet pronësore, nuk mund të konsiderohet efektiv. Kërkuësve në këtë mënyrë u ishte mohuar mjeti efektiv për shkeljen e pretenduar të të drejtave të tyre sipas Nenit 1 të Protokollit nr. 1.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 7 800 EUR secili për kërkuësin e parë dhe të dytë dhe 13 000 EUR secili për 17 kërkuësit e tjerë në lidhje me dëmin jo-financiar; 13 098 600 EUR së bashku për të gjithë kërkuësit në lidhje me dëmin e tyre financiar.

Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje të Nenit 8, në lidhje me të drejtën e kërkuësve të respektimit të banesës në lidhje me sekuestrimin dhe rrethimin e banesës dhe Nenit 13 së bashku me Nenin 8 në lidhje me mungesën e mjetit të efektshëm në këtë aspekt.

## Neni 8

### Neni 8-1 Respektimi i korrespondencës

#### Respektimi i jetës private

Monitorimi i përdorimit të internetit nga punonjësi në vendin e punës dhe përdori i të dhënave të mbledhura për të justifikuar pushimin nga puna: *shkelje*

***Bărbulescu kundër Rumanisë (GC) - 61496/08***, Vendim themeli 5.9.2017 (GC)

**Faktet** – Kërkuesi u pushua nga puna nga punëdhënësi, një shoqëri private, për shkak të përdorimit të rrjetit të internetit të shoqërisë gjatë kohës së punës në shkelle të rregullore të brendshme, që ndalonin përdorimin personal të kompjuterëve të shoqërisë. Gjatë një periudhe kohe, punëdhënësi kishte vëzhguar komunikimet e tij në llogarinë Yahoo Messenger që atij i ishte kërkuar të hapte me qëllim përgjigjen e pyetjeve të klientëve. Regjistrimet e paraqitura gjatë gjykimeve para gjykatave të brendshme që ai kishte shkëmbyer mesazhe të një natyre thjesht private me njerëzit e tjerë.

Në gjykimin në pajtim me Konventën, kërkuesi argumentoi që prishja e kontratës ishte bazuar në një shkelle të së drejtës së tij për të respektuar jetën e tij private dhe korrespondencës dhe që gjykatat e brendshme nuk ia kishin mbrojtur këtë të drejtë.

Në vendimin e datës 12 janar 2015, një Dhomë e Gjykatës, me gjashtë vota me një, konstatoi që nuk ka patur shkelle të Nenit 8 të Konventës. Sipas mendimit të Dhomës, nuk ka patur të dhëna që autoritetet e brendshme nuk kishin vendosur një balancë të drejtë, brenda marzhit të vlerësimit të tyre, ndërmjet së drejtës së kërkuesit për respektimin e jetës së tij private në pajtim me Nenin 8 dhe interesave të punëdhënësit të tij (shih [Shënim Informativ 192](#)).

Më 6 qershor 2016, çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të kërkuesit.

### **Ligji – Neni 8**

(a) *Zbatueshmëria* - Lloji i shërbimit të mesazheve të menjëhershme në internet ishte një formë komunikimi që u jepte mundësi individëve të zhvillonin një jetë private sociale. Përveç kësaj, nocioni ‘korrespondencë’ mbulonte dërgimin dhe marrjen e komunikimeve, edhe në një kompjuter të punëdhënësit.

Kërkuesi natyrisht që ishte informuar në lidhje me ndalimin e përdorimit privat të internetit, e parashikuar kjo në rregulloret e brendshme të punëdhënësit. Megjithatë, ai nuk ishte informuar paraprakisht në lidhje me gamën dhe natyrën e aktiviteteve vëzhguese të punëdhënësit, apo për mundësinë që punëdhënësi mund të ketë akses tek përmbajtja faktike e komunikimeve të tij.

Ishte çështje e hapur nëse rregulloret kufizuese të punëdhënësit i kishin lënë kërkuesit një pritshmëri të arsyeshme të privatësisë. Sido që të jetë, udhëzimet e punëdhënësit nuk mund të ulin jetën private social në vendin e punës në

nivelin zero. Respektimi i jetës private dhe fshehtësia e korrespondencës vazhdon të ekzistonte, edhe nëse këto mund të kufizoheshin në masën që është e nevojshme.

Komunikimet e kërkuarit në vendin e punës mbulohehin nga konceptet 'jetë private' dhe 'korrespondence'. Për pasojë, Neni 8 i Konventës zbatohet në këtë çështje.

(b) *Themeli* - Në dritën e rrethanave të caktuara të çështjes, duke patur parasysh përfundimin në lidhje me zbatueshmërinë e Nenit 8 dhe faktin që gëzimi nga kërkuari i së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private dhe korrespondencës ishte prekur nga veprimet e punëdhënësit privat, ankesa duhej të shqyrtohej nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të Shtetit.

Vetëm disa Shtete Anëtare e kishin rregulluar shprehimisht çështjen e ushtrimit nga punëmarrësit të së drejtës së tyre për respektimin e jetës së tyre private dhe korrespondencës në vendin e punës. Kështu, Shteteve Kontraktuese duhet tu jepet një marzh i gjerë vlerësimi në përcaktimin e nevojës për të vendosur një kuadër ligjor që të rregullojë kushtet në të cilat një punëdhënës mund të miratojë një politikë që rregullon komunikimet elektronike ose të tjera të një natyre jo-profesionale nga punëmarrësit në vendin e punës.

Megjithatë, proporcionaliteti dhe garancitë procedurale ndaj veprimeve arbitrare ishin thelbësore. Në këtë kontekst, autoritetet e brendshme duhet të trajtojnë faktorët e mëposhtëm si relevantë: nëse punëmarrësi ishte njoftuar në lidhje me mundësinë që punëdhënësi mund të merrte masa për të vëzhguar korrespondencën dhe komunikimet e tjera dhe të zbatimit të këtyre masave; gamën e monitorimit nga punëdhënësi dhe shkallën e ndërhyrjes në jetën private të punëmarrësit; nëse punëdhënësi kishte dhënë arsye për të justifikuar vëzhgimin e komunikimeve të punëmarrësit; nëse do të kishte qenë e mundur për të vendosur një sistem monitorimi bazuar në metoda dhe masa më pak ndërhyrëse krahasuar me aksesin e drejtpërdrejtë në përmbajtjen e komunikimeve të punëmarrësit; pasojat e vëzhgimit për punëmarrësit që i nënshtrohen atij; dhe nëse punëmarrësi ishte pajisur me garanci të përshtatshme, posaçërisht kur operacionet e vëzhgimit të punëdhënësit kanë qenë të një natyre ndërhyrëse. Së fundmi, autoritetet e brendshme duhet të garantojnë që punëmarrësit, komunikimet e të cilëve ishin vëzhguar, të kenë akses tek një masë mbrojtëse para një organi gjyqësor me juridiksion për të

përcaktuar, të paktën në lëndë, se si ishin respektuar kriteret e përshkruara më sipër dhe nëse masat e kundërshtuara kishin qenë të ligjshme.

Gjykatat e brendshme kishin identifikuar saktësisht interesat në lojë - duke iu referuar shprehimisht së drejtës së kërkuesit për respektimin e jetës së tij private - dhe gjithashtu të parimeve të zbatueshme ligjore të domosdoshmërisë, specifikimit të qëllimit, transparencës, legjitimitetit, proporcionalitetit dhe sigurisë së parashikuar në [Direktiva 95/46/KE](#) të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 1995 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Gjykatat e brendshme kishin shqyrtuar gjithashtu nëse procedimet disiplinore ishin zhvilluar mbi baza kontradiktoriteti dhe nëse kërkuesit i ishte dhënë mundësia për të paraqitur argumente e tij.

Kërkuesi nuk ishte informuar paraprakisht në lidhje me gamën dhe natyrën e aktiviteteve vëzhguese të punëdhënësit, apo për mundësinë që punëdhënësi mund të kishte akses tek përmbajtja faktike e mesazheve të tij. Gjykatat e brendshme nuk kishin përcaktuar nëse kërkuesi ishte njoftuar paraprakisht në lidhje me mundësinë që punëdhënësi mund të prezantonte masa vëzhgimi dhe gamën dhe natyrën e këtyre masave. Për tu kualifikuar si njoftim paraprak, paralajmërimi nga punëdhënësi duhej të jepej para se të filloheshin aktivitetet e vëzhgimit, posaçërisht nëse ato përfshinin edhe aksesin tek përmbajtja e komunikimeve të punëmarrësve.

Çështja e gamës së vëzhgimit dhe shkallës së ndërhyrjes në jetën private të kërkuesit nuk ishte shqyrtuar nga ndonjë gjykatë e brendshme, edhe nëse punëmarrësi dukej se kishte regjistruar të gjitha komunikimet e kërkuesit gjatë periudhës së vëzhgimit në kohë reale, i kishte aksesuar ato dhe printuar përmbajtjen e tyre.

Gjykatat e brendshme nuk kishin bërë një vlerësim të mjaftueshëm nëse ka patur arsye legjitime për të justifikuar vëzhgimin e komunikimeve të kërkuesit. Përveç kësaj, as Gjykata e Rrethit dhe as Gjykata e Apelit nuk kishin shqyrtuar në masën e duhur nëse qëllimi i ndjekur nga punëmarrësi mund të arrihej nëpërmjet metodave më pak ndërhyrëse krahasuar me aksesin e përmbajtjes së komunikimeve të kërkuesit.

Për më tepër, asnjë gjykatë nuk kishte shqyrtuar seriozitetin e pasojave të vëzhgimit dhe procedimit disiplinor pasues. Në këtë aspekt, kërkuesi i ishte nënshtruar sanksionit më të rëndë disiplinor, që është largimi.

Gjykatat e brendshme nuk e kishin bërë konstatimin nëse punëdhënësi e kishte thirrur kërkuesin për të dhënë një shpjegim për përdorimin nga ana e tij të burimeve të shoqërisë, posaçërisht të internetit, ai në fakt kishte hyrë tek përmbajtja e komunikimeve në fjalë. Autoritetet e brendshme nuk e kishin konstatuar faktin se në cilin moment të procedimit disiplinor punëdhënësi kishte aksesuar përmbajtjen. Pranimi që përmbajtja e komunikimeve mund të aksesohet në çdo fazë të procedimit disiplinor do të ishte në kundërshtim me parimin e transparencës ([Rekomandimi CM/Rec\(2015\)5](#) të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e punësimit).

Duke qenë kështu, gjykatat e brendshme nuk kishin konstatuar posaçërisht nëse kërkuesi ishte njoftuar paraprakisht nga punëdhënësi i tij në lidhje me mundësinë që komunikimet e tij në Yahoo Messenger mund të vëzhgoheshin; ajo nuk i kushtuan rëndësi as faktit që ai nuk ishte informuar në lidhje me natyrën ose gamën e vëzhgimit, ose shkallën e ndërhyrjes në jetën e tij private dhe korrespondencën e tij. Po ashtu, ato nuk kishin konstatuar, së pari, shkaqet specifike që justifikonin ndërhyrjen e masave vëzhguese; së dyti, nëse punëdhënësi mund të kishte zbatuar masa që përbënin një ndërhyrje më të butë në jetën private dhe korrespondencën e kërkuesit; dhe së treti, nëse komunikimet mund të ishin aksesuar pa dijeninë e tij.

Kështu, pavarësisht marzhit të gjerë të vlerësimit të Shtetit të paditur, autoritetet e brendshme nuk kishin dhënë mbrojtje të përshtatshme për të drejtën e kërkuesit për të respektuar jetën private dhe korrespondencën e tij dhe për pasojë nuk kishin mundur të vendosnin një balancë të drejtë ndërmjet interesave në fjalë.

**Përfundimi:** shkelje (njëmbëdhjetë vota me gjashtë)

Neni 41: pretendimi në lidhje me dëmin financiar rrëzohet; konstatimi i një shkeljeje i mjaftueshëm në lidhje me dëmin jo-financiar

## Neni 10

### Neni 10-1 Liria e shprehjes

OJQ-të të detyruara nga kërkesa për të verifikuar deklaratimet faktike shpifëse për individët privatë: nuk ka shkelje

**Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe të tjerë kundër Bosnjës Hercegovinës (GC) - 17224/11**, Vendim themeli 27.6.2017 (GC)

**Faktet** - Kërkuesit, një komunitet fetar myslimanësh dhe tre OJQ-ë të boshnjakëve etnikë në Rrethin Brčko u dërguan një letër autoriteteve më të larta të rrethit, duke shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me procedurën e emërimit të drejtorit të radio-stacionit publik multi-etnik duke pretenduar që një redaktore në stacion, e cila ishte propozuar për atë pozicion, kishte kryer veprime që kishin shpërfillës për myslimanët dhe boshnjakët etnikë. Menjëherë pas kësaj, letra u publikua në tre gazeta të ndryshme ditore. Redaktorja ngriti padi për shpifje në gjykatën civile. Kërkuesit u shpallën përgjegjës për shpifje dhe u urdhëruan ta tërhiqnin letrën, ose përndryshe ata duhej të paguanin kompensim për dënimin jo-financiar.

Para Gjykatës europiane kërkuesit u ankuan që dënimi i tyre shkelte të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes që është e garantuar nga Neni 10.

**Ligji** – Neni 10: Vendimet e gjykatave të brendshme përbënin ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuesve. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte një qëllim legjitim, që është ai i mbrojtjes së reputacionit të të tjerëve. Çështja qendrore para Gjykatës ishte nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Akuzimi i redaktoreve për shpërfillje në lidhje me një grup tjetër etnik dhe fetar dëmtonte jo vetëm reputacionin e saj, por shkaktoi paragjykimet në mjedisin e saj profesional dhe social. Për pasojë, akuzat arrinin nivelin asaj rëndësie që mund të dëmtonin të drejtat e saj sipas Nenit 8. Kështu, Gjykata duhej të verifikonte nëse autoritetet e brendshme kishin arritur një balancë të drejtë ndërmjet të dyja vlerave të garantuara nga Konventa, që, nga njëra anë, është liria e kërkuesve për lirinë e shprehjes të mbrojtur nga Neni 10 dhe, nga ana tjetër, e drejta e redaktoreve për të respektuar reputacionin e saj sipas Nenit 8.

Kërkuesit nuk ishin në raport të varur pune me radion publike, gjë që do të kishte bërë ata të nënshtroheshin detyrës së besnikërisë, rezervës dhe diskrecionit përkundrejt asaj dhe si e tillë, nuk ishte e nevojshme që Gjykata të konsideronte çështjet që ishin themelore në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me sinjalizuesit. Gjykata ishte e mendimit të autoriteteve të brendshme që përgjegjshmëria e kërkuesve për shpifje duhej të vlerësohej vetëm në lidhje me korrespondencën e tyre private me autoritetet lokale, dhe jo publikimin e letrës në media, pasi nuk ishte provuar që ishin ata përgjegjës për publikimin e saj.

Nëse një OJQ-ë tërhoqi vëmendjen tek çështjet me interes publik, ajo po ushtronte rolin e rojës publike të një rëndësie të veçantë si ajo e shtypit dhe mund të karakterizohet si një roje publike. Në sferën e lirisë së shtypit, për shkak të detyrave dhe përgjegjësive të brendshme gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes, garancia e dhënë nga Neni 10 për gazetarët në lidhje me raportimin për çështje të një interesi të përgjithshëm i nënshtrohej kushtit që ato vepronin në mirëbesim me qëllim që të ofronin informacione të sakta dhe të qëndrueshme në pajtim me etikën e gazetarisë. Të njëjtat konsiderata zbatoheshin për një OJQ-ë që merr përsipër ushtrimin e rolit të rojës sociale.

Në balancimin e interesave konkurruese të përfshira, ishte e përshtatshme të merreshin parasysh kriteret që përgjithësisht zbatoheshin për shpërndarjen e deklarime shpifëse nga media në ushtrim të funksionit të saj të rojës publike.

*(a) Sa i njohur ishte personi përkatës dhe kush ishte objekti i akuzave - Duke aplikuar për postin e drejtorit të radios dhe duke patur parasysh interesin publik të përfshirë në informacionin përmbajtur në letër, redaktorja duhej të konsiderohej sikur kishte hyrë në mënyrë të pashmangshme dhe të ditur në sferën publike dhe në këtë mënyrë e hapur për vëzhgim të afërt të veprimeve të saj. Në këto rrethana, kufijtë e kritikës së pranueshme ishin përkatësisht më të gjerë krahasuar me rastin e një profesionisti të zakonshëm.*

*(b) Përmbajtja, forma dhe pasojat e informacionit që u ishin kaluar autoriteteve - një faktor i rëndësishëm ishte testi i përdorur nga kërkuesit në letrën e kritikuar. Ata nuk kishin thënë shprehimisht që një pjesë e informacionit që ata u kishin kaluar autoriteteve kishte dalë nga burme të tjerë, siç janë punonjësit e radios. Ata e kishin hapur letrën e tyre me fjalët 'sipas informacioneve tona',*



por nuk kishin treguar qartazi që ata kishin vepruar si dhënës mesazhi. Kështu ata kishin lënë të nënkuptohej që ata kishin akses të drejtpërdrejtë tek ai informacion dhe në këto rrethana ata kishin marrë përgjegjësi për deklaratimet.

Një faktor tjetër i rëndësishëm ishte nëse qëllimi i deklaratimeve të kritikuara ishte kryesisht akuzimi i redaktores apo ishte për të njoftuar nëpunësit kompetentë të shtetit në lidhje me sjelljen që sipas tyre ishte e parregullt ose e paligjshme. Kërkuesit u shprehën që synimi i tyre ishte të informonin autoritetet kompetente në lidhje me parregullsi të caktuara dhe për ti nxitur ata të hetojnë dhe verifikojnë akuzat që përmbante letra. Megjithatë, letra e kritikuar nuk përmbante ndonjë kërkesë për hetim dhe verifikim të akuzave.

Në lidhje me pasojat e akuzave të mësipërme që u janë kaluar autoriteteve, ka shumë pak dyshim që të marra në tërësi dhe duke patur parasysh kontekstin specifik në të cilin ato janë bërë, sjellja që i atribuohet redaktores duhej të konsiderohej si tepër e papërshtatshme nga këndvështrimi moral dhe social. Akuzat e vendosnin atë në një pozitë të vështirë dhe ato e portretizonin atë si një person i cili nuk respekton dhe përçmon në mendimet dhe ndjenjat e saj myslimanët dhe boshnjakët etnikë. Gjykatat e brendshme ishin të mendimit që deklaratimet në fjalë përmbanin akuza shpifëse që dëmtonin reputacionin e saj dhe Gjykata nuk gjeti shkak të shprehej ndryshe. Që akuzat ou paraqitën një numri të kufizuar nëpunësish publikë nëpërmjet korrespondencës private nuk eliminonte riskun e mundshëm të efektit të dëmshëm për të ardhmen e karrierës së redaktores si një punonjëse e shërbimit civil dhe reputacionin e saj profesional si gazetare. Pavarësisht se si letra mbërriti në media, ishte e kuptueshme që publikimi i saj hapte një mundësi për debat publik dhe përforconte dëmin për dinjitetin dhe reputacionin e saj profesional.

*(c) Autenticiteti i informacionit të deklaruar* - Faktori më i rëndësishëm në lidhje me ushtrimin e balancimit në këtë çështje ishte autenticiteti i informacionit të dhënë autoriteteve. Në kontekstin e lirisë së shtypit, kërkoheshin shkaqe të posaçme para se media të lirohej nga detyrimi i saj i zakonshëm për të verifikuar deklaratimet faktike që ishin shpifëse për individët. Ashtu si gazetat, kërkuesit ishin të detyruar të respektonin kërkesën për të verifikuar vërtetësinë e akuzave të paraqitura. Kjo kërkesë gjendej e mishëruar në [Kodin e Etikës dhe Sjelljes për OJQ-të](#).

Autoritetet e brendshme ishin të mendimit që ka patur një papajtueshmëri ndërmjet asaj që u ishte dhënë kërkuesve nga punonjësit e radios dhe asaj që ata kishin raportuar në letër. Kërkuesve, si OJQ-ë anëtarët e të cilave gëzonin një reputacion të mirë në shoqëri, u kërkohet të bënin një reflektim të saktë të raportimit të punonjësve, si një element i rëndësishëm për zhvillimin dhe ruajtjen e besimit të ndërsjellë të imazhit të tyre si pjesëmarrës kompetentë dhe të përgjegjshëm të jetës publike. Gjykatat e brendshme kishin konstatuar që, ndryshe nga sa ishte pretenduar, redaktorja nuk ishte autori i komenteve të raportuara në gazetën e përjavshme. Verifikimi i atij fakti para raportimit nuk do të kërkonte ndonjë përpjekje të madhe nga ana e kërkuesve.

Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të devijuar nga konstatimet e gjykatave të brendshme që kërkuesit nuk kishin vërtetuar vërtetësinë e deklarimeve të tyre që ata dinin ose duhej të dinin se ishin të rrema dhe për pasojë nxori përfundimin që kërkuesit nuk kishin bazë të mjaftueshme faktike për pretendimet e tyre të kundërshtuara në lidhje me redaktoren në letrën e tyre.

(d) *Ashpërsia e sanksionit* - Autoritetet e brendshme kishin urdhëruar që kërkuesit të informonin autoritetet që ata kishin tërhequr letrën e tyre, dhe në rast mosveprimi ata duhej të paguanin 1 280 EUR së bashku në lidhje me dëmin jo-financiar. Shuma që kërkuesit ishin urdhëruar të paguanin ishte, në vetvete, jo-proporcionale.

Gjykata nuk konstatoi arsye të forta që do ta bënin atë të zëvendësonte qëndrimin e gjykatave të brendshme me të vetin dhe të shmangë balancimin e bërë prej tyre. Ajo u bind që ndërhyrja e kundërshtuar mbështetej në shkaqe relevante dhe të mjaftueshme dhe që autoritetet e Shtetit të paditur kishin gjetur një balancë ndërmjet interesit të kërkuesve për të drejtën e shprehjes, nga njëra anë, dhe interesit të redaktores në mbrojtje të reputacionit të saj nga ana tjetër, duke vepruar kështu brenda marzhit të vlerësimit të tyre.

**Përfundimi:** nuk ka shkelje (njëmbëdhjetë vota me gjashtë)

(See *Zakharov kundër Ruisë*, [14881/03](#), 5 tetor 2006; *Björk Eiðsdóttir kundër Islandës*, 46443/09, 10 korrik 2012, [Shënim Informativ 154](#); *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës* (GC), 49017/99, 17 dhjetor 2004, [Shënim Informativ 70](#))

## Neni 10

### Neni 10-1 Liria e shprehjes

OJQ dënohet për shkelje të të drejtave të personalitetit të politikanit duke e përshkruar të folurën si 'racizëm verbal': shkelje

**GRA Stiftung Gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës - 18597/13**,  
Vendim themeli 9.1.2018 (Seksioni III)

**Faktet** - Në nëntor 2009, krahu rinor i Partisë Popullore Zvicerane zhvilloi një demonstratë në lidhje me iniciativën publike për të mbështetur ndalimin e minareve në Zvicër. Pas demonstratës, kërkuesi, një organizatë jo-qeveritare që promovonte tolerancën dhe dënonte të gjitha llojet e diskriminimit me motive racore, bëri një postim në internet, duke cituar një fjalim të mbajtur nga një politikan i ri gjatë një demonstratë dhe i përshkoi fjalët e tij si 'racizëm verbal'. Politikani në fjalë ngriti padi për mbrojtjen e të drejtave të tij të personalitetit. Gjykata e Lartë nxori përfundimin që fjalimi i politikanit nuk ishte racist dhe urdhëroi që artikulli në fjalë të hiqet nga faqja e internetit të kërkuesit dhe të zëvendësohet me vendimin e gjykatës. Ankimi i kërkuesit nuk pati sukses.

Para Gjykatës Europiane organizata si kërkuese pretendoi posaçërisht, që gjykatat civile kishin shkelur të drejtën e saj të lirisë së shprehjes.

**Ligji** – Neni 10: Konstatimi i gjykatave të brendshme kundër organizatës kërkuese përbënte një ndërhyrje në të drejtën e saj të lirisë së shprehjes. Ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj dhe ndiqte një qëllim legjitim. Pyetja ishte nëse ndërhyrja kishte qenë e 'nevojshme në një shoqëri demokratike'.

Gjatë vlerësimit të deklaramëve në fjalë, ishte e rëndësishme të mos harrohet që konteksti i përgjithshëm i debatit politik në vazhdim në të cilën janë bërë deklaratat përkatëse. Si fjalimi ashtu edhe artikulli i organizatës kërkuese preknin një debat publik tepër intensiv në Zvicër në momentin përkatës: iniciativa popullore kundër ndërtimit të minareve që ishte raportuar gjerësisht në median kombëtare dhe ndërkombëtare. Iniciativa ishte pranuar përfundimisht me referendum më 29 nëntor 2009 dhe ndalimi ishte përfshirë në Kushtetutën zvicerane.

Politikani në fjalë ishte zgjedhur kryetar i një dege lokale të krahut rinor të partisë kryesore politike në Zvicër. Fjalimi i tij ishte qartësisht politik dhe ishte bërë në kuadrin e mbështetjes së qëllimeve politike të partisë së tij, që në atë

kohë ishte promovimi i iniciativës. Për pasojë, politikani e kishte ekspozuar veten me vullnetin e tij përkundrejt vëzhgimit publik duke deklaruar mendimet e tij politike, dhe në këtë mënyrë duhej të tregonte një shkallë të lartë tolerance përkundrejt kritikës së mundshme të deklarimeve të tij nga ata që nuk ishin i të njëjtit mendim me të. Organizata kërkuese kishte ri-prodhuar fjalimin e tij, i cili ishte publikuar në faqen e vetë partisë politike, duke e quajtur atë ‘racizëm verbal’. Gjykata e Lartë Federale ishte shprehur që klasifikimi i fjalimit si ‘racizëm verbal’ ishte një gjykim i përzier i vlerave që nuk kishte bazë faktike, pasi fjalimi nuk kishte qenë racist. Në veçanti, Gjykata e Lartë Federale ishte e mendimit që për lexuesin e zakonshëm, deklarimet nuk dukeshin si pezhorative për myslimanët, por thjesht si mbrojtëse e kristianizmit si kulturë udhëheqëse në Zvicër.

Duhej të bëhej një dallim ndërmjet deklarimeve të faktit dhe gjykimeve të vlerave. Kërkesa për të provuar të vërtetën e një gjykimi të vlerave nuk mund të përmbushej dhe shkelte në vetvete lirinë e mendimit, që ishte një pjesë themelore e së drejtës së garantuar nga Neni 10. Nëse një deklaratë shndërrohet në një gjykim vlerash, proporcionaliteti i çdo ndërhyrjeje mund të varet nga fakti nëse ka ekzistuar ‘bazë e mjaftueshme faktike’ për deklarimin në fjalë. Me qëllim që të bëhet dallimi ndërmjet një pretendimi faktik dhe një gjykimi vlerash, ishte e rëndësishme të merren parasysh rrethanat e çështjes dhe toni i përgjithshëm i thënieve, duke mos harruar që thëniet në lidhje me çështjet me interes publik, mbi këtë bazë, mund të përbëjnë gjykime vlerash dhe jo deklarime fakti.

Gjykata nxori përfundimin që klasifikimi i fjalimit nga kërkuesi si ‘racizëm verbal’ përbente një gjykim vlerash, pasi ai përmbante komentin e vet të organizatës kërkuese mbi deklarimet. Nuk mund të thuhet që klasifikimi i fjalimit si ‘racizëm verbal’, kur ai mbështeste një iniciativë që ishte përshkruar tashme nga shumë organizata si diskriminuese, ksenofobe ose raciste, mund të konsiderohet pa asnjë bazë faktike. Kërkuesi nuk kishte lënë asnjë herë të kuptohet që deklarimet përfshiheshin brenda kuadrit të veprës penale të diskriminimit racial në bazë të Kodit Penal Zviceran. Në fakt, në argumentet e saj para autoriteteve të brendshme dhe Gjykatës, organizata kërkuese kishte theksuar nevojën për të qenë në gjendje të përshkruante një deklaram të një individi si racist pa nënkuptuar domosdoshmërisht përgjegjësi penale.

Përshkrimi në fjalë nuk mund të kuptohej si sulm personal dhe pa shkak ose si një ofendim për politikanin. Organizata kërkuese nuk i ishte referuar jetës

private ose familjare, por mënyrës se si ishte perceptuar fjalimi i tij politik. Si politikan që shpreh mendimin e vet publikisht për një çështje sensitive, ai duhej ta dinte që fjalimi i tij mund të shkaktonte një reaksion kritik tek kundërshtarët e tij politikë. Për sa më sipër, kategorizimi i kundërshtuar i deklaramit të tij si ‘racizëm verbal’ nuk mund të thuhet se ka patur ndonjë pasojë të dëmshme për jetën e tij private dhe profesionale. Sanksioni i vendosur, sado i butë, mund të ketë patur një ‘efekt frenues’ mbi ushtrimin e lirisë së shprehjes për organizatën kërkuese, pasi mund ta ketë dekurajuar nga vazhdimi i qëllimeve të saj statutore dhe kritika e deklarimeve politike dhe politikave në të ardhmen.

Gjykatat e brendshme nuk u kishin dhënë rëndësinë e duhur parimeve dhe kriterëve të përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës për balancimin e së drejtës së respektimit të jetës private dhe së drejtës së lirisë së shprehjes. Ato e kishin tejkaluar marzhin e vlerësimit të dhënë atyre dhe nuk kishin gjetur një balancë të arsyeshme proporcionalitetit ndërmjet masave kufizuese për të drejtën e lirisë së shprehjes së organizatës kërkuese dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 5,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë* (GC), 18030/11, 8 nëntor 2016, [Shënim Informativ 201](#); dhe *Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës* (GC), 40454/07, 10 nëntor 2015, [Shënim Informativ 190](#))

\*Shih për shembull [Raportin e ECRI-t 2009 mbi Zvicrën](#) dhe një [Raportin e vitit 2014 të Komitetit të OKB-së mbi eliminimin e diskriminimit racial](#)

## Neni 14

### Diskriminimi

#### Neni 3 Hetimi efektiv

##### Detyrime pozitive

**Škorjanec kundër Krocisë - 25536/14**, Vendim Themeli 28.3.2017 (Seksioni II)

**Faktet** - Kërkuesja dhe partneri i saj, i cili ishte me origjinë romë, u sulmuan nga dy individë që shprehën ofendime kundër romëve menjëherë para dhe pas

sulmit. Kërkuesja u trajtua si dëshmitar në një çështje penale dhe jo si viktimë së bashku me partnerin e saj. Në gjykimin në pajtim me Konventën, kërkuesi pretendoi mospërmbushjen nga autoritetet e brendshme të detyrimeve pozitive në lidhje me një veprim dhune me motive racore kundër saj në shkëlqje të Neneve 3 dhe 14.

**Ligji** - Neni 3 (*aspekti procedural*) në lidhje me Nenin 14: Detyrimi i autoriteteve për të gjetur një lidhje ndërmjet qëndrimeve raciste dhe një veprimi të dhënë dhune, që ishte pjesë e përgjegjësisë së Shteteve në pajtim me Nenin 3 të marrë së bashku me Nenin 14, kishte të bënte jo vetëm me veprimet e dhunës bazuar në statusin ose karakteristikat personale faktike ose të perceptuara të një viktime, por edhe veprimet e dhunës bazuar në shoqërimin ose lidhjen faktike ose të prezumuar të një viktime me një person tjetër që faktikisht ose në mënyrë të prezumuar kishin një status të veçantë ose karakteristikë të mbrojtur. Në këto raste, autoritetet duhej të bënin atë që ishte e arsyeshme në rrethanat përkatëse për të mbledhur dhe siguruar provat, shihnin të gjitha mjetet praktike për të zbuluar të vërtetën dhe dhënë vendime të paanshme, objektive dhe me arsyetim të plotë, pa lënë jashtë fakte të dyshimta që mund të tregonin dhunën me motive racore.

Neni 3 kërkonte zbatimin e mekanizmave të përshtatshëm të së drejtës penale, menjëherë sapo niveli i ashpërsisë së dhunës së ushtruar nga individë privatë të merrte mbrojtjen sipas kësaj dispozite. Këta parime zbatohen *a fortiori* në rastet e dhunës së motivuar nga diskriminimi racial. Gjykata ishte e mendimit që sistemi ligjor kroat parashikon mekanizma të përshtatshëm ligjorë për të ofruar një nivel të pranueshëm të mbrojtjes për kërkuesit në rrethanat përkatëse. Megjithatë, në këtë rast, autoritetet e ndjekjes penale e kishin përqendruar hetimin dhe analizën e tyre vetëm në elementin kriminal të urrejtjes në lidhje me sulmin e dhunshëm ndaj partnerit të kërkueses. Ato nuk bënë ndonjë vlerësim të hollësishëm të faktorëve përkatës të situatës dhe të lidhjes ndërmjet marrëdhënies së kërkueses me partnerin e saj dhe motivit racist për sulmin ndaj tyre. Kërkuesja kishte ngritur pretendime specifike për dhunë me motive racore drejtuar ndaj saj në ankesën e saj penale. Insistimi i autoriteteve të ndjekjes penale mbi faktin që ajo vetë nuk ishte me origjinë rome dhe mosidentifikimi nga ana e tyre nëse ajo ishte perceptuar nga sulmuesit si me origjinë rome, si dhe mosmarrja parasysh prej tyre dhe mosvendosja e lidhjes ndërmjet motivit racor për sulmin dhe shoqërimin e kërkueses me partnerin e saj kishte rezultuar në një vlerësim të mangët të

rrethanave të çështjes. Kjo e kufizonte përshtatshmërinë e reagimit procedural të autoriteteve të brendshme ndaj pretendimeve të kërkueses për një sulm të dhunshëm me motive racore ndaj saj në një masë që ishte e papajtueshme me detyrimin e shtetit për marrjen e të gjitha masave të arsyeshme për të nxjerrë në pah rolin e motiveve raciste në incident.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 12,500 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu, *Šečić kundër Kroacisë*, 40116/02, 31 maj 2007, [Shënim Informativ 97](#); *Abdu kundër Bullgarisë*, 26827/08, 11 mars 2014, [Shënim Informativ 172](#); *Balázs kundër Hungarisë*, [5529/12](#), 20 tetor 2015; dhe *R.B. kundër Hungarisë*, 64602/12, 12 prill 2016, [Shënim Informativ 195](#))

## Neni 46

### Neni 46-2 Ekzekutimi i vendimit

#### Masat individuale

#### Masat e përgjithshme

## Neni 5

### Neni 5-1-e Personat me çrregullime mendore

#### Nenet 5-4 Rishikimi i ligjshmërisë së ndalimit / Shpejtësia e rishikimit

Shteti i paditur duhet të ofrojë garanci procedurale ndaj arbitraritetit në lidhje me shtrimin e detyruar në spitale psikiatrikë

***N. kundër Rumanisë - 59152/08***, Vendim Themeli 28.11.2017 (Seksioni IV)

**Faktet** - Në janar të vitit 2001 filloi gjykimi penal në ngarkim të D. i dyshuar për incest dhe korruptimit të të dy vajzave të tij të mitura (gjykimi u ndërpre në vitin 2002). Ai u shtrua në një spital psikiatrik, një masë e lënë në fuqi në prill të vitit 2002 në mungesë të kërkuesit. Pas ndryshimeve legjislative që synonin

konsolidimin e të drejtave të njerëzve me aftësi të kufizuara, ligjshmëria e ndalimit të vazhduar të kërkuesit u rishikua periodikisht nga shtatori 2007 e në vazhdim. Megjithatë, ai mbeti në spitalin psikiatrik pasi ekspertët mjekësorë konstatuan që ai vuante nga skizofrenia paradoide. Në gusht të vitit 2012, gjykata e rrethit u shpreh që në parim kërkuesi duhej të lirohej nga spitali, por ai duhej të mbetej i ndaluar provizorisht deri sa të lirohet një vend në një institucion të përshtatshëm. Në shkurt 2017, gjykata e shkallës së parë urdhëroi që ndalimi i kërkuesit duhej të zëvendësohej me trajtim të detyruar deri në shërimin e tij, por përpjekjet për të siguruar lirimin e tij nuk sollën dobi.

**Ligji** – Neni 5, par 1: Privimi nga liria e kërkuesit futej në sferën e zbatimit të nën-paragrafit (e), meqenëse çrregullimet e tij mendore ishin konfirmuar nga një sërë vlerësimesh të mjekësisë ligjore.

(a) *Ndalimi i vazhduar pas vitit 2007* - Në pajtim me legjislacionin e brendshëm, sëmundja mendore e një të ndaluar psikiatrik duhej të përbënte një rrezik për shoqërinë. Për më tepër, neni 5, par 1 (e), nënkuptonte që nëse nuk është parashikuar trajtim mjekësor, ndalimi i një personi me çrregullime mendore kërkonte një justifikim të posaçëm në lidhje me seriozitetin e çrregullimeve dhe nevojës për mbrojtjen e personit përkatës ose të tjerë.

Në çështjen konkrete, në rishikimin e parë të ndalimit të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë e kishte bazuar vendimin e saj në një referencë të thjeshtë tek dy aspekte kryesore: akuza penale e ngritur fillimisht ndaj kërkuesit (incest dhe korruptim i të miturve); dhe skizofrenia paradoide (sipas ekspertizës mjekësore të nxjerrë në korrik 2007).

Në lidhje me akuzat, gjykata ishte mbështetur tërësisht tek dosja e paraqitur nga prokuroria. Megjithatë, prokurori publik e kishte pushuar akuzën e incestit për mungesë provash. Akuza e korruptimit të të miturve më vonë ishte bërë shkak për një konstatim që nuk kishte çështje për të shqyrtuar përsa i takon mosbindjes së kërkuesit. Ky konstatim nuk u rishikuar asnjëherë nga ndonjë gjykatë. Ndërsa akuzat nuk ishin shqyrtuar nga një gjykatë në gjykime mbi bazë kontradiktoriteti. Për pasojë, referenca tek ato nuk ishte e mjaftueshme për të provuar rrezikshmërinë.

Në lidhje me çrregullimet mendore të kërkuesit, në vend të vlerësimit të rrezikut që ai sillte, gjykata thjesht ia kishte referuar konkluzionet e ekspertizës mjeko-ligjore (që kishte rekomanduar vazhdimin e ndalimit), një qëndrim që



tashmë ishte kritikuar nga Gjykata. Përveç kësaj, as gjykata dhe as autoritetet mjekësore nuk kishin raportuar ndonjë veprim dhune të kërkuesit gjatë ndalimit të tij. Përkundrazi, sipas vlerësimit të tij të korrikut 2007, kërkuesi ishte sjellë qetësisht, nuk e kishte kundërshtuar trajtimin e tij, nuk kishte shkaktuar konflikte me pacientë të tjerë dhe kishte treguar një nivel të ulët armiqësie gjatë marrjes së trajtimit.

Rishikimet e mëvonshme nuk e kishin sqaruar nëse kërkuesi përbënte një rrezik të mundshëm, pasi ishte ndjekur i njëjti qëndrim formalistik dhe sipërfaqësor; dhe as ankimet e kërkuesit ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe as procedimet që ai kishte nisur veçmas nuk kishin hedhur dritë mbi këtë çështje.

Për më tepër, as autoritetet mjekësore dhe as gjykata vetë nuk kishte shqyrtuar nëse mund të ishin zbatuar masa alternative.

Për pasojë, në mungesë të një vlerësimi të rrezikut të përbërë nga kërkuesi, ndalimi i tij nuk kishte patur bazë ligjore dhe nuk ishte i justifikuar sipas nënparagrafit (e) të Nenit 5, par 1. Kjo ka qenë e diskutueshme edhe në dritën e Nenit 14, par 1 (b) të [Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#) (KDPAK), që parashikonte posaçërisht që ekzistenca e një aftësie të kufizuar në vetvete në asnjë rast nuk justifikon provimin e lirisë.

Megjithëse eventualisht ka patur një rishikim të faktit nëse kërkuesi përbënte rrezik, autoritetet e brendshme nuk kishin deklaruar informacionin faktik që ishte bërë shkak për ndryshimin në vlerësimin e ekspertëve mjeko-ligjorë.

(b) Nëse ishte e nevojshme të vazhdohej me ndalimin e kërkuesit pasi vendimi gjyqësor urdhëronte lirimin e tij - Në vendimin e muajit gusht 2016, ndërsa theksonte nevojën e përfundimit të ndalimit të kërkuesit, Gjykata e Rrethit i mbajti masat në fuqi pa treguar shkaqet përkatëse ligjore.

Për më tepër, pas miratimit të vendimit përfundimtar në shkurt 2017 që urdhëronte lirimin e kërkuesit, as autoritetet e brendshme dhe as Qeveria nuk treguan ndonjë procedurë të zbatueshme për situatën e kërkuesit që atij ti jepej mundësia e vlerësimit të situatës së tij para lirimit ose transferimit në një qendër tjetër që të përmbushë nevojat e tij. Nuk u përmend as mundësia e lirimit me kusht ose gradual.

Megjithëse kërkuesi kishte rënë dakord të rrinte i ndaluar deri në momentin që shërbimet sociale të gjenin një zgjidhje të përshtatshme për situatën e tij, atij duhej ti ishin dhënë garanci të përshtatshme mbrojtëse që të garantonin që ai mund të lirohej pa asnjë vonesë tjetër.

Duke pranuar që vendimet e përmendura më sipër mbështeteshin në praktika që po miratohen gjithmonë e më shumë në vitet e fundit në nivel ndërkombëtar duke inkurajuar trajtimin dhe kujdesin për njerëzit me paaftësi brenda komunitetit sipas rastit. (shih Nenin 19 të KDPAK [udhëzimet](#) e nxjerra nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ose [Strategjia e Këshillit të Europës për Aftësinë e Kufizuar 2017-2023](#)).

Megjithatë, zbatimi i tyre ngriti çështje shtesë në bazë të Nenit 5, par 1. Faktikisht kërkuesi nuk ishte liruar akoma. Sidoqoftë, kishte mbetur pa u bërë një vlerësim rigoroz i nevojave të tij specifike dhe e masave të përshtatshme në kuptimin e mbrojtjes sociale. Për më tepër, përpjekjet e autoriteteve të brendshme nuk dolën të dobishme për shkak të mungesës së institucioneve që mund të akomodonin atë.

Kjo situatë e kushteve ishte një reflektim i realiteteve ekzistuese në Rumani, siç është përshkruar më parë nga organe të tjera ndërkombëtare (si [Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajnimin dhe Dënimin Çnjerëzor dhe Poshtëruet](#) (KPT) ose Këshilli Europës [Komisioneri për të Drejtat e Njeriut](#)).

Vazhdimi i ndalimit të kërkuesit pas vendimit të datës 29 gusht 2016 ishte arbitrar.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 5, par 4: Zbatimi i legjislacionit përkatës rumun, i cili kishte hyrë në fuqi në shtator 2006, ishte i papërshtatshëm për të garantuar të drejtat e kërkuesit.

(a) *Natyra periodike e rishikimeve:* Rishikimet nga gjykatat të domosdoshmërisë së ndalimit të kërkuesit ndaheshin nga periudha kohore prej pesëmbëdhjetë muajsh (shkurt 2015 - maj 2016), gjashtëmbëdhjetë muaj (tetor 2008 - shkurt 2010) bile edhe tre vjet e tetë muaj (prill 2010 - dhjetor 2013). Nuk ishte dhënë asnjë arsye e posaçme për të justifikuar këto vonesa. Për më tepër, këto periudha i kishin kaluar në masë të konsiderueshme afatet kohore të parashikuara nga drejta e brendshme (gjashtë muaj, dhe në vijim dymbëdhjetë muaj nga viti 2014).

Gjykata ka vënë re me shqetësim praktikën e vlerësimit në retrospektivë të nevojës për ndalim të vazhduar mbi bazën e informacionit mjekësor të marrë para një periudhe të gjatë kohore (për shembull, më shumë se një, dy ose tre vjet paraprakisht) që nuk reflektonin domosdoshmërisht gjendjen e personit të ndaluar në momentin e vendimit. Një vonesë e tillë ndërmjet vizitës mjekoligjore dhe vendimit pasues në vetvete mund të jetë në kundërshtim me parimin në themel të Nenit 5 të Konventës, që është mbrojtja e individëve ndaj arbitraritetit.

Së fundmi, në masën që vonesat e sipërpërmendura mund të shpjegohen nga nevoja për të marrë raportet mjeko-ligjore të kërkuara, gjykata nuk duke se kishte kërkuar të dinte në lidhje me progresin në punën e ekspertëve, ose të ketë përdorur kompetencat e veta duke i gjobitur ekspertët që nuk kishin respektuar detyrimet në paraqitjen e një raporti.

Për pasojë, kërkesa e rishikimit ‘të shpejtë’ nuk ishte përmbushur.

(b) *Asistenca ligjore*: Kërkuesi, i cili vuante nga çrregullime mendore që e pengonin atë të ndiqte si duhet gjykimin, kishte pranuar asistencën e avokatit të caktuar kryesisht. Megjithatë, ai ishte përfaqësuar nga një avokat i ndryshëm në secilën fazë të gjyimit, pa qenë në gjendje për të biseduar me ta, duke mos qenë në gjendje të takonte avokatët e ndryshëm para seancave gjyqësore. Në pjesën më të madhe të çështjeve, avokatët e tij kishin parashtruar në mbështetje të vazhdimit të ndalimit të tij ose e kishin lënë çështjen në çmuarje e gjykatës.

Duke mos diktuar se si avokatët duhet të trajtojnë çështjet në të cilat ata përfaqësojnë një person me çrregullime mendore, Gjykata konstatoi që ka patur mungesë të asistencës së efektshme.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 46

*Masat individuale*: Me qëllim që të korrigohet shkelja e të drejtave të siguruara kërkuesit sipas Nenit 5, autoritetet duhet të zbatojnë pa vonesë vendimin përfundimtar të Gjykatës së Rrethit që urdhëron lirimin e tij në kushtet që përmbushin nevojat e tij.

*Masat e përgjithshme*: Meqenëse mangësitë e identifikuar në këtë çështje mund të bëhen shkak për kërkesa të mirë-bazuara në të ardhmen, Gjykata

rekomandoi që Shteti i paditur të parashikonte masa të përgjithshme për të garantuar: që ndalimi i individëve në spitale psikiatrikë të jetë i ligjshëm, i justifikuar dhe jo-arbitrar; dhe që çdo individ të jetë në gjendje ti drejtohet gjykatës duke i dhënë garanci në lidhje me garantimin e një vendimi të shpejtë gjyqësor në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të tij.

Neni 41: 30,000 EUR në lidhje me dëmin jo-financiar.

### **Neni 3 i Protokollit nr 1.**

#### **Shprehja e lirë e mendimit të njerëzve**

Moshetimi i përshtatshëm nga autoritetet e brendshme i parregullsive të rënda zgjedhore: *shkelje*

***Davydov dhe të Tjerë kundër Rusisë - 75947/11***, Vendim themeli 30.5.2017 (Seksioni III)

**Faktet** - Çështja kishte të bënte me zgjedhjet e nivelit vendor dhe federal të datës 4 dhjetor 2011 për në Asamblenë Legjislative të St Petersburgut dhe Dumës Shtetërore të Federatës Rusë (dhoma e ulët e parlamentit rus). Kërkuesit morën pjesë në zgjedhje në cilësi të ndryshme: të gjithë ishin votues të regjistruar, disa ishin si kandidatë për Asamblenë Legjislative dhe të tjerë anëtarë të komisioneve elektorale ose vëzhgues. Në gjykimin në pajtim me Konventë, kërkuesit u ankuan në lidhje me shkeljen e së drejtës së tyre për zgjedhje të lira gjatë zgjedhjeve dhe mosgarantimin nga autoritetet e brendshme të një rishikimi të efektshëm të pretendimeve të tyre. Ata pretenduan që komisionet zgjedhore kishin falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve duke urdhëruar rinumërimet në të cilat partia në pushtet *Yedinaya Rossiya* dhe kandidatët e saj iu dhanë sistematikisht më shumë vota, ndërsa partitë dhe kandidatët në opozitë iu hoqën votat. Disa prej kërkuesve ishin ankuar tek Komisioni Zgjedhor i Qytetit të St Petersburgut, ndërsa të tjerë kishin bërë denoncime dhe akuzuar komisionet përkatëse zgjedhore në gjykatat e brendshme. Megjithatë, pretendimet e tyre ishin rrëzuar.

**Ligji** - Neni 3 i Protokollit nr 1.

(a) *Zbatueshmëria* - Është e qartë se zgjedhjet për në Dumën Shtetërore kualifikohen si zgjedhje të 'një organi legjislativ' brenda kuptimit të Nenit 3 të Protokollit nr. 1.

Asambleja Legjislative e St Petersburgut ishte një organi i qeverisë demokratike të një prej subjekteve të Federatës Rusë, e veshur me një gamë të gjerë kompetencash në territorin përkatës, bazuar në ndarjen kushtetuese të pushteteve ndërmjet rajoneve dhe Federatës. Si e tillë, ajo gjithashtu përfshihej në përkufizimin e 'organit legjislativ' brenda kuptimit të Nenit 3 të Protokollit nr 1.

(b) *Themeli* – Rekomandimet e hollësishme të bëra në Raportin shpjegues të Komisionit të Venecias [Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore\\*](#) reflektonin rëndësinë e hollësive teknike që mund të ishin thelbësore për të garantuar një procedurë të hapur dhe transparente për të garantuar vullnetin e votuesve nëpërmjet numërimit të fletëve të votimit dhe regjistrimin e saktë të rezultateve zgjedhore në të gjithë sistemin, nga qendra lokale e votimit tek Komisionin Qendror Zgjedhor. Ato konfirmuan që fazat pas votimit që kanë të bëjnë me numërimin, regjistrimin dhe transferimin e rezultateve të zgjedhjeve përbëjnë një pjesë të domosdoshme të procesit zgjedhor. Si të tilla, ato duhet të arrihen me garanci të qarta procedurale, të jenë të hapura dhe transparente dhe të lejojnë vëzhgimin nga të gjithë anëtarët në të gjithë spektrin politik, duke përfshirë opozitën.

Megjithatë, Neni 3 i Protokollit nr. 1 nuk u konsiderua si një kod për çështjet zgjedhore i destinuar për të rregulluar të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Për pasojë, niveli i shqyrtimit të Gjykatës do të varej nga aspekti i diskutuar i së drejtës për zgjedhje të lira. Një shqyrtim më i rreptë duhet ti përkushtohet çdo shmangieje nga parimi i së drejtës universale për zgjedhje ndërsa Shteteve mund tu jepet një marzh i gjerë vlerësimi ku masat kanë penguar kandidatët nga kandidimi për në zgjedhje. Një shqyrtim më shumë rigoroz do ti kushtohet fazës teknike të numërimit të votave dhe përpunimit të tyre: thjesht një gabim ose parregullsi në këtë fazë, në vetvete, nuk do të tregonte parregullsi të zgjedhjeve nëse parimet e përgjithshme të barazisë, transparencës, paanësisë dhe pavarësisë së administrimit zgjedhor janë respektuar. Koncepti i zgjedhjeve të lira do të rrezikohet nëse (i) ka patur prova të shkeljeve procedurale që mund të shtrembërojnë shprehjen e opinionit të njerëzve, për shembull nëpërmjet

shtrembërimet të hapur të synimit të votuesve, dhe (ii) këto ankesa nuk janë trajtua në mënyrë efektive nga gjykatat e brendshme (megjithëse Gjykata konfirmoi në këtë kontekst që e drejta e një votuesi individual për të bërë ankim mund tu nënshtrohej kufizimeve të arsyeshme siç është kërkesa për një numër të caktuar votuesish).

(i) *Serioziteti i shkeljeve procedurale* - Elementet e mëposhtëm të ankesave të kërkuarve për padrejtësi në zgjedhje ishin të pakundërshtuara: (i) rezultatet në pothuaj gjysmën e zonave zgjedhore të kundërshtuara fillimisht në zgjedhjet për në Asamblenë Legjislative të St Petersburgut (dhe tre të katërtat e kundërshtuara në zgjedhjet për në Dumën Shtetërore) u deklaruan të pavlefshme nga komisionet zgjedhore territoriale (KZT) dhe u urdhëruan rinumërimet; (ii) Vendimet e KZT-ve ishin të përgjithshme dhe me tekst të ngjashëm, duke e bërë të vështirë të vlerësohet nëse kanë qenë të justifikuara; (iii) përbërja e KZT-ve që vendosën për zhvillimin e rinumërimit përjashtuan anëtarët nga partitë opozitare në një numër të madh rastesh; (iv) disa prej anëtarëve të komisioneve zgjedhore të zonave (KZZ) përkatëse nuk ishin njoftuar për vendimet e marra dhe në këtë mënyrë nuk morën pjesë në rinumërim; (v) rinumërimet u kryen në një kohë kaq të shkurtër që ngrinin çështjen e aftësisë së tyre për respektimin e kërkesave procedurale të legjislacionit të brendshëm; (vi) anëtarët e partive opozitare mungonin sistematikisht nga procesi i rinumërimit në nivel territorial dhe zone; dhe (vii) si rezultat i rinumërimit partia qeveritare kishte fituar me shumicë dhe partitë opozitare kishin humbur.

Përveç kësaj, pretendimet e kërkuarve ishin mbështetur në mënyrë të tërthortë nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), një mision me vëzhgues ndërkombëtarë të pavarur dhe të besueshëm, që identifikoi numërimin dhe përpunimin e rezultateve si fazat më problematike të zgjedhjeve në fjalë.

Kërkuarët në këtë mënyrë kishin prezantuar tek autoritetet e brendshme dhe tek Gjykata, një pretendim të diskutueshëm që rregullsia në zgjedhje ishte kompromentuar seriozisht nga procedura e rinumërimit. Një parregullsi e tillë ishte në gjendje të çonte në shtrembërim të konsiderueshëm të synimit të votuesve në secilën zonë përkatëse. Kështu, ishte e nevojshme të përcaktohet nëse kërkuarve u ishin marrë parasysh efektivisht këto ankesa në nivelin e brendshëm.

(ii) *Efektiviteti i shqyrtimit të ankesave të kërkuessve në nivelin e brendshëm* - Ndërmjet tyre, kërkuessit kishin provuar të gjitha mjetet e mundshme sipas legjislacionit të brendshëm që konsideroheshin nga Qeveria si efektive dhe të aksesueshme. Megjithatë, Komisioni Zgjedhur i Qytetit nuk i kishte shqyrtuar në themel ankimet e kërkuessve, por ua kishte kaluar to zyrave të prokurorit. Nga ana e tyre, zyra e prokurorisë dhe komiteti hetimor nuk kishte parë asnjë shkak për të ndërmarrë ndonjë hap procedural që synonte verifikimin e pretendimeve të mashtrimit në zonat përkatëse dhe nuk kishte hapur hetime penale, duke përfaqësuar mendimin që çështja përfshihej në sferën e gjykatave përkatëse. Nga ana tjetër, megjithëse kompetente sipas legjislacionit federal dhe rajonal për të zhvilluar një vlerësim të pavarur dhe efektiv të pretendimeve të shkeljeve të së drejtës për zgjedhje të lira dhe të ndershme, gjykatat përgjithësisht ishin kufizuar në shqyrtimin në themel të pretendimeve, duke e kufizuar analizën e tyre tek çështje të parëndësishme të formaliteteve dhe duke injoruar provat që tregonin shkelje serioze dhe të përhapura të kërkesave të procedurës dhe transparencës. Në thelb, ato kishin miratuar vendimet e komisioneve zgjedhore, pa u angazhuar në shqyrtime reale të shkaqeve për kundërshtim.

Për pasojë ka patur një shkelje të Nenit 3 të Protokollit nr. 2 në masën që kërkuessve u ishte mohuar shqyrtimi i efektshëm i ankesave të tyre në lidhje me parregullsitë serioze në procedurën në të cilën ishin numëruar votat.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 41: 7 50 EUR për secilin nga kërkuessit që kanë ngritur pretendim në lidhje me dëmin jo-financiar.

(Shih gjithashtu *Namat Aliyev kundër Azerbaxhanit*, 18705/06, 8 prill 2010, [Shënim Informativ 129](#); *Kerimova kundër Azerbaxhanit*, 20799/06, 30 shtator 2010, [Shënim Informativ 133](#); dhe *Riza dhe të Tjerë kundër Bullgarisë*, 48555/10 dhe 48377/10, 13 tetor 2015, [Shënim Informativ 189](#))

\*Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (Udhëzime dhe Raporti Shpjegues) (CDL-AD (2002) 23 rev), i miratuar nga Komisioni European për Demokraci nëpërmjet Ligjit ("Komisioni i Venecias")

## **Neni 2 i Protokollit nr 4.**

### **Neni 2, par 1 i Protokollit nr. 4 Liria e Lëvizjes**

Mungesa e qartësisë e legjislacionit italian në lidhje me nxjerrjen e urdhrave të ‘mbikëqyrjes së posaçme policore’ konsiderohet rrezik për shoqërinë: *shkelje*

## **Neni 5**

### **Neni 5-1 Heqja e lirisë**

Caktimi i masave parandaluese që vendosin kufizime mbi lirinë e lëvizjes së individëve konsiderohet rrezik për shoqërinë: *Neni 5 nuk zbatohet*

## **Neni 6**

### **Gjykimi civil**

#### **Neni 6-1 Të drejtat dhe detyrimet civile / Seanca publike**

Caktimi i masave parandaluese pa seancë publike *Neni 6, i zbatueshëm; shkelje*

***De Tommaso kundër Italisë (GC) - 43395/09*** - Vendim themeli 23.2.2017 (GC)

**Faktet** - Ligji italian parashikon mundësinë e caktimit të masave ‘parandaluese’ - që kanë të bëjnë me kufizimin e lirive të ndryshme - për personat që përbëjnë rrezik për sigurinë dhe moralin publik (Ligji nr 1432 i datës 27 dhjetor 1956).

Kërkuesi ishte shpallur më parë disa herë fajtor për vepra penale në lidhje me trafikun e drogës dhe zotërim të paligjshëm të armëve. Në vitin 2007, prokurori publik rekomandoi, në bazë të dyshimeve të vazhdueshme në lidhje me sjelljen e kërkuesit dhe burimin e të ardhurave, që ai të vendoset nën ‘mbikëqyrje të posaçme policore’ në pajtim me ligjin e sipërpërmendur. Në vitin 2008, një gjykata rrethi vendosi masën e kërkuar, duke sjellë numrin e mëposhtëm të detyrimeve për një periudhë prej dy vjetësh: raportimin një herë në javë tek autoriteti policor përgjegjës për mbikëqyrjen; kërkimi për punë brenda një muaji; mosndryshimi i vendit të banimit; bërja e një jete të ndershme dhe në respekt të ligjit dhe mosdhënia shkak për dyshime; mosshoqërimi me persona që kishin precedentë penalë dhe që u janë nënshtruar masave parandaluese ose të sigurisë; moskthimi në banesë më vonë se ora 10 e darkës ose moslargimi para orës 6 në mëngjes, përveç në rast domosdoshmërie dhe vetëm pasi të



ketë njoftuar në kohë autoritetet; mosmbajtja e armëve; mosshkruajra në bare, klube nate, salla lojërash ose shtëpi publike dhe mosprania në takime publike; mospërdorimi i telefonave celularë ose mjeteve të komunikimit në radio; dhe mbajtja me vete e dokumentit që caktonte këto detyrime (*carta precettiva*) dhe paraqitja e saj autoritetit të policisë nëse i kërkohet.

Shtatë muaj më vonë, ky vendim u rrëzua nga Gjykata e Apelit, që ishte e mendimit që në momentin kur u caktua masa, rreziku i nga kërkuesi nuk ishte i mbështetur nga asnjë aktivitet kriminal në vazhdim nga ana e tij.

**Ligji** - Neni 5, par 1: Neni 5 nuk trajtonte thjesht kufizimet e lirisë së lëvizjes, që ishin rregulluar nga Neni 2 i Protokollit nr. 4. Si përjashtim, në çështjen *Guzzardi kundër Italisë* ([7367/76](#), i datës 6 nëntor 1980) Gjykata ishte e mendimit që masat e kësaj natyre mund të thuhet se përbënin privimin e lirisë në kuptimin e hapësirës tepër të ngushtë ku kërkuesi ishte kufizuar, mbikëqyrjes pothuaj të përhershme që ai i ishte nënshtruar dhe faktit që për të ishte pothuaj tërësisht e pamundur për të patur kontakte sociale. Në të gjitha çështjet pasuese, Gjykata nuk kishte konstatuar që ka patur rrethana të krahasueshme, duke përfshirë rastet kur kërkuesve u ishte ndaluar largimi nga banesa gjatë natës.

Në rastin konkret, arsyet e mëposhtme e bënë Gjykatën të konstatojë që masat në fjalë nuk përbënin heqje lirie: (a) kërkuesi nuk ishte detyruar të banonte brenda një hapësire të kufizuar; (b) ndërsa ai ishte i lirë të largohej nga banesa gjatë ditës, ai kishte qenë në gjendje të bënte jetë sociale dhe të ruante marrëdhënien me botën e jashtme; (c) ndalimi i largimit nga banesa gjatë natës përveç se në rastet e domosdoshmërisë (ndërmjet orës 10 të darkës dhe 6 të mëngjesit) nuk mund të barazoheshin me arrestin e shtëpisë; dhe (d) ai nuk kishte kërkuar asnjëherë leje nga autoritetet për tu larguar nga vendi i tij i banimit.

Kështu, Neni 5 nuk zbatohet.

**Përfundim:** i papranueshëm (shumica).

Neni 2 i Protokollit nr. 4: Masat në fjalë kishin një bazë ligjore, që është Ligji nr 1432/1956, siç interpretohet në dritën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas mendimit të gjykatës, megjithatë, caktimi i masave parandaluese për kërkuesin nuk ka qenë i parashikueshëm në masë të mjaftueshme dhe nuk ishte shoqëruar me garanci të përshtatshme ndaj abuzimeve të mundshme

të ndryshme. Ligji në fjalë ishte i përpiluar të terma të paqarta dhe tepër të gjerë, duke mos qenë i qartë dhe i saktë në masë të mjaftueshme në lidhje me individët për të cilët janë të zbatueshme masat (Seksioni 1 i Ligjit) dhe përmbajtjen e këtyre masave (Seksioni 3 dhe 5 i Ligjit).

(a) *Personat e synuar nga masat* - Mbi bazën e konsideratave të mëposhtme, Gjykata arriti në përfundimin që, për shkak të mungesës së një përkufizimi të qartë të objektit dhe mënyrës së ushtrimit të diskrecionit tepër të gjerë të dhënë gjykatave, Ligji nuk jepte mbrojtjen e mjaftueshme ndaj ndërhyrjes arbitrare dhe nuk i kishte dhënë mundësi kërkuesit për të rregulluar sjelljen e tij dhe të parashikonte në një shkallë të caktuar në masën e mjaftueshme caktimin e masave parandaluese.

(i) Në praktikën gjyqësore të fundit, Gjykata Kushtetuese Italiane ishte e mendimit, në përgjigje të pretendimit që dispozitat përkatëse nuk kanë qenë të sakta në masë të mjaftueshme, që thjesht përkatësia tek një prej kategorive të individëve të referuar në Seksionin 1 të Ligjit nuk ishte e mjaftueshme të justifikohet caktimi i masës parandaluese, dhe që masa parandaluese nuk mund të miratohej mbi bazën e thjesht dyshimit.

Pavarësisht këtyre treguesve, fakt mbetet që as Ligji dhe as Gjykata Kushtetuese nuk kishin identifikuar qartë ‘provat faktike’ ose tipet specifike të sjelljes që duhej të merreshin parasysht me qëllim që të vlerësohej rreziku për shoqërinë që vinte nga individi.

(ii) Në çështjen konkrete, Gjykata e Rrethit e kishte bazuar vendimin e saj në ekzistencën e tendencave kriminale ‘aktive’ nga ana e kërkuesit, megjithatë nuk i kishte veshur atij ndonjë sjellje specifike apo aktivitet kriminal.

Për më tepër, gjykata kishte përmendur si shkaqe për masën parandaluese faktin që kërkuesi nuk kishte ‘punë të përhershme dhe të ligjshme’ dhe jeta e tij karakterizohej nga shoqërimi i rregullt me kriminele të njohur lokalë (*malavita*) dhe kryerja e veprave penale.

Me fjalë të tjera, ajo e kishte bazuar arsyetimin e saj mbi prezumimet e ‘tendencave kriminale’, një kriter që Gjykata Kushtetuese e kishte identifikuar të pamjaftueshme.

(b) *Përmbajtja e masave*

(i) *Përkufizimi i pasaktë i detyrimeve të caktuara* - Ashtu siç e lejonte gjykatën të vendoste 'çdo masë tjetër të konsideruar të nevojshme' duke patur parasysh kërkesat e mbrojtjes së shoqërisë, Ligji parashikonte vendosjen e detyrimeve të paqarta dhe pasakta, si 'bërja e një jete të ndershme dhe në pajtim me ligjin' dhe 'të mos bëhet shkak për dyshim'.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese nuk i kishte korrigjuar këto mangësi; duke iu referuar koncepteve po aq të papërcaktueshëm ose tek sistemi ligjor italian, Gjykata Kushtetuese nuk kishte bërë ndonjë qartësim të mëtejshëm në lidhje me normat specifike mosrespektimi i të cilave do të ishte një tregues i mëtejshëm për rrezikun e këtij personi për shoqërinë.

(ii) *Ndalimi i pranisë në takimet publike* - Masat e parashikuara nga ligji dhe të vendosura në ngarkim të kërkuesit përfshinin edhe një ndalim të pranisë në takime publike. Ky në fakt ka qenë një ndalim absolut. Ligji nuk specifikonte asnjë afat kohor apo hapësiror në lidhje me mundësinë e kufizimit të kësaj lirie themelore, duke ia lënë çështjen tërësisht diskrecionit të gjyqtarit pa treguar me qartësinë e duhur objektin e këtij diskrecioni dhe mënyrën e ushtrimit të tij.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri)

Neni 37, par 1: Qeveria kishte paraqitur një deklaratë të njëanshme duke njohur që kërkuesi kishte vuajtur një shkelje të Nenit 6, par 1, i Konventës, për shkak të mungesës së seancës publike dhe duke marrë përsipër ti paguante atij një shumë parash në lidhje me shpenzimet procedurale (por jo në lidhje me dëmin jo-financiar).

Megjithatë, ndryshe nga çështja e masave parandaluese në lidhje me pronën, nuk ka patur vendime të mëparshme për çështjen nëse Neni 6, par 1, ka qenë i zbatueshëm për gjykimet për zbatimin e masave parandaluese në lidhje me individët, si ato të vendosura në çështjen konkrete, dhe, nëse po, nëse seancat për këto çështje duhej të ishin publike.

**Përfundim:** Kërkesa për mosmarrje parasysh rrëzohet (njëzëri).

Neni 6, par 1

(a) *Zbatueshmëria* - Aspekti kriminal i Nenit 6, par 1, nuk ishte i zbatueshëm, meqenëse mbikëqyrja e posaçme nuk ishte e krahasueshme me një sanksion penal, duke ditur që gjykimi në lidhje me kërkuesin nuk përfshinte përcaktimin e një 'akuze penale'.

Megjithatë, ka patur një ndryshim në praktikën gjyqësore të Gjykatës drejt zbatimit të aspektit civil të Nenit 6 në çështjet në të cilat fillimisht duket se nuk prekin një të drejtë civile, por mund të kenë pasoja të drejtpërdrejta dhe të konsiderueshme për një të drejtë private që i takon një individ (shih *Alexandre kundër Portugalisë*, 33197/09, 20 nëntor 2012, [Shënim Informativ 157](#), dhe *Pocius kundër Lituanisë*, [35601/04](#), 6 korrik 2010).

Në çështjen konkrete, detyrimet sipas së cilave nuk lejohej largimi i rrethit të banesës, largimi nga banesa ndërmjet orës 10 të darkës dhe 6 të mëngjesit, prania në takimet publike dhe përdorimi i telefonave celularë dhe mjeteve të komunikimit në radio pa dyshim që përfshiheshin në sferën e të drejtave personale dhe kështu ishin e një natyre civile (shih, *mutatis mutandis*, *Enea kundër Italisë* (GC), 74912/01, 17 shtator 2009, [Shënim Informativ 122](#), dhe *Ganci kundër Italisë*, 41576/98, 30 tetor 2003, [Shënim Informativ 57](#)).

Kishte lindur një ‘mosmarrëveshje e vërtetë dhe serioze’ në lidhje me ato të drejta kur Gjykata e Rrethit e kishte vendosur kërkuesin nën mbikëqyrje të posaçme, duke rrëzuar argumentet e tij. Mosmarrëveshja pastaj ishte zgjidhur përfundimisht me vendim të Gjykatës së Apelit, që njohur që masa parandaluese e vendosur për kërkuesin ishte e ligjshme.

**Përfundim:** i pranueshëm (njëzëri).

(b) *Themeli (mungesa e seancës publike)* - Kërkuesi nuk kishte mundësi të kundërshtonte masat në një seancë publike. Gjykata përsëriti që detyrimi për të mbajtur një seancë publike nuk ishte absolute meqenëse rrethanat që justifikojnë mospasjen e seancës varej kryesisht nga natyra e çështjeve që do të përcaktoheshin nga gjykatat e brendshme.

Rrethanat e kësaj çështjeje kishin diktuar që një seancë publike mund të mbahej, duke patur parasysh që gjykatat e brendshme duhej të vlerësonin aspektet të tilla si karakteri, sjella dhe rrezikshmëria e kërkuesit, dhe të gjitha këto ishin vendimtare për vendosjen e masës parandaluese.

**Përfundim:** shkelje (njëzëri).

Gjykata gjithashtu ishte e mendimit, katërbëdhjetë vota me tre, që nuk ka patur shkelje të Nenit 6, par 1, në kuptimin e rregullsisë së gjykimit, posaçërisht në lidhje me vlerësimin e provave në shkallë të parë, dhe, me dymbëdhjetë

vota me pesë, që nuk ka patur shkelje të Nenit 13 në lidhje me Nenin 2 të Protokollit nr 4.

Neni 41: 5 000 EURO në lidhje me dëmin jo-financiar; rrëzohet pretendimi në lidhje me dëmin financiar

## II. AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

*Selami dhe të tjerë kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 78241/13, aktgjykimi i datës 1 mars të vitit 2018*

***Neni 3 (aspekti procedues) mungesa e hetimit efikas***

***Neni 5, paragrafi 5 (e drejta e kompensimit për shkak të privimit të pabazë nga liria)***

Trashëgimtari gëzon të drejtën e shumës më të lartë të kompensimit për shkak të torturës dhe privimit të pabazë nga liria e babait të tij

**Faktet** – Ankuesit e rastit janë bashkëshortja e të ndjerit z. Selami dhe tre fëmijët e z. Selamit.

Z. Selami ka qenë i privuar nga liria në muajin gusht të vitit 2002 nën dyshimet për pjesëmarrje në vrasjen e dy nëpunësve të policisë. Gjatë periudhës derisa ai ka qenë i privuar nga liria, ai ka qenë i ekspozuar ndaj dhunës serioze fizike dhe për këtë arsye ai ka qenë i hospitalizuar, me më shumë fraktura. Për shkak të lëndimeve të shkaktuara, mbi të është kryer intervenimi kirurgjik në tru dhe ai ka mbetur në gjendje kome në një periudhë kohore prej dy javëve.

Në mënyrë succesive, kundër tij janë ngritur akuza për pjesëmarrje në grupin terrorist, por në muajin shtator të vitit 2003, procedura penale ka qenë e ndërprerë. Pas dy muajve ai është drejtuar deri te Ministria e drejtësisë për qëllime të arritjes së marrëveshjes në lidhje me dëmin e shkaktuar nga lëndimet, të cilat atij i janë shkaktuar nga ana e policisë. Në mungesë të përgjigjes nga Ministria e drejtësisë, në muajin janar të vitit 2004, ai ka parashtruar padi për kompensim të dëmeve për shkak të privimit të pabazuar nga liria dhe për shkak të torturës fizike. Në muajin prill të vitit 2010, gjykata e shkallës së parë ka

sjell aktgjykimin e dëmshpërblimit të shumës ekuivalente prej 18.000 euro, si kompensim të dëmit të natyrës jo materiale për shkak të privimit të pabazë nga liria. Pjesa e tjetër e kërkesës ka qenë e refuzuar.

Z. Selami dhe familja e tij, kanë parashtruar ankesë me argumentet se Gjykata themelore nuk ka vendosur në lidhje me kërkesën e tyre për kompensim të dëmit për shkak të lëndimeve serioze të cilat i janë shkaktuar. Në muajin gusht të vitit 2012, Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesë e tyre, por duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Publike e ka zvogëluar kompensimin e miratuar më parë për dëmshpërblim në shumën ekuivalente prej 9.800 euro. Në këtë shumë është përfshirë edhe dëmi i shkaktuar nga sjellja jo humane.

Z. Selami ka ndërruar jetë në muajin prill të vitit 2011. Në muajin tetor të vitit 2012, z. Nexhmi Selami, një nga ankuesit dhe i biri i z. Selamit, ka qenë i shpallur si trashëgimtarë i vetëm i z. Selamit, dhe ai ka parashtruar kërkesën për revizion deri te Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, në emër të tij dhe në llogari të babait të tij të ndjerë.

Kërkesa ka qenë e refuzuar në muajin korrik të vitit 2013

**E drejta** - GJEDNJ e ka kategorizuar trajtimin sipas të cilit ka qenë i ekspozuar z. Selami për qëllimet dhe në pajtim me kushtet e Konventës. Nga faktet e rastit, GJEDNJ ka sajuar konkludimin se zotëri Selami ka qenë i torturuar nga ana e policisë derisa sa ai ka qenë i privuar nga liria dhe derisa atë e kanë marrë në pyetje dhe gjykata konstaton se ai ka qenë viktimë e torturës, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. GJEDNJ në mënyrë plotësuese konstatoi se privimi nga liria e z. Selamit gjatë muajit gusht të vitit 2002 ka qenë i pabazë dhe në kundërshtim me nenin 5 të Konventës.

Gjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të lëndës, GJEDNJ ka vendosur në lidhje me legjitimitimin aktiv të anëtarëve të familjes së z. Selamit. GJEDNJ sajon konkludimin se familja nuk ka qenë në gjendje që të ankohet si “viktimë e drejtpërdrejtë” në lidhje me shkeljet e nenit 3: z. Selami është zhdukur në periudhën prej 2 muajve dhe se familja nuk ka qenë dëshmitarë i torturës së ushtruar mbi të. Në mënyrë plotësuese, GJEDNJ nuk konstatoi lidhjen shkak – pasojë në mes trajtimit ndaj të cilit z. Selami ka qenë i ekspozuar gjatë vitit 2002 dhe vdekjes së tij në vitin 2011. Prapëseprapë, GJEDNJ sajon konkludimin se djali i z. Selamit i cili ka qenë i shpallur si trashëgimtarë i vetëm i tij, gëzon vetinë e “viktimit indirekte”. Ai përskaj faktit se ka qenë trashëgimtarë i vetëm

i të ndjerit z. Selami, ai ka vazhduar procedurën vendore për kompensim të dëmit pas vdekjes së babait të tij dhe ka trashëguar kompensimin e dëmit të përcaktuar me aktgjykim. Për këto arsye, GJEDNJ sajon konkludimin se ai ka demonstruar “interesin e fuqishëm moral” për përcaktimin e përgjegjësisë së shtetit për shkeljet e lartpërmendura, lënë anash interesin material lidhur me trashëgimin e kompensimit të dëmit të përcaktuar me aktgjykim.

GJEDNJ, e refuzoi konstatimin e Qeverisë, se z. Selami është dashur të inicioj procedurën penale të cilën më vonë pas vdekjes së tij kanë mundur që ta vazhdojnë anëtarët e familjes së tij. Shteti nuk mund të konsiderohet i liru nga “obligimi procedural” i tij përmes bartjes së përgjegjësisë për hetimin penal të palës së dëmtuar, në veçanti në rastet kur vetë institucionet e shtetit kanë qenë të njoftuar dhe të vetëdijshëm për argumentet që kanë merituar hetime përkatëse. GJEDNJ në rastin konkret nuk gjeti dëshmi të cilat do të udhëzonin në konkludimin se procedura penale, në masë të konsiderueshme do të ndikonte mbi shumën e përcaktuar me aktgjykim si kompensim të dëmit të shkaktuar.

Si çështje tjetër të cilën e shqyrtoi GJEDNJ ishte çështja se vallë institucionet kombëtare, gjatë veprimit në lidhje me kërkesat paditëse të anëtarëve të familjes, i kanë pranuar shkeljet e Konventës dhe me aktgjykim kanë përcaktuar kompensime përkatëse të dëmit. GJEDNJ konstatoi se kompensimi i dëmit i përcaktuar me aktgjykim ka qenë i përcaktuar për shkak të privimit të pabazë nga liria dhe se shumta e përcaktuar e dëmshpërblimit është dashur që ta kompensoj edhe dëmin e shkaktuar përmes torturës serioze fizike që ka rezultuar me lëndime trupore. Prapëseprapë, GJEDNJ sajoi konkludimin se vendimet gjyqësore vendore edhe pse kanë përfshirë pranimin, ai nuk ka qenë në lidhje me privimin e pabazë nga liria gjatë muajit gusht të vitit 2002 dhe se ai nuk ka përfshirë përshkrimin, në mënyrë eksplicite ose në esencë, të torturës fizike ndaj së cilave ka qenë i ekspozuar z. Selami, si “torturë”.

Në mënyrë plotësuese, shumta e kompensimit të dëmit, në mënyrë plotësuese ka qenë e zvogëluar me vendimin e Gjykatës së Apelit.

Në bazë të analizave krahasuese të shumës për kompensim të dëmit të përcaktuar me aktgjykim nga ana e institucioneve vendore, nga njëra anë dhe shumtat e kompensimit të dëmit të cilat i përcakton GJEDNJ në lidhje me rastet e ngjashme, u sajua konkludimi se shumta e përcaktuar e dëmshpërblimit në



nivel kombëtarë nuk mund të konsiderohet si përkatëse dhe se shuma prej 9.800,00 euro është shumë jo racionale dhe e ulët.

Për këto arsye, GJEDNJ sajoi konkludimin se në këtë rast ekziston shkelja e të drejtave të Nexhmi Selamit, të birit të z. Selamit dhe trashëgimtarë i vetëm i tij, shkelje që janë në lidhje me nenin 3 dhe nenin 5 paragrafi 5 të Konventës. Në të njëjtën kohë, GJEDNJ vendosi që z. Nexhmi Selami ti përcaktoj me aktgjykim dallimin në mes shumës së kompensimit të dëmit të përcaktuar me aktgjykim nga ana e institucioneve vendore dhe shumës e cila zakonisht do të përcaktohej me aktgjykimin e GJEDNJ, në raste të tilla që janë me seriozitet të veçantë.

Prej këtu, GJEDNJ në lidhje me këtë rast solli aktgjykimin për shumën prej 20.000 euro si kompensim të dëmit të natyrës jo materiale.

GJEDNJ, konstaton mungesën e hetimit efikas “*proprio motu*” në lidhje me argumentet e z. Selamit se ai ka qenë i ekspozuar ndaj torturës nga ana e policisë. Gjykata mori qëndrimin se shteti nuk mund të lirohet nga obligimi i tij procedural lidhur me nenin 3, duke ia bartur barrën personit të dëmtuar në lidhje me parashtrimin kallëzimit penal. Z. Selami është drejtuar deri te Ministria për drejtësi në lidhje me qëllimet e arritjes së marrëveshjes si në pjesën e dëmit të pësuar për shkak privimit të pabazë nga liria, ashtu edhe për shkak të lëndimeve të cilat atij i janë shkaktuar nga ana e policisë dhe gjatë kësaj ai ka parashtruar dokumentacionet përkatëse mjekësore, kurse Ministria e drejtësisë edhe përskaj obligimit ligjorë nuk e ka njoftuar prokurorinë kompetente për veprën e lartpërmendur penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. Përskaj kësaj, GJEDNJ konstatoi edhe mungesën e çfarëdo lloji të orvatjeve për hetime edhe pasi që gjykatat civile gjatë procedurës për kompensim të dëmit, kanë konstatuar se “z. Selami ka qenë i ekspozuar ndaj torturave serioze fizike” nga ana e policisë. Për këto arsye, në rastin konkret u konstatuan shkelje për nga aspekti procedues në lidhje me nenin 3 të Konventës.

### **Konkluzion:**

Neni 3 (aspekti procedues) mungesa e hetimit efikas – ekzistojnë shkelje, njëzëri

Neni 5 paragrafi 5 (e drejta e kompensimit për shkak të privimit të pa bazë nga liria) – ekzistojnë shkelje, njëzëri

**Asani kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 27962/10**, aktgjykimi i datës 1 shkurt të vitit 2018

Neni 6, paragrafi 1 dhe 3 (g) (e drejta e gjykimit të drejtë dhe e drejta e marrjes në pyetje të dëshmitarëve)

**Faktet:** Ankuesit Ramiz Asani dhe Naim Asani, para GJEDNJ kanë theksuar argumentet se nuk kanë qenë në mundësi që ti marrin në pyetje dëshmitarët kryesorë në lidhje me gjykimin e tyre për veprën penale – vrasje gjatë vitit 2018.

Ata kanë qenë të privuar nga liria gjatë vitit 2007, në lidhje me incidentin që kanë ndodhur gjatë vitit 2006 para internet – kafesë, ku gjatë shkrepjes nga arma e zjarrit kanë humbur jetën tre fëmijë të moshës së mitur, kurse gjashtë persona të tjerë kanë qenë rëndë të lënduar.

Gjatë procedurës vendore kundër ankuesve, gjatë së cilët ata janë shpallur si fajtor dhe iu janë përcaktuar dënimet me burgim të përjetshëm, nga ana e dy dëshmitarëve të mbrojtur me identitet të fshehur, të cilët kanë fituar statusin e tillë për shkak të frikës për sigurinë e tyre, ankuesit janë identifikuar si shkaktarë të veprës, por gjatë kësaj mbrojtjes i është lejuar që dëshmitarëve të mbrojtur gjatë gjykimit para gjykatave vendore vetëm të mund tu parashtrojnë pyetje me shkrim. Gjykata gjyqësore, gjithashtu ka lejuar që si dëshmi të pranohet leximi i deklaratës së dhënë gjatë hetimit nga ana e dëshmitarit tjetër, i cili nuk është paraqitur gjatë gjykimit edhe pse ai ka qenë i ftuar.

**E drejta:** Në këtë rast, GJEDNJ e zbatoi testin e trefishtë të zhvilluar nga praktika gjyqësore dhe në veçanti u fokusua në këto tre çështje vijuese, si gjatë vlerësimit të argumenteve për shkëljen e të drejtave të palës mbrojtëse për shkak të mos marrjes në pyetje të dëshmitarëve anonim, ashtu edhe për nga aspekti i ofrimit si dëshmi të deklaratës së dhënë gjatë hetimeve nga ana e dëshmitarit B.H.

*I. Provat për shkëljen e të drejtave të mbrojtjes për shkak të mos marrjes në pyetje të dëshmitarëve anonim*

*1. Vallë kanë ekzistuar shkaqe të qëndrueshme për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve*

Për nga aspekti i dëshmitarëve me identitet të fshehur, GJEDNJ morri qëndrimin se të njëjtit kanë qenë anonim në kuptim të praktikës gjyqësore të GJEDNJ, duke pasur parasysh faktin se të dhënat e tyre personale nuk kanë qenë në qasje për të akuzuari dhe për mbrojtjen e tyre dhe se të njëjtit gjatë procedurës gjyqësore shfaqen me pseudonimet “Korabi” dhe “Vodno”. GJEDNJ sajoi konkludimin se shfrytëzimi i dëshmimeve të dhëna nga dëshmitarët anonim në rastin konkret, në mënyrë racionale mund të konsiderohet si e arsyeshme, por gjatë kësaj duke i marrë parasysh argumentet e Qeverisë të dhëna gjatë mbrojtjes dhe faktin se të njëjtit kanë mbetur të pa kontestuar nga ana e ankuesve. Prapëseprapë, GJEDNJ përkujton se edhe pse dëshmitarët kanë kërkuar që të mbeten anonim për shkak të frikës nga hakmarrja, ndjenja e tyre subjektive nuk mjafton vetvetiu, për faktin se gjykatat vendore janë të obliguara që të konstatojnë dhe të vlerësojnë se vallë në rastin konkret ekzistojnë shkaqe objektive për frikë dhe se vallë ekzistojnë dëshmi për këto shkaqe, gjë që në rastin konkret nuk është realizuar.

## *2. Vallë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët anonim kanë paraqitur bazën e vetme dhe kryesore për gjykimin e ankuesve*

GJEDNJ sajoi konkludimin se deklaratat e dhëna nga dëshmitarët me identitet të fshehur, nuk kanë qenë dëshmi të vetme gjatë procedurës. Prapëseprapë, duke pasur parasysh faktin se “Korabi” dhe “Vodno” kanë qenë dëshmitarët e vetëm okular të cilët i kanë identifikuar ankuesit si shkaktarë të veprës penale dhe se gjykata gjyqësore në bazë të deklaratave të dhëna nga këta dëshmitarë ka konstatuar “praninë e ankuesve në vendin e ngjarjes, zhvillimin dhe dinamikën e ngjarjeve”, GJEDNJ konkludoi se deklaratat e dhëna nga dëshmitarët me identitet të fshehur, kanë qenë me rëndësi të madhe dhe se pa të njëjtit, gjasat për gjykimin e ankuesve do të ishin të zvogëluara në masë të konsiderueshme, përkatësisht dëshmitë anonime të dhëna nga “Korabi” dhe “Vodno” duhet të konsiderohen si dëshmi vendimtare në rastin konkret.

## *3. Vallë kanë ekzistuar faktorë për kundër balancim ose për vendosjen e baraspeshës*

Faktorët e baraspeshës, duhet të mundësojnë vlerësimin e drejtë dhe të rregullt të besueshmërisë së argumenteve të dhëna nga dëshmitarët anonim. GJEDNJ konkludoi se mundësia e cila iu është ofruar ankuesve që tu parashtrojnë pyetje me shkrim dëshmitarëve me identitet të fshehur, nuk mund të konsiderohet si masë e mjaftueshme mbrojtëse procedurale për arritjen e baraspeshës së

nevojshme për shkak të kufizimeve me të cilat janë ballafaquar të akuzuarit (më vonë të gjykuarit) gjatë realizimit të drejtës së tyre të mbrojtjes, në veçanti nëse merren parasysh kushtet e posaçme në të cilat janë marrë në pyetje dëshmitarët, që ka përfshirë në vete jo vetëm mbrojtjen e tërësishme të anonimitetit të tyre, por edhe përjashtimin e mbrojtjes nga marrja në pyetje e tyre, që përshin edhe pamundësinë që të kenë qasje deri te materialet e fituara nga pajisjet teknike për bartjen e fotografisë dhe zërit.

## *II. Pranimi i deklaratës së dhënë nga dëshmitari B.H. të dhënë gjatë hetimit*

### *1. Vallë kanë ekzistuar shkaqe të mirëfillta për mungesën e tij*

GJEDNJ konstatoi se në rastin konkret, gjykatat vendore nuk kanë ofruar arsye solide për mungesën e B.H. gjatë gjykimit. Për konkludimet e tilla, GJEDNJ i ka marrë parasysh këto rrethana vijuese: dëshmitari ka qenë dëshmitarë okularë i ngjarjes penale – juridike, dhe se ai është marrë në pyetje në prani të gjykatësit hetues dhe prokurorit publik, në propozim të prokurorit publik në fazë të hershme të procedurës; se ankuesit gjatë gjykimit kanë kërkuar marrjen në pyetje të tij; se gjykata pa suksese ka bërë orvatje që ta sigurojë dëshmitarin; por se ka shprehur besimin ndaj njoftimit nga ana e MPB se dëshmitari nuk është në qasje për organet e përndjekjes për shkak të arratisë dhe se ai kërkohet me fletë arrest ndërkombëtarë, gjatë sjelljes së vendimit të pranohet si dëshmi deklarata e tij e cila është dhënë gjatë hetimit dhe e cila është lexuar gjatë gjykimit. Gjatë vlerësimeve se vallë në rastin konkret janë marrë të gjitha masat racionale dhe pozitive nga ana e gjykatave vendore për sigurimin e dëshmitarit, GJEDNJ në veçanti e ka marrë parasysh faktin se gjykata vendore ka sjell vendimin që të lexohet deklarata e dhënë nga ana e B.H. tre muaj pas njoftimit të pranuar nga MPB, pa kurrfarë tentativa tjera në ndërkohë për sigurimin e pranisë së tij dhe pa përpjekje që të kontrollohen pohimet e ankuesve të dhëna gjatë fjalimit përfundimtarë në lidhje me atë se dëshmitari B.H. gjendet brenda shtetit dhe se është në duar të policisë, gjoja për shkak të inkriminimit të tij në një vepër tjetër penale, qasje të cilën e kanë respektuar edhe instancat tjera më të larta gjyqësore të shtetit, të cilët kanë vendosur në lidhje me këtë lëndë.

### *2. Vallë dëshmitë kanë qenë të vetme ose vendimtare*

GJEDNJ konstatoi se në deklaratën e tij të dhënë para gjykatësit hetues dhe para gjykimit, deklaratë kjo e pranuar në debatin kryesorë gjykues si dëshmi

e dhënë, B.H. nuk i ka identifikuar ankuesit si shkaktarë të veprës, por se gjykata gjyqësore është mbështetur në deklaratën e dhënë nga ana e B.H. që ta konstatojë motivin e veprës penale. Prej këtui, GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendore kanë konstatuar një element të rëndësishëm për nga aspekti i përgjegjësisë penale të ankuesve në bazë të dëshmisë së shqyrtuar. Edhe përkaj faktit se kjo nuk ka qenë dëshmi e vetme në këtë drejtim dhe nuk ka pasur rëndësi të drejtpërdrejtë, për GJEDNJ si vendimtare ka qenë fakti se kjo dëshmi ka pasur rëndësi të konsiderueshme gjatë përcaktimit të fajësisë së të akuzuarve, kurse pranimi i deklaratës së tillë si dëshmi, ka mundur të paraqes handicap për mbrojtjen.

### *3. Vallë ka pasur faktorë të mjaftueshëm të baraspeshës*

Gjatë vlerësimit të këtij aspekti nga testimi i përcaktuar, GJEDNJ në rastin konkret i ka analizuar kriteret e përcaktuara gjatë praktikës së saj gjyqësore: qasja e gjykatës gjyqësore deri te dëshmitë e paverifikuara, disponimi dhe fuqia dëshmuese e dëshmimeve tjera inkriminuese dhe masat e ndërmarra procedurale që të kompensohet mungesa e mundësisë që dëshmitarët të merren në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë gjyqimit.

GJEDNJ konstatoi se në aktgjyqimet e gjykatave vendore, nuk ekziston asgjë prej ku mund të sajohen konkludime se të njëjtit ndaj deklaratës së dhënë nga B.H. janë sjellë me vëmendje të posaçme, e as që mund të vërehet fakti se për shkak se kemi të bëjmë me dëshmitarë që mungon, se kjo gjë i ka nxitur gjykatat vendore që ti japin rëndësi më të vogël deklaratës së dhënë nga ana e tij.

Më pas, GJEDNJ ka konstatuar se pavarësisht nga fakti se dëshmia e dhënë nga B.H. ka shërbyer si dëshmi indirekte (duke pasur parasysh faktin se kjo dëshmi nuk ka mundur që ta inkriminojë në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjërin prej ankuesve), prapëseprapë duke pasur parasysh handicapin e mbrojtjes në lidhje me të njëjtin, pesha e saj dëshmuese nuk mund të konsiderohet si faktor i mjaftueshëm i baraspeshës.

Përfundimisht, GJEDNJ konstatoi se ankuesit kanë pasur mundësinë që të ofrojnë versionin e tyre në lidhje me ngjarjet dhe ta kontestojnë kredibilitetin e B.H. si dëshmitarë, identiteti i të cilit ka qenë i njohur për të njëjtit. Prapëseprapë, mbrojtja nuk ka pasur mundësinë që ta merr në pyetje B.H., gjithashtu edhe gjykata gjyqësore nuk ka pasur mundësinë që ta vrojtojë sjelljen

e tij me qëllim që të bën vlerësimet e veta për besueshmërinë e rolit që atij ia ka përcaktuar. Nga mungesa e parashtrësës së qartë nga ankuesit në lidhje me deklaratën e dhënë nga B.H. e cila është lexuar gjatë debatit gjyqësorë, GJEDNJ sajton konkludimin se e njëjta nuk mund të interpretohet si anulim i padyshimtë i së drejtës që të merret në pyetje ky dëshmitarë.

**Konkludim:** Kufizimet e së drejtës së mbrojtjes së ankuesve, në lidhje me dëshmitarët që janë me identitet të fshehur dhe të dëshmitarit B.H. kanë qenë në kundërshtim me garancitë e gjykimit të drejtë dhe kanë rezultuar me shkeljen e nenit 6, paragrafi 1 dhe 3 (g) të Konventës – njëzëri.

Gjykata e refuzoi kërkesën e ankuesve për kompensim të drejtë juridik të dëmit për shkak të mungesës së lidhjes shkak – pasojë në mes shkaqeve për të cilat kërkohej kompensimi dhe shkeljeve të konstatuara të KEDNJ.

***Ramkovski kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 33566/11***, aktgjykim i datës 8 shkurt të vitit 2018

**Faktet:** Ankuesve z. Velija Ramkovski (“ankuesi i parë”) dhe zonjës Emel Ramkovska (“ankuesi i dytë”) iu është përcaktuar paraburgimi për shkak të dyshimeve se qëllimisht për përfitime të leverdisë pronësore në kundërshtim me ligjin kanë shkaktuar veprën penale shoqërim terrorist dhe veprën penale fshehje e tatimeve, kurse për ankuesin e parë edhe veprën penale keqpërdorim të pozitës zyrtare. Gjatë hetimit dhe procedurës së mëtutjeshme penale, paraburgimi i ankuesve ka qenë i prolonguar në vazhdimësi, dhe pa suksese kanë mbetur kërkesat e ankuesve për zëvendësim të paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak.

## **E Drejta:**

### **Neni 5 paragrafi 3**

GJEDNJ gjatë shqyrtimit të provave, konstatoi shkeljen e nenit 5 paragrafi 3 të KEDNJ, për shkakun se gjykatat vendore nuk kanë ofruar arsyetime të përcjella

me arsyetime relevante dhe të mjaftueshme për paraburgimin e prolonguar në vazhdimësi.

Në aktgjykimin e tij, GJEDNJ potencon se kërkesa për arsyet e mjaftueshme dhe relevante për përcaktimin e masës së paraburgimit, përskaj ekzistimit të dyshimeve racionale - vlen qysh gjatë sjelljes së aktvendimit iniciues, përkatësisht gjatë sjelljes së aktgjykimit të parë me të cilin përcaktohet masa e paraburgimit.

Përskaj mungesës së shkaqeve relevante dhe të mjaftueshme për vazhdimin e masës së paraburgimit në rastin konkret, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtje në lidhje me aktgjykimet për paraburgimet kolektive dhe për lëshimet e gjykatave vendore që ti shqyrtojnë moduset alternative për sigurimin e prezencës gjatë gjykimin, shfrytëzimin e formulimeve identike në aktgjykimet për vazhdimin e paraburgimit dhe lëshimet që të vlerësohet se vallë shkaqet dhe bazat për përcaktimin e masës së paraburgimit kanë vazhduar së ekzistuari edhe gjatë periudhës kur kjo masë ka qenë e vazhduar.

Gjykata thekson se vlerësimi i racionalitetit të kohëzgjatjes së paraburgimit nuk mund të realizohet në mënyrë abstrakte, por se paraburgimi i vazhdueshëm mund të arsyetohet vetëm në raste të ekzistimit të indikacioneve specifike për ekzistimin e interesit të posaçëm publik, i cili anon në raport të rregullit për respektim të lirisë individuale.

Ashtu që, për nga aspekti i mundësisë për arrati, GJEDNJ në aktgjykimin e saj thekson se duhet të merret parasysh karakteri i individit të përfshirë, aspektet e tija morale, lidhjet me shtetin në të cilin zhvillohet procedura dhe kontaktet e tij me shtetet e huaja. Për nga aspekti i mundësisë për arrati, përskaj faktit se mundësia e tillë duhet të përcaktohet me një dozë të mjaftueshme të bindjes, mes tjerave mundësia e tillë duhet të jetë edhe reale, kurse masa të jetë përkatëse duke pasur parasysh historinë dhe karakterin e individit të përfshirë. Në lidhje me provat që kanë të bëjnë me ankuesin e dytë, të shpalosura për herë të parë në mbrojtjen e shtetit para GJEDNJ, GJEDNJ mori qëndrimin se të njëjtit janë irelevante për vlerësimin e provave të dhëna nga ankuesit për shkeljen e KEDNJ për shkakun se gjykatat vendore nuk i kanë theksuar lidhjet e fuqishme të ankuesit me Turqinë si shkak i cili e arsyeton paraburgimin e saj në bazë të rrezikut nga arratia. GJEDNJ për nga aspekti i faktit se i biri i ankuesit të parë dhe vëllai i ankuesit të dytë, ka qenë i arratisur dhe qëndrimi i gjykatave vendore se kjo dhe arratia e disa bashkë të akuzuarve të tjerë e zmadhon

rrezikun e arratisjes, morri qëndrimin se sjellja e personave të cilët kanë qenë bashkë të akuzuar nuk mund të paraqet faktorin vendimtarë gjatë vlerësimit të mundësisë për arratisjen e ndonjë personi tjetër, por se vlerësimet e tilla duhet të bazohen në rrethanat personale të individit të përfshirë.

GJEDNJ, gjithashtu konstaton se në kontekst të rrezikut nga arratia, përkaj referimit në mënyrë abstrakte të “pronës dhe lidhjeve familjare”, gjykatat vendore nuk kanë potencuar asnjë aspekt specifik të karakterit të ankuesve, sjelljes së tyre ose të rrethanave të cilat do ta arsyetonin konkluzionin e tyre për ekzistimin e rrezikut të vazhdueshëm të arratisjes; se nuk i kanë adresuar provat e ankuesve për mungesën e rrezikut nga arratia, për shkak të lidhjeve të fuqishme familjare të tyre, fakti se të njëjtit nuk i janë kundërshtuar privimit nga liria dhe se ata nuk kanë tentuar që të arratisen; mungesa e çfarëdolloj arsytimi përse në rastin konkret, nuk janë siguruar masa alternative dhe më pak invazive që të sigurohet prezenca e të akuzuarve.

Në kontekst të provave të theksuara në aktgjykimet se bëhet fjalë për një vepër të organizuar, GJEDNJ vëren se një gjë e tillë vetvetiu duke mos i theksuar karakteristikat personale dhe sjelljet, nuk mund të paraqesë arsyetim për paraburgimin e gjatë dhe në kuptimin se gjykatat vendore nuk e kanë marrë parasysh faktin se ankuesit më parë nuk kanë pasur dosje penale.

Gjatë kësaj GJEDNJ edhe pse pranon se pozitat udhëheqëse të cilat ankuesit i kanë pasur në personat juridik të involvuar në ngjarjen penale – juridike, paraqesin faktorë relevantë gjatë vlerësimit të mundësisë për përsëritjen e veprës, prapëseprapë konstaton se edhe nën supozimet se rreziku i tillë ka ekzistuar në mënyrë initiale, pas një periudhe të caktuar kohore, thirrja në këtë argument ka kërkuar sqarime plotësuese, gjë të cilën gjykatat vendore e kanë anashkaluar që ta theksojnë dhe në këtë mënyrë të dëshmojnë dhe të përcaktojnë me siguri të mjaftueshme ekzistimin e mundësisë për përsëritjen e veprës.

#### **Neni 5 paragrafi 4**

Në këtë rast GJEDNJ konstaton mungesën e shkeljes së nenit 5 § 4 të KEDNJ. Përkatesisht ankuesit u ankuan se Gjykata e Apelit nuk ka vendosur me shpejtësi të mjaftueshme në lidhje me ankesat e tyre, të parashtruara kundër aktgjykimit për vazhdim të paraburgimit. GJEDNJ pasi që konstatoi se në rastin konkret për të cilin janë ankuar ankuesit, Gjykata e Apelit ka vendosur në lidhje



me ankesën 11 ditë pas miratimit të tij, kurse vendimi njërit prej akuzuarve i është dorëzuar në ditën e 14 – të pas dorëzimit të ankesës, kur mbrojtësi i tyre në të njëjtën kohë ka realizuar shqyrtimin në lëndën përkatëse, GJEDNJ konstatoi se afatet e tilla nuk janë në kundërshtim me kërkesën për vendosje “të shpejtë” e që janë në lidhje me nenin

5 § 4 të KEDNJ.

## **Neni 6 paragrafi 2**

GJEDNJ konstatoi se në rastin e shqyrtuar nuk ekzistojnë shkelje të asnjërës prej dispozitave të përfshira në nenin 6 paragrafi 2 të KEDNJ. Përkatësisht, ankuesit kanë theksuar se gjykatat vendore kanë shkelur të drejtën e tyre për pandehje të pafajësisë me faktin se në vendimin e datës 22 mars të vitit 2011 për vazhdimin e paraburgimit të ankuesve, këshilli i përbërë nga tre anëtarët, mes tjerave, ka theksuar se “të akuzuarit i kanë kryer veprat penale si një grup mirë i organizuar dhe kompakt”; “duke pasur parasysh shkallën e rrezikut për shoqërinë dhe përgjegjësinë penale” dhe se “disa prej veprave penale janë realizuar si vepra të vazhdueshme penale”. Duke bërë dallimin në mes deklaratave që reflektojnë mendimin se personi i përfshirë është fajtor (që lëndojnë të drejtën për pandehje të pafajësisë) dhe deklaratat të cilat thjeshtë e përshkruajnë “gjendjen e dyshimit” (të cilat konsiderohen si të pranueshme për praktikën gjyqësore të GJEDNJ); dhe duke i analizuar deklaratat kontestuese që janë në kontekst, GJEDNJ konstaton se deklaratat e kontestuara që janë shfrytëzuar me qëllim që të arsyetohet vazhdimi i masës së paraburgimit të ankuesve në bazë të rrezikut nga arratia dhe të rrezikut të përsëritjes së veprës, gjatë kësaj gjykatat vendore janë thirrur në dyshimin e bazuar se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat kanë qenë të akuzuar dhe se rrethanat e kontestuara kanë qenë të trajtuara jo si fakte të përcaktuara, por vetëm si prova. GJEDNJ nuk sajoi konkludimin se deklaratat e kontestuara kanë përfshirë në vete deklarata eksplicite dhe jo përkatëse me të cilat do të konstatohej fajësia e ankuesve, para se të njëjtit të shpallen si fajtorë në procedurën përkatëse. Përkundrazi, GJEDNJ konstatoi se në kontekstin e lartpërmendur ekzistojnë deklarata të cilat në mënyrë të qartë tregojnë se ankuesit kanë qenë të dyshuar dhe se gjykatat vendore nuk e kanë shqyrtuar çështjen se vallë fajësia e ankuesve mund të konfirmohet nga dëshmitë, por se vallë ka ekzistuar baza juridike për vazhdimin e masës së paraburgimit.

**Konkluzion:** Neni 5 paragrafi 3 – ekzistojnë shkelje, njëzëri

Neni 5 paragrafi 4 – nuk ekzistojnë shkelje - njëzëri

Neni 6 paragrafi 2 – nuk ekzistojnë shkelje - njëzëri

Neni 41: me nga 780 euro për dëmshpërblim të natyrës jo materiale për secilin prej ankuesve.

**Taseva Petrovska kundër Republikës së Maqedonisë**, A. nr. 73759/14, aktgjykimi i datës 11 janar të vitit 2018

### **Neni 6 paragrafi 1 (e drejta e gjykimit të drejtë)**

**Faktet:** Ankuesja është profesor i drejtësisë në universitetin privat në Shkup. Ajo posedon diplomë të doktorantit nga fusha e së drejtës penale.

Më 14 janar të vitit 2010, ankuesja ka parashtruar kërkesë deri te Ministria e drejtësisë (“Ministria”) për barazimin me të drejtat e personave që kanë dhënë provimin e jurisprudencës. Kërkesa e ankueses është refuzuar me arsyetimin se ajo nuk është jurist i diplomuar meqenëse ajo ka diplomuar në Fakultetin për siguri dhe vetë mbrojtje shoqërore.

Pas refuzimit të kërkesës së saj nga ana e Ministrisë për drejtësi, dhe pas padisë së parashtruar nga ana e ankueses, Gjykata administrative ka refuzuar padinë e ankueses me arsyetimin se ajo nuk ka poseduar diplomën në fushën e shkencave juridike, përkatësisht ajo nuk i ka përmbushur kushtet që të fitoj mirënjohjen e kërkuar.

Ankuesja ka parashtruar ankesën deri te Gjykata e Lartë administrative. Në përgjigjen e ankesës, Ministria ka theksuar se barazimi i të drejtave të personave që kanë dhënë provimin e jurisprudencës varet nga posedimi i diplomës për përfundimin e fakultetit juridik, kurse ankuesja nuk ka poseduar një diplomë të tillë. Përgjigjja e Ministrisë nuk i është dorëzuar ankueses. Më datën 30 janar të vitit 2014, Gjykata e Lartë administrative, ka refuzuar ankesën e ankueses dhe ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë.

**Edrejta:** Duke u thirrur në parimet e përgjithshme në lidhje me parimin e barazisë së argumenteve juridike të përmbledhura në aktgjykimin *Grozdanovski kundër*

*RM-së* (A. nr. 21510/03, § 36, 31 maj viti 2007), si dhe qëndrimin e Gjykatës në lidhje me rrethanat e ngjashme sikur rasti i lartpërmendur *Grozdanovski kundër RM-së*, por edhe në aktgjykimin *Naumovski kundër RM-së* A. nr. 25248/05 §§ 26-29, 27 nëntor viti 2012), Gjykata në rastin e shqyrtuar konstatoi ekzistimin e shkeljes së gjykimit të drejtë në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës.

**Konkluzion:** ekzistojnë shkelje – njëzëri.

***Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Ortodokse – Greke e Ohrit e Patrikanës së Pejës)*** kundër Republikës së Maqedonisë, A. nr. 3532/07, aktgjykimi i datës 16 nëntor të vitit 2017

Neni 11 (liria e tubimit dhe e shoqërimit) në lidhje me nenin 9 të KEDNJ (liria e përkatësisë fetare)

Refuzimi i institucioneve vendore që ta regjistrojnë shoqatën - ankuese

**Faktet:** Shoqata – ankuese ka bërë dy përpjekje të pasuksesshme për regjistrimin e saj, përpjekja e parë sipas dispozitave të Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze e vitit 1997 dhe përpjekja e dytë sipas dispozitave të Ligjit aktual për statusin juridik të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze. Aktgjykimi i GJEDNJ ka të bëjë me dy përpjekjet për regjistrim të shoqatës ankuese.

**E drejta:** Gjatë analizës së dy përpjekjeve për regjistrim të ankuesit si subjekt religjiozë në suaza të shtetit, GJEDNJ pa mëdyshje ka konstatuar se refuzimi i regjistrimit të tij paraqet pengimin e së drejtës për lirinë e shoqërimit në lidhje me lirinë e përkatësisë fetare të ankuesit. Gjatë kësaj, GJEDNJ konstaton se refuzimi i tillë ka qenë “i përcaktuar me ligj” dhe se ka pasur “qëllim legjitim”, përkatësisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave tjerë. Prapëseparë, GJEDNJ sajton konkludimin se mospranimi i ankuesit në veti të entitetit religjioz, përkatësisht refuzimi që ai të regjistrohet si i tillë nuk ka qenë masë “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

Gjatë konstatimeve të tilla, GJEDNJ i ka vlerësuar arsyet e institucioneve vendore të dhëna në suaza të vendimeve me të cilat është refuzuar kërkesa e regjistrimit të ankuesit si bashkësi fetare. Gjatë kësaj, arsyet i ka sistematizuar dhe i ka shqyrtuar në disa grupe të radhitura në vijim:

**(a) *Mungesa formale:*** Institucionet vendore e kanë refuzuar regjistrimin duke theksuar më shumë mungesa të natyrës formale. Të njëjtit kanë përfshirë edhe provat se fletëparaqitja për regjistrim ka qenë e parashtruar nga personi i pa autorizuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor; më pas se dispozitat që janë në lidhje me pronësinë e dokumenteve themeluese të ankuesve kanë qenë në kundërshtim me legjislativin relevantë; se shoqata nuk ka përcaktuar se vallë do të funksionojë si kishë, bashkësi ose grup dhe se nuk janë ofruar përshkrime për atë se vallë bëhet fjalë për shoqatë vullnetare ose shoqatë të personave fizik. Gjatë kësaj, GJEDNJ sajoi konkludimin se vendimet e gjykatave kombëtare janë fokusuar në aspektet e pastra formale, dhe jo në esencën e kërkesës për regjistrim dhe nuk kanë ofruar udhëzime të mjaftueshme për nga aspekti i asaj që ka qenë e nevojshme për regjistrimin e ankuesit. Gjatë kësaj GJEDNJ konstatoi se arsyetimet e dhëna në lidhje me mungesat formale për regjistrim, nuk kanë qenë “relevante dhe të mjaftueshme”.

**(b) „Prejardhja nga shtetet e huaja“ e shoqatës së ankuesve:** GJEDNJ nuk ka qenë e kënaqur nga dëshmitë e ofruara në përkrahjen e argumenteve të Qeverisë se shoqata e ankuesit ka qenë e themeluar nga ana e kishës ose shtetit të huaj. Gjatë kësaj, fakti dhe dëshmitë se lideri i ankuesit ka qenë i emëruar nga Kisha Ortodokse e Serbisë, GJEDNJ e ka konsideruar si të pamjaftueshëm në këtë kuptim, duke pasur parasysh faktin se themeluesit kanë qenë nënshtetas të RM-së. Gjatë kësaj, GJEDNJ e morri parasysh faktin se legjislativi relevant nuk pengon regjistrimin e organizatës religjioze të themeluar nga kisha ose shteti i huaj.

**(c) *Emërtimi i shoqatës së ankuesve:*** Ankuesi në fillim ka kërkuar që të regjistrohet me emrin “Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit” dhe më vonë në pajtim me dispozitat e ligjit aktual me emrin “Kryepeshkopata Ortodokse – Greke e Patrikanës së Pejës”. Sipas legjislativit vendor, institucionet kompetente është dashur që ta vlerësojnë kërkesën për regjistrim në dritën e kufizimit ligjorë që pamundëson regjistrimin e entiteteve religjioze emri i të cilëve (në masë të konsiderueshme) nuk dallon nga emri i organizatës tani më të regjistruar. GJEDNJ në aktgjykimin e saj pranon se në kontekst të lirisë së shoqërimit,

kjo është një komponentë relevante, meqenëse emri përkatësisht emërtimi është një prej elementeve më të rëndësishme për identifikimin e shoqatës. Megjithatë, GJEDNJ morri qëndrimin se, në rastin konkret emri, përkatësisht emërtimi i zgjedhur nga ankuesi, ka qenë mjaftë specifik që ta dallojë atë nga Kisha Ortodokse Maqedonase – Kryepeshkopata e Ohrit. Gjithashtu, GJEDNJ gjatë sajimit të konkludimit të tillë ka marrë parasysh faktin se nuk kanë ekzistuar indikacione se ankuesi ka pasur për qëllim që të identifikohet me Kishën Ortodokse Maqedonase. Përkundrazi, GJEDNJ ka konstatuar se aplikuesi në mënyrë të prerë ka tentuar që të distancohet nga KOM. Edhe përkaj konkludimit të institucioneve vendore se vetëm Kisha Ortodokse Maqedonase ka pasur “të drejtën historike, religjioze, morale dhe materiale” që ta shfrytëzojë emrin “Kryepeshkopata e Ohrit”, GJEDNJ konstaton se nuk kanë ekzistuar indikacione se shfrytëzimi i këtij emri nga ana e shoqatës së ankuesit i shkel të drejtat dhe liritë, në veçanti liritë religjioze të të tjerëve.

**(c) Qëllimi i theksuar i ankuesit që të bëhet entitet paralel religjioz i Kishës Ortodokse Maqedonase:** GJEDNJ vlerësoi se në rastin konkret, obligimi i shtetit për qasje neutrale dhe të paanshme, ka qenë jo kompatible me çfarëdo lloj të autorizimit që ta vlerësojë legjitimitetin e bindjeve religjioze ose të modusit në të cilin të njëjtit janë shprehur. GJEDNJ vëren se autoqefaliteti dhe uniteti i Kishës Ortodokse Maqedonase ka një rëndësi të madhe për përkatësit dhe besimtarët e KOM dhe për shoqërinë në tërësi, por prapëseprapë ka sajuar konkludimin se një gjë e tillë nuk mund të arsyetohet në një shoqëri demokratike, të zbatohen masat e refuzimit të regjistrimit të ankuesit. Gjatë kësaj, në aktgjykimin e saj GJEDNJ thekson se roli i institucioneve në situata të ekzistimit të konflikteve në mes ose në suaza të grupeve religjioze, nuk është evitimi i shkaqeve të tensioneve përmes eliminimit të pluralizmit, por të sigurohet se grupet konkurrenente tolerohen në mes vete. Më pas, GJEDNJ në aktgjykimin e saj thekson se masat me të cilat pengohen liritë e shoqërimit dhe shprehjes (religjioze), nuk mund të arsyetohen me idenë se të njëjtit janë të natyrës parandaluese, pavarësisht nga fakti se sa shokuese dhe të pa pranueshme mund të jenë për pushtetin qëndrimet ose fjalët e caktuara dhe pavarësisht nga fakti se sa kërkesat e caktuara mund të jenë jo legjitime, përkatësisht se masat e tilla mund të kenë arsyeime vetëm në rastet e nxitjes së dhunës ose gjatë refuzimit të parimeve demokratike. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se në asnjë fazë të procedurës për regjistrim dhe në procedurën

para GJEDNJ nuk është theksuar se ankuesi orvatet për përdorimi e dhunës ose të mjeteve kundër demokratike për arritjen e qëllimeve të veta.

Duke pasur parasysh lartpërmendurën, GJEDNJ konkludon se arsyetimet e dhëna nga institucionet vendore, për refuzimin e regjistrimeve, marrë në përgjithësi, nuk kanë qenë “relevante dhe të mjaftueshme” që të arsyetohet intervenimi i shtetit gjatë përpjekjeve të ankuesit që të regjistrohet si organizatë fetare, përkatësisht si organizatë religjioze, dhe se refuzimi i regjistrimit në rrethana të këtij rasti, nuk mund të pranohet si masë e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

**Konkluzion:** ekzistimi i shkeljes – njëzëri.

Neni 41: 4,500 euro për dëme të natyrës jo materiale dhe 5.000 euro për kompensim të shpenzimeve.

# IRZ



Makavej, 2018